



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË
LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË
VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE.

SPITALI RAJONAL GJIROKASTËR

GUSHT 2018

Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 442/1 prot, datë 19.04.2018, i ndryshuar me nr. 442/2, datë 13.06.2018.

Auditimi është kryer nga:

1. S.H, përgjegjës grupi
2. E.M, anëtar
3. A.N, anëtar
4. I.D, anëtarë
5. J.H, anëtarë

Auditimi ka filluar më datë 23.04.2018.

Auditimi ka përfunduar më datë 29.06.2018.

Periudha e auditimit 01.06.2015 - 31.03.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Ky Raport Auditimi mbështetet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4100. 149. b), të INTOSAI, Pranuar dhe Sanksionuar në Rregulloren e Brendshme të KLSH, dhe strukturuar në “Udhëzuesin për Auditimin e Përputhshmërisë”, botim i KLSH, 2013, Kreu II, Pika 9, 149 b), ii.

Përmbajtja.

Emërtimi	Faqe
Përmbledhje	2-11
Hyrje	12-12
Qëllimi dhe procesi i auditimit	12-13
Rezultatet e auditimit, nga të cilat:	
I. Zbatimi i Rekomandimeve.	13-13
II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	14-17
III. Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit.	17-22
IV. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.	22-25
V. Auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlerë të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit etj).	25-44
VI. Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.	44-53
VII. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.	53-121
VIII. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.	121-124
IX. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.	124-127
X. Verifikim në spitalet e varësisë, nis hasen problematika gjatë auditimit në Spitalin Rajonal Gjirokastrë.	127-127
XI. Të ndryshme të rezultuara nga auditimi	127-129
Konkluzione dhe opinioni i auditimit	129-149
Anekset	150-150

Përmbledhje

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi përputhshmërinë e aktivitetit të Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë (këtu e në vazhdim SRGJ), me periudhë veprimtare 01.06.2015 deri më datë 31.03.2018, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike etj.

Nga auditimi i kryer për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin që iu vu në dispozicion grupit të auditimit, u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore dhe mangësi, të cilat paraqiten si më poshtë:

I. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016, “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH”.

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastër, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, u konstatohet se: nuk është kryer më parë auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre është konstatuar se:

-Nuk është ngritur Këshillin Administrativ dhe Këshillin Tekniko-Administrativ në kundërshtim me rregulloren nr. 4884 prot., datë 31.12.2008 “Për disa ndryshime në rregulloren e shërbimit të kujdesit shëndetësor dytësor (spitalor) dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”.

-Mos-ngritja e kësaj strukture ndikon në uljen e besueshmërisë dhe përpikërisë së zbatimit të politikave të Ministrisë së Shëndetësisë në Spital duke krijuar problematika në zbatimin e pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në kundërshtim me nenet 19-24 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Nuk analizohen pasqyrat financiare duke rritur riskun e devijimeve të cilat janë materiale nga ana cilësore dhe sasiore, nuk analizohet buxheti duke rritur riskun e ndryshimit të destinacionit të shpenzimeve buxhetore dhe nuk jepen opinione për domosdoshmërinë e investimeve të kryera ndër vite në spital. Mungesa e Këshillit K dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Të gjitha funksionet që duhet të kryheshin nga Këshilli Administrativ kryhen nga Drejtori i Spitalit. Mungesa e Këshillit ka sjellë efekte në mos-përmbushjen e plotë të detyrave të drejtorit ekzekutiv në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19.

-Nuk është ngritur gjithashtu Komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 40. Mungesa e Komitetit për planifikimin spitalor ka sjellë mangësi në hartimin dhe raportimin e planit spitalor në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Kreu V, Neni 42, Pika 2,3,5 dhe efektet janë pasqyruar në rastin e rikonstruksionit të spitalit si dhe në blerjen e pajisjeve mjekësore.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

III. Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit.

Nga SRGJ në hartimin dhe planifikimin e projektbuxhetin për vitet 2015, 2016. Nga grupi i punës nuk është analizuar dhe detajuar në mënyrë të hollësishme përlogaritja në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime mbështetur në kërkesën e MSH. Në relacion nuk është përshkruar gjëndja e detyrimeve të palikujduara në fillim të vitit dhe ecuria e shlyerjes së tyre si dhe nuk është përshkruar as planifikimi i të ardhurave dytësore të SRGJ. Lidhur me shpenzimet për “barna dhe materiale mjekësore” të cilat tre vitet e fundit janë rritur ndjeshëm nuk është bërë asnjë detajim ose analizë në hartimin e PB. Nga ana tjetër konstatohet realizimi i shpenzimeve në një shumë më të vogël sesa ajo e paraqitur në PBA e cila është e kushtëzuar nga çelja paraprake. Vlerat të cilat janë shpenzuar në buxhetin e vitit 2016 për të cilat nuk është planifikuar në fillim të vitit ose është planifikuar shumë më tepër nga se është realizuar. Nga këto diferenca të realizuara konstatohet një planifikim jo i saktë i nevojave të vitit të pritshëm buxhetor si pasojë e ndryshimit të niveleve të realizimit. Planifikimi kryhet në bazat e një përqindje të caktuar në rritje në krahasim me shpenzimin faktik të vitit të kaluar.

IV. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave janë konstatuar disa raste të personave të punësuar, ku për procedurën e marrjes në punë nuk figuron miratimi i Ministrit në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë, “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore” ku punësimi është kryer sipas urdhrave të brendshme.

-Nga auditimi u konstatuan devijime dhe tejkallim të strukturës pa miratim nga Ministria e linjës por vetëm me urdhër të titullarëve për administratën, sektorin e teknikës, hotelerisë dhe mjedisit.

-Rregullorja me të cilën ka funksionuar Spitali Rajonal i Gjirokastrës është e papërshtatur me ndryshimet e bëra në strukturë gjatë viteve të fundit duke krijuar pengesë në mirëfunksionimin administrativ të institucionit. Detyrat e secilit pozicion nuk janë të qarta duke qenë pengesë jo vetëm në procesin e administrimit por dhe të rekrutimit të stafit të ri në SRGJ.

-Nga auditimi i 20 dosjeve të personelit janë konstatuar mangësi në dokumentacion. Mangësitë më të hasura kanë qenë Cv, procedura e përzgjedhjes së aplikantëve dhe të emërimit në SRGJ si psh: kandidati fitues nuk plotëson të gjitha kushtet e shpallura në njoftim, mungon shpallja e njoftimit për vende vakante dhe përcaktimi i kriterëve për disa raste, procesverali i vlerësimit me pikë i intervistës dhe kriterëve të vlerësimit.

-Për periudhën objekt auditimi janë larguar punonjës të cilët kanë ndjekur procedurat ligjore dhe kanë paditur SRGJ në Gjykatë, nga të cilat 14 çështje kanë përfunduar me Vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, duke detyruar SRGJ të njohë shpenzime gjyqësore për të dëmshpërblyer financiarisht punonjësit në **shumën 8,369,278 lekë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.**

- Gjithashtu nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish-punonjësit, Spitali Rajonal Gjirokastrë është paditur në Gjykatë nga 13 punonjës të cilët janë në proces gjykimi dhe referuar Vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë kanë fituar këtë shkallë të gjykimit duke kërkuar nga SRGJ një dëmshpërblim financiar në shumën totale **5,057,674 lekë, shumë e cila do të sjellë një efekt financiar negativ të pritshëm për buxhetin e shtetit.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

V. Auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlerë të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit etj).

Gjatë auditimit me zgjedhje të likuidimeve nëpërmjet bankës rezultoi se gjatë vitit 2016 dhe vitit 2017 janë pranuar dhe likuiduar nga komisioni i pritjes së mallit barna, kite dhe reagente të cilat e kanë pasur afatin e skadencës më të vogël se 1 vit, veprim që bie në kundërshtim me DST të paraqitura në procedurën e prokurimit dhe në kontratën e nëshkruar mes palëve si dhe në dokumentet standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe APP.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël, rezultoi se: -Për vitin 2016 janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla *duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat normale të prokurimit, në shumën totale 1,124,140 lekë pa TVSH*, procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim, dhe konkretisht është kryer procedura “Blerje karburant”, në muajin mars 2016 me fond limit në shumën 465,440 lekë pa tvsh, dhe procedura “Blerje karburant”, me fond limit në shumën 658,700 lekë pa tvsh në muajin nëntor 2016.

-Për vitin 2017 janë kryer 4 procedura blerje me vlera të vogla *duke copëzuar fondin dhe duke anashkalluar procedurat normale të prokurimit*, pra procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim. Nga këto, 2 procedura me vlerë të vogël me objekt “Blerje karburanti” **në shumën totale 1,550,000 lekë pa TVSH**, dhe konkretisht është kryer procedura “Blerje karburant në muajin shkurt 2017”, me fond limit në shumën 800,000 lekë, dhe procedura “Blerje karburant”, me fond limit në shumën 750,000 lekë në muajin prill 2017. Gjithashtu janë kryer 2 procedura me objekt “Roje private” **në shumën totale 1,483,257 lekë pa TVSH**, konkretisht procedura me objekt “Roje private” me fond limit në shumën 733,099 lekë e zhvilluar në muajin shkurt 2017, dhe procedura me objekt “Roje private”, me fond limit në shumën 750,158 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale prokurimi.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 40, pika 1.

Nga auditimi i shpenzimeve për karburant u konstatua se në të gjitha rastet janë kryer pagesa për kontrata furnizimi me karburant pa kërkuar deklaratën doganore SAD të Operatorit Ekonomik kontraktues, mbi bazën e të cilit do të llogaritej çmimi për njësi i karburantit, por çmimi është vendosur bazuar në faturën me TVSH sipas furnizimit të shoqërisë, dhe buletinit të fundit sipas datës së faturës dhe kursit të këmbimit, gjithashtu nga titullari i SRGJ, në asnjë rast nuk është ngritur komision për mbikëqyrjen e kontratës, *veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IX, neni 77, pika 5 dhe 6.*

Në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, shpenzimeve për goma, bateri, servise etj., rezultoi se nga Dega Teknike, nuk janë plotësuar kartelat përkatëse për çdo mjet, ku të jenë të evidentuara të dhënat teknike të mjetit, defektet e konstatuara, shërbimet e kryera periodike etj. Gjithashtu për automjetet nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj., shpenzime të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për ndjekjen e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre, si dhe për gjurmën standarte të auditimit, *veprime të cilat janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Menaxhimi i aktiveve të njësitë e sektorit publik”, pikat 19, 26, 35, 121, 122.*

Gjatë auditimit është konstatuar se nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar të vendimeve gjyqësore, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar detyrime përmbartimore për 10 punonjësit e larguar, në **shumën 549,064 lekë, e cila përbën**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

VI. Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2017 rezulton se gjendja debitore për gjoba, penalitete dhe detyrime të cilat janë gjeneruar për 68 punonjës të insitucionit nga kontrollet e FSDKSH-së, detyrime këto të cilat duhet të mbliidhen dhe arkëtohen nga Spitali Rajonal Gjirokastër, konstatohet se vlera në fund të vitit paraqitet në shumën 1,952, 840 lekë. Nga ana e insitucionit nuk janë marrë masat e duhura për nisjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 9, neni 12, pika g dhe gj, dhe **shuma prej 1,952,840 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.**

Gjithashtu paraqiten edhe debitorë të tjerë të cilët janë operatorë ekonomik apo mbikqyrës punimesh të cilët nuk kanë zbatuar kushtet e kontratave duke gjeneruar penalitete dhe gjoba, të cilat janë njohur në pasqyrat financiare të SRGJ. Këto penalitete janë konstatuar nga kontrollet e vazhdueshme të kryera nga FSDKSH ndaj SRGJ, ku janë 8 subjekte në shumën totale 2,885,142 lekë.

Nga ana e insitucionit nuk janë marrë masat e duhura për nisjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 9, neni 12, pika g dhe gj, dhe **shuma prej 2,885,142 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.**

VII. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Ne Spitalin Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastër për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 68 procedura prokurimi si dhe 34 kontrata shtesë me vlerë prej 435.6 milion lekë.

Nga grupi i auditimit janë audituar 26 procedura prokurimi si dhe 11 kontrata shtesë me vlerë 276.4 milionë lekë, 63 % e investimeve të realizuar ose 38% e procedurave kryesisht ato me vlerë më të madhe dhe me rrisht më të lartë.

Vlera prej 159.2 milion lekë për tendera të pa audituar i përket shpenzimeve për material mjeksore per imazherinë, oksigjen mjeksorë, ushqime pasi nga përlllogaritja e përvitshme dhe mesatarja e të shtruarve rezultoi të mos kishte rritje krahasimisht me vitet e mëparshme etj.

-Ne lidhje me procedurat për blerje Medikamete, Material mjekimi si dhe Kite&reagent në këtë insitucion u konstatua se edhe pse është e parashikuar qartë në kontratën e lidhur mes palëve kushtet e furnizimit dhe afatet e furnizimit, nga ana e operatorëve ekonomik fitues në kundërshtim me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 659-704 “Kontratat”, si dhe kontratën respektive nenet 3 dhe 6 të saj, me dijeni të plotë kanë furnizuar me medikamente, materiale mjeksore apo Kite&Reagent jo në përputhje me cilësinë e kërkuar dhe pranuar mes palëve si dhe kanë kryer furnizimet me këto artikuj jo në afatin e miratuar. Nga ana e ish-drejtorit K.K edhe pse janë evidentuar këto mangësi në kundërshtim me kontratën në dy raste ka miratuar kërkesën për shtyrje afati pa bazë ligjore të furnizimit me këto artikuj.

-Nga auditimi u konstatua se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Në 6 raste, në procedurat e negociimit pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, nga autoriteti kontraktor nuk është argumentuar dhe dokumentuar arsyeja e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negociim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 36, pika 4, e cila përcakton se: *“Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e kandidatëve që do të ftojë”*.

-Në 2 raste, në procedurat e negociimit pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, shkaqet e pavarura janë të paargumentuara dhe institucioni nuk ndodhet në kushtet e nevojës extreme për ngjarje të paparashikuara në kundërshtim me nenin 33 të LPP, pika c ku rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor.”

-Në 3 raste, në procedurat e marrjes me qira të kaldajave, nga Njësia e Prokurimit në përgatitjen e DT nuk është vepruar në përputhje me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 11.

-Në 1 rast skualifikimi i operatorit ekonomik është kryer jo në përputhje të VKM nr.914 datë 29.12.2014, Neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 3.

-Në të gjitha procedurat e prokurimit, nuk ka raporte mbi monitorimin e zbatimit të kontratës sipas specifikimeve teknike, sasitë, shërbimet e kryera etj., në kundërshtim me nenet 1, 15 e 17 të kontratës, së lidhur në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX, neni 77, ku gjithashtu në përfundim të kontratës autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX neni 77, pika 1.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se:

-Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83/2.

- Në 5 raste nga procedurat e audituara, nuk konstatohet të jetë argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Në 6 raste, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1.

-Nga auditim i ushtruar mbi procedurën “Blerje medikamente për nevojat spitalore viti 2016” me afat furnizimi deri më datë 15.04.2016, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 2,920,321 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik **“FF” Sh.p.k**.

-Nga auditim i ushtruar mbi procedurën “Blerje medikamente për nevojat spitalore viti 2017” me afat furnizimi deri më datë 15.04.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 2,512,552 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik **“FF” Sh.p.k** si dhe **359,780 lekë dëm ekonomik** për furnizime me medikamente jo në përputhje me cilësinë e kërkuar.

Nga auditim i ushtruar mbi procedurën “Blerje materiale mjekësore për vitin 2017” me afat furnizimi deri më datë 15.04.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 1,897,181 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik **“FF” Sh.p.k** si dhe **310,800 lekë dëm ekonomik** për furnizime me materiale mjekimi jo në përputhje me cilësinë e kërkuar.

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Blerje Kite&Reagent, viti 2016”* është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **1,231,776 lekë**, e cila përfaqëson **911,520 lekë** si mall I furnizuar në kundërshtim me kushtet e kontratës *neni 6 pika 2 e kontratës “Cilësia e mallit” dhe vlera 320,256 lekë* si penalitet I llogaritur nga mosfurnizimi në kohë me mall. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi shoqërinë fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse **“G-A F” SHPK e cila me dijani të plotë ka kryer furnizimin me Kite&Reagente me një afat skadence më të vogël se një vit si dhe nuk ka realizuar furnizimin me mall brenda afateve të përcaktuara në kontratë.**

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Blerje Kite&Reagent, viti 2017”*, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **1,016,800 lekë**, e cila përfaqëson furnizime me *Kite&Reagent në kundërshtim me nenin 6 pika 2 e kontratës “Cilësia e mallit”*, ku ngarkon me përgjegjësi shoqërinë fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse **“G-A F” SHPK e cila me dijani të plotë ka kryer furnizimin me Kite&Reagente me një afat skadence më të vogël se një vit.**

-Nga auditim i ushtruar mbi procedurën *“Blerje materiale mjekësore për vitin 2016”* me afat furnizimi deri më datë 15.04.2016, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 493,923 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik **“G” Sh.p.k** si dhe **36,489 lekë dëm ekonomik** për furnizime me materiale mjekimi jo në përputhje me cilësinë e kërkuar.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt *“Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve”*, për vitin 2015, nga verifikimi i dokumentacionit për shërbimet e kryera rezultoi se për pjesët të cilat janë ndërruar është hartuar procesverbal nga kryetari i degës teknike z.F.D dhe është nënshkruar nga secili shofer në të cilin shprehet se është bërë kthimi i tyre në magazinën e recuperos. Ndërkohë që pjesët e ndërruara nuk janë bërë në asnjë rast hyrje në magazinën e sipërpërmendur por ruheshin nga shoferët në ambientet e garazhit të secilit. Nga verifikimi me zgjedhje i disa pjesëve të këmbimit të cilat ruheshin nga shoferët rezultoi se mungonin disa prej tyre për të cilat nuk verifikohet fakti i ndërrimit të tyre. Në lidhje me kryerjen e shpenzimeve për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve nga titullari i AK-së nuk është kërkuar raport mbi zbatimin e kontratës së mësipërme. Vlera për kontratën e vitit 2015 për pjesët të cilat nuk u gjenden është në shumën 531,960 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. **Shuma 531,960 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt *“Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve”*, për vitin 2016, nga verifikimi i dokumentacionit për shërbimet e kryera rezultoi se për pjesët të cilat janë ndërruar është hartuar procesverbal nga kryetari i degës teknike z.F.D dhe është nënshkruar nga secili shofer në të cilin shprehet se është bërë kthimi i tyre në magazinën e recuperos. Ndërkohë që pjesët e ndërruara nuk janë bërë në asnjë rast hyrje në magazinën e sipërpërmendur por ruheshin nga shoferët në ambientet e garazhit të secilit. Nga verifikimi me zgjedhje i disa pjesëve të këmbimit të cilat ruheshin nga shoferët rezultoi se mungonin disa prej tyre për të cilat nuk verifikohet fakti i ndërrimit të tyre. Vlera për kontratën e vitit 2016 për pjesët të cilat nuk u gjenden është në shumën 544,800 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. **Shuma 544,800 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve”, për vitin 2017, nga verifikimi i dokumentacionit për shërbimet e kryera rezultoi se për pjesët të cilat janë ndërruar është hartuar procesverbal nga kryetari i degës teknike z.L.Q dhe është nënshkruar nga secili shofer në të cilin shprehhet se është bërë kthimi i tyre në magazinën e rekuperos. Ndërkohë që pjesët e ndërruara nuk janë bërë në asnjë rast hyrje në magazinën e sipërpërmendur por ruhen nga shoferët në ambientet e garazhit të secilit. Nga verifikimi me zgjedhje i disa pjesëve të këmbimit të cilat ruhen nga shoferët rezultoi se mungonin disa prej tyre për të cilat nuk verifikohet fakti i ndërrimit të tyre. Në lidhje me kryerjen e shpenzimeve për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve nga titullari i AK-së nuk është kërkuar raport mbi zbatimin e kontratës së mësipërme. Vlera për kontratën e vitit 2016 për pjesët të cilat nuk u gjenden është në shumën 364,680 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. **Shuma 364,680 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Blerje Kite&Reagent, viti 2015*”, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **144,060 lekë**, e cila përfaqëson furnizime me *Kite&Reagent në kundërshtim me nenin 6 pika 2 e kontratës “Cilësia e mallit”*, ku ngarkon me përgjegjësi shoqërinë fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse “**G-A F**” SHPK e cila ka kryer furnizimin me *Kite&Reagente jo në përputhje me kontratën.*

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Mirëmbajtje e impiantistikës, viti 2015*” është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **72,990 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e materialeve dhe punimeve të situacionuara, faturuar, dhe likuiduara si punime të kryera në repartin e maternitetit gjatë periudhës 25.08.2015-31.12.2015 periudhë kjo, kur Godina e Maternitetit ka qenë në restaurim. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi shoqërinë fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse “**I**” SHPK e cila me *dijeni të plotë ka kryer furnizimin me materiale impiantistike ndërkohë që kjo godinë ka qenë në rikonstruksion.*

-Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “*Blerje Kite&Reagent*” kontrata shtesë 2017, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **176,400 lekë**, e cila përfaqëson furnizime me *Kite&Reagent në kundërshtim me nenin 6 pika 2 e kontratës “Cilësia e mallit”*, ku ngarkon me përgjegjësi shoqërinë fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse “**G-A F**” SHPK e cila ka kryer furnizimin me *Kite&Reagente jo në përputhje me kontratën.*

VIII. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

-Në Spitalin Rajonal Gjirokastër ka një mangësi të theksuar të njohjes së Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pasi ky Ligj nuk është vënë në funksionim, dhe për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë ku drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Nga SRGJ nuk janë përcaktuar procedura të brendshme të anti-korrupsionit dhe të sinjalizimit të parregullsive. Për vitin 2015-2017, nuk është hartuar dhe dërguar në Ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, gjithashtu nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësoin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së.

-Nuk është hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit. Nuk ka të miratuar një plan afatmesëm për rishikimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

sistemeve të brendshme të kontrollit të të gjithë niveleve të institucionit. Për rrjedhojë në SRGJ nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, për kryerjen e shpenzimeve dhe funksioneve të ndryshme të shoqërisë si dhe rregulla për delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre: Nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut:

Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.

IX.Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

-Kontratat e lidhura me subjektet private për vitin 2015, nuk kanë Stemen e “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse, në kundërshtim me “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, në të cilin është përcaktuar se: “*Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemen e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrimit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur.*

-Nuk ka autorizim nga Drejtori i Spitalit për monitorimin e kontratave me qira nga stafi apo nënpunësi zbatues. Kjo bie në kundërshtim me **Vendimin nr. 54**, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” monitorimi i kontratës.

-Spitali Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastër deri më 29.06.2018, nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të asetëve në Z.V.R.P.P përkatëse.

Nisur nga fakti se në këtë spital edhe pse në nivel qarku nuk është ngritur akoma Këshilli administrativ sipas rregullores dhe ligjeve në fuqi dhe struktura organizative dhe drejtuese më e lartë e spitalit është drejtoria, vihet re një menaxhim në nivele të ulta drejtuese të këtij spitali pasi; nga prona truall që ky spital administron që në ndërtimin e tij dhe referuar planimetris së vitit 1981 nga 31,190 m² truall sot në administrim të spitalit janë vetëm 27,325 m² ose 3,865 m² më pak, sipërfaqe këto të zhveshura nga na jugore dhe veriore e pronës pa një datë të caktuar. Referuar cmimit të trojeve në Republikën e Shqipërisë miratuar me VKM nr.89 datë 03.02.2016 për qytetin e Gjirokastrës zona kadastrale nr. 8541 ka një cmim prej 4865 lekë/m² x 3,865 m² = **18,803,225 lekë vlerë e zhveshur nga asetet e spitalit**.

Për periudhën objekt auditimi janë lidhur 2 kontrata qiraje për objekte, të trashëguara ndër vite kontrata mes Spitalit Rajonal Omer Nishani dhe z.A.Zs për një objekt në hyrje të spitalit me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

sipërfaqe 37.5 m² dhe një çmim prej 17,437 lekë muaj dhe kontrata me z. A.Sh për një objekt në brendësi të spitalit me sipërfaqe prej 42 m² objekt dhe 120 m² sipërfaqe funksionale me një çmim prej 10,320 lekë në muaj. Në lidhjen e kontratave mes të interesuarve dhe spitalit duke mbajtur dy standarte në çmimin për m² të qirasë mbajnë përgjegjësi ish-drejtorët A.M dhe K.K.

X.Verifikim në spitalet e varësisë, nëse hasen problematika gjatë auditimit në Spitalin Rajonal Gjirokastrë.

Gjirokastra si qytet është qendra më të rëndësishme administrative, kulturore dhe ekonomike e rajonit jugor të Shqipërisë. Qyteti i Gjirokastrës është qendër e bashkisë, rrethit, qarkut dhe prefekturës me të njëjtin emër. Në këtë qytet funksionojnë disa institucione, agjensi dhe drejtori rajonale, si spitali rajonal “Omer Nishani”, i cili mbulon me shërbime të specializuara të gjitha spitalet e zonës së Përmetit, Tepelenës dhe Libohovës. Nisur nga fakti se ky spital ka dhe mjek më të specializuar dhe shërbim më të plotë ai mbulon një fluks shumë të madh urgjencash të zonave përreth. Spitali Rajonal “Omer Nishani” është i pajisur me 9 Autoambulanca për ofrimin e shërbimit të urgjencës.

XI. Të ndryshme të rezultuara nga auditimi

-Planifikimi për blerje barna e materiale mjekimi nga ana e Spitalit omer Nishan i Gjirokastrë Kryhet pa bërë një mirstudim të nevojës për këto barna e medikamente duke mos analizuar konsumin mesatarë vjetor dhe duke mos llogaritur kushtet e ruajtjes në depon (farmacinë) e Spitalit e cila është në kushte jo të mira. Për këtë problem ka dhe një kërkesë të ish përgjegjëses së Farmacisë M.Z drejtuar ish-drejtorit të spitalit K.K me nr. 50 datë 28.01.2016 me lëndë: Njoftim për kushtet e farmacisë dhe mungesat e barnave dhe materialeve mjeksore.

Për periudhën objekt auditimi nga blerja e medikamenteve, materiale mjeksore dhe Kite Reagente të pa planifikuar mirë pa marrë gjëndjen e Farmacisë apo pa llogaritur konsumin mesatarë ndër vite dhe mbi të gjitha pranimi i mallrave jo në përputhje me kontratën por me një afat skadence shumë të afërt u konstatuan barna të skaduar në **vlerën prej 2,648,765 lekë e cila përbën efekt financiarë negativ për institucionin**. Gjithashtu në ruajtje janë barna me rrezikshmëri të lartë të cilat futen në familjen e Helmevesi Antropine, Morfinë, Pancuranium etj të skaduar në një vlerë prej 245,041 lekë nga të cilat 40,987 janë për vitet 2015-2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

HYRJE

Ky auditim ka të bëjë me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare të Spitalin Rajonal Gjirokastrë, për periudhën 01.06.2015 deri më datë 31.03.2018. Ky auditim ka marrë në analizë dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje, sipas rastit dhe problematikës së evidentuar gjatë auditimit. Grupi i auditimit është përpjekur në kryerjen e një auditimi të plotë dhe të gjithanshëm të aktivitetit të institucionit për këtë periudhë.

Auditimi u realizua në përputhje me: Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003, “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”; Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Rregulloren e Brendshme të Spitalit; etj.

Në këtë auditim është analizuar: Zbatimi i ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre; Planifikimi dhe zbatimi i Buxhetit, si dhe shpenzimet administrative; Zbatimi i dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave; Zbatimi i dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit; Zbatimi i dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike dhe lidhjen e kontratave; Zbatimi i dispozitave ligjore në zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile; Zbatimi i dispozitave ligjore në prokurimet me vlerë të vogël; Zbatimi i dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore; Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Qëllimi dhe procesi i auditimit

Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese kanë qenë;

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimin e riskut dhe proceseve të drejtimit;

a. jep siguri të arsyeshme nëse:

-informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;

-burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;

b. dhënia e rekomandimeve dhe të kërkesave për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë.

Gjetjet kryesore: Nga auditimi i kryer për zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë ekonomiko-financiare dhe vlerësues, duke verifikuar sipas rastit dokumentacionin e plotë dhe me zgjedhje që ju vu në dispozicion grupit të auditimit, janë nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

frytshmëri të fondeve të Spitalit Rajonal Gjirokastër. Gjetjet kryesore të konstatuara nga ky auditim lidhen kryesisht me:

- organizimin dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli Tekniko-Administrativ),
- plotësimin e pasqyrave financiare (bilancit),
- në pagesat e kryera nëpërmjet arkës dhe bankës,
- në marrëdhëniet e punës,
- në prokurimin e fondeve dhe zbatimin e kontratave,
- në organizimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Parregullsitë, dobësitë dhe shkeljet e vërejtura, tregojnë se sistemi i kontrollit të brendshëm kërkon të përmirësohet. Në lidhje me këtë, rekomandimi i përgjithshëm Drejtorin e Institucionit, është që të forcojnë nivelin e menaxhimit, duke pasur objektiv menaxhimin me efektivitetet në funksion të rritjes së fitimit dhe zbatimin e politikave afatgjatë në fushën e administrimit spitalor.

Kriteret e vlerësimit. Në vlerësimin e mekanizmave të kontrollit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve, të cilat mund të ndodhin;
- procedurat e mekanizmave të kontrollit, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;
- nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;
- anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të kontrollit, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;
- ndikimi që këto anë të dobëta kanë.
- shpërndarja në kohë dhe intensiteti i gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve.

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet, duke përfshirë testimet dhe procedurat që u mendua se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare, në përputhje me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

Rezultatet e auditimit

I. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016, “*Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH*”.

Nga auditimi i ushtruar në Spitalin Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastër, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, u konstatohet se: nuk është kryer asnjëherë auditimi i jashtëm publik nga Kontrolli i Lartë i Shtetit

Spitali Rajonal "Omer Nishani" Gjirokastër është spital i cili i shërben rajoneve Gjirokastër, Tepelenë, Përmet dhe rrethinave përreth I cili ofron shërbime për një popullsi më shumë se 200,000 banorë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

II. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Spitali Rajonal "Omer Nishani" Gjirokastër vepron në bazë të rregullores së shërbimit të kujdesit shëndetësor dytësor (spitalor) të vitit 1997 përditësuar me rregulloren e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë nr.4884 prot., datë 31.12.2008 “Për disa ndryshime në rregulloren e shërbimit të kujdesit shëndetësor dytësor (spitalor).

Në kundërshtim me këtë rregullore dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Spitali Rajonal "Omer Nishani" Gjirokastër nuk ka kryer organizimin për funksionimin e spitalit pasi **nuk ka ngritur Këshillin Administrativ dhe Këshillin Tekniko-Administrativ**, ndërkohë efekti zinxhir i këtij mosveprimi është ndjerë në të gjitha hallkat e menaxhimit të brendshëm dhe është në kundërshtim me:

Kreu I, neni 4, Organet drejtuese të spitaleve janë 1. Këshilli Administrativ 2. Drejtoria 3. Komisioni Mjekësor i Spitalit 4. Këshilli Tekniko-Administrativ

Kreu I, neni 5, Këshilli Administrativ është organi më i lartë i drejtimit të spitaleve dhe si i tillë siguron zbatimin nga spitali të politikës së përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë.

Mosngritja e kësaj strukture ndikon në uljen e besueshmërisë dhe përpikërisë së zbatimit të politikave të Ministrisë së Shëndetësisë në Spital. Konkretisht, mos veprimet e Institucionit Spitalor në lidhje me themelimin dhe funksionimin e kësaj strukture ka sjellë pasojat e mëposhtme në lidhje me detyrat e Këshillit Administrativ:

Kreu I, Neni 6, Detyrat e Këshillit Administrativ

Këshilli Administrativ në zbatim të politikës së Ministrisë së Shëndetësisë mbi bazën e studimeve, projekton zhvillimin e spitaleve (afatgjatë dhe afatmesëm) për investime, pajisje, nevojë për personel, aparaturë etj

Kjo detyrë kryhet vetëm nga Drejtori i Spitalit duke centralizuar pushtetin e tij ekzekutiv, duke rritur riskun e vendimmarrjes absolute dhe duke krijuar hallkën e parë të dobësisë së menaxhimit financiar dhe kontrollit të institucionit.

Analizon dhe miraton strukturën e organizimit të përgjithshëm të spitalit dhe e zbaton atë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Mungesa e kësaj analize nga Këshilli Administrativ ndikon në organizimin e përgjithshëm të punës në spital, në organigramën e spitalit dhe rrit riskun e punësimeve në pozicione të paanalizuara mirë, ndikon në rritjen e riskut për punësime mbistrukturën e miratuar të punonjësve ose kryerjen e punësimeve të stafit kualifikimet e të cilëve nuk përputhen me pozicionin e punës.

Analizon dhe miraton rregulloret e brendshme të spitalit, buxhetin (në fillim të vitit), bilancin, aktivitetin financiar, programin e aktiviteteve mjekësore si dhe prioritetet e propozuara nga Komisioni Mjekësor i Spitalit. Këshilli Administrativ kontrollon dhe siguron zbatimin e tyre.

Mungesa e këshillit ka sjell mospërditësim të rregullores së spitalit e cila vepron mbi bazën e një rregulloreje e cila është e vitit 2008, rregullorja e papërditësuar nuk i përshtatet ndryshimeve të ligjeve të funksionimit të spitaleve nga viti 2008-2018 dhe K boshllëk në sistemet e menaxhimit të brendshëm. Nuk analizohen pasqyrat financiare duke rritur riskun e devijimeve të cilat janë materiale nga ana cilësore dhe sasiore dhe që mund të ndikojnë në aktivitetin e përgjithshëm spitalor, nuk analizohet buxheti duke rritur riskun e ndryshimit të destinacionit të shpenzimeve buxhetore dhe nuk jepen opinione për domosdoshmërinë e investimeve të kryera ndër vite në spital, duke kanalizuar studimet vetëm në sektorin juridik dhe financiar të spitalit. Vetë anëtarët e Këshillit Administrativ (i cili në përbërje duhet të ketë dy anëtarë të caktuar nga këshilli i qarkut ku ndodhet autoriteti spitalor i qarkut; një anëtar i caktuar nga çdo këshill bashkiak ku ndodhen spitalet në nivel bashkie; një përfaqësues i caktuar nga prefekti i qarkut; presidenti i urdhrat të mjekut të qarkut; drejtori i autoritetit spitalor; drejtori i drejtorisë së sigurimeve të kujdesit shëndetësor të qarkut ose një person i autorizuar prej tij; kryeinfermieri i përgjithshëm i spitalit të qarkut sipas Kreut II, Nenit 13, Këshilli Administrativ të ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”) për shkak të eksperiencës së punës, japin ekspertizën e tyre, duke u thelluar në studime të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

detajuara, në lidhje me prioritetet e aktivitetit mjekësor për ti shërbyer më mirë pacienteve të rajoneve Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet si dhe komunave përreth.

Cakton detyra për shërbimet, sektorët, repartet, për organizimin dhe ecurinë e shërbimit shëndetësor në spital.

Mungesa e Këshillit K dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” duke rritur riskun e parregullsive dhe të menaxhimit jo-efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare të cilat janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimit publik spitalor.

Mungesa e përcaktimit të përgjegjësive është në kundërshtim me Përgjegjshmërinë menaxheriale e titullarit, neni 8, i cili citon:

Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: d) propozimin e një strukture të përshtatshme organizative dhe vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, përveç rasteve kur legjislacioni i posaçëm parashikon ndryshe

Mos caktimi i saktë i detyrave për ecurinë e shërbimit shëndetësor në spital K problematika në të gjithë komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Kundërshtim me nenet 19-24 të Ligjit të MFK.

Mjedisi i kontrollit çalon në 3 nga 5 komponentët e tij dhe konkretisht në politikat menaxheriale dhe stilin e punës; në strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; si dhe në politikat dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Menaxhimi i riskut nuk jep siguri të arsyeshme mbi realizimin e objektivave të shërbimit spitalor. Mungesa e Këshillit gjithashtu rrit riskun për uljen e nivelit të sigurisë që shërbimi spitalor ofron pasi nuk figurojnë raporte mbikëqyrje dhe monitorimi të shërbimeve spitalore.

Veprimtaritë e kontrollit nuk përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin. Në këtë rast, cdo funksion kryhet dhe zbatohet nga Drejtori Ekzekutiv, pasi Këshilli nuk ekziston.

Mungesa e këshillit dhe koordinimit të punës ka sjellë një komunikim jo efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësive.

Gjithashtu, titullari e spitalit i cili është përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, *sa herë që ndryshojnë kushtet* duhet të kërkojë ndihmën e Këshillit Administrativ për t’iu përshtatur nevojave dhe kërkesavë të pacientëve në kohë reale.

Në kundërshtim me ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 14, nuk janë përmbushur gjithashtu Funksionet e këshillit administrativ:

Këshilli administrativ ushtron këto funksione:

a) miraton politikat, harton programet tekniko-financiare për konkretizimin e planeve afatshkurtra dhe afatgjata në fushën e shërbimit spitalor të qarkut, në përputhje me strategjinë dhe politikat shtetërore shëndetësore, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë;

b) programon dhe i propozon Ministrisë të Shëndetësisë ndryshimet strukturore të autoritetit spitalor të qarkut;

c) propozon projektbuxhetin, ndarjen dhe destinacionin e tij;

ç) vendos për pranimin e dhuratave nga individë ose fondacione dhe shoqata me qëllim bamirësie, si dhe binjakëzimin me spitalet simotra;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

d) i propozon Ministrin të Shëndetësisë emërimin dhe shkarkimin e drejtorit ekzekutiv të autoritetit spitalor të qarkut;

Të gjitha këto funksione kryhen nga Drejtori i Spitalit. Mungesa e Këshillit ka sjellë efekte në **mospërbushje plotë të detyrave të drejtorit ekzekutiv në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 19.**

Funksionet e drejtorit ekzekutiv, neni 19, Pika a,d,e

Drejtori ekzekutiv është drejtuesi ekzekutiv, organizues dhe kontrollues i të gjithë veprimtarisë së drejtorisë dhe ushtron këto funksione:

a) raporton dhe përgjigjet para këshillit administrativ;

d) përgatit planet e punës në fillim të vitit dhe ia paraqet këshillit administrativ për miratim

e) drejton punën për hartimin e projektbuxhetit ekonomik dhe financiar dhe i paraqet për miratim këshillit administrativ buxhetin e zberthyer për çdo spital, shërbim e repart;

Pranë Spitalit nuk është ngritur gjithashtu Komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 40 i cili citon:

1. Pranë autoritetit spitalor publik të qarkut ushtron veprimtarinë e vet komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut, i cili është organi këshillimor i tij.

2. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të këtij komiteti përcaktohen me vendim të këshillit administrativ të autoritetit spitalor të qarkut.

Mungesa e Komitetit për planifikimin spitalor ka sjellë mangësi në hartimin dhe raportimin e planit spitalor në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Kreu V, Neni 42, Pika 2,3,5.

2. Plani spitalor i qarkut miratohet nga këshilli administrativ, në përputhje me planin shtetëror spitalor, dhe përcakton parashikimin e ndërhyrjeve në qark të lidhura me ngritjen e spitaleve të reja, me transformimin, modernizimin ose mbylljen e spitaleve ekzistuese, me nevojën për një numër shtretërisht të ndarë për rastet akute, kronike, konvaleshente, me eficientë e pajisjeve, me rrjetin rrugor dhe kushtet geomorfologjike dhe higjieno-sanitare të popullatës.

3. Zgjerimi, transformimi, përveç përshtatjeve të detyruara nga kërkesa funksionale, duhet të realizohen, në përputhje me planin spitalor të qarkut.

5. Në planin spitalor të qarkut duhet të përcaktohen mjetet financiare për ndërtimin e spitaleve të reja, zgjerimin, transformimin ose modernizimin e atyre ekzistuese, blerjen e pajisjeve përkatëse, si dhe për shpërndarjen e tyre, në lidhje me objektivat e përcaktuara nga plani spitalor i qarkut.

Mungesa e planit spitalor ka sjellë pasoja në:

-Rastin e rikonstruksionit të spitalit duhej ndërhyrja dhe analiza e Komitetit për planifikimin spitalor ndërkohë vendimi për rikonstruksion është ndërmarrë vetëm nga Drejtorja e Spitalit. Mungesa e Komitetit influencon në mungesën e studimeve të hollësishme të bazuara mbi nevojën sipas numrit të shtretërve. Nuk ka analiza të detajuara të bazuara mbi shtimin e numrit të popullatës për vitet 2009-2018 dhe studimet për rikonstruksion janë bazuar vetëm në kërkesën dhe nevojën për rikonstruksion, referuar dhe ankesës verbale të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë F.G i cili e njeh mirë këtë institucion pasi ka ushtruar detyrën e Mjekut, në lidhje me gjendjen aktuale të Spitalit Rajonal “Omer Nishani” si në lidhje me degradimin e tij nga Lagështira fenomen shumë i njohur në këtë qytet u konstatua se:

Rikonstruksioni i Spitalit “Omer Nishani” është bërë në vitet 2007-2009 dhe në asnjë moment nuk është kryer një rikonstruksion i plotë por janë kryer rikonstruksione pjesore në referencë të kontaktës nr. 16 datë 15.08.2007 lidhur ndërmjet Spitalit Gjirokastër me drejtor N.ZH dhe operatorit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

ekonomik “J.K” me përfaqësues S.C. Në objekt të kësaj kontrate është “Rikonstruksioni i ambjenteve të brendshme të Spitalit” me vlerë 47,376,900 lekë.

Kontrata nr. 15 datë 15.08.2007 lidhur ndërmjet Spitalit Gjirokastrë me drejtor N.ZH dhe operatorit ekonomik “J” SHPK me përfaqësues J.B. Në objekt të kësaj kontrate është “Rikonstruksioni H/izolimi + dritare + suvatime të jashtme” me vlerë 8,334,480 lekë.

Nga investimi deri më tani kanë kaluar pothuajse 10 vite një kohë shumë e gjatë për të bërë një verifikim të mirëfilltë rikonstruksionit të këtij spitale në verifikimin e zërave të punimeve. Nga ana vizuale ato zëra që janë të dukshëm si dyer e dritare janë të zëvendësuar. Problematika më e madhe e këtij spitali mbetet lagështira që vjen nga natyra e këtij qyteti si dhe nga sistemi hidraulik tejet i amortizuar i këtij objekti 40-50 vjeçarë.

-Nuk ekziston një plan spitalor i cili jep shpjegime në lidhje me domosdoshmërinë e blerjeve të pajisjeve mjekësore. Pajisjet blihen me kërkesë të pavjoneve të ndryshme, i cili argumenton nevojën dhe domosdoshmërinë për pajisjen, kjo kërkesë më pas shtjellohet nga grupi për argumentimin e fondit limit. Praktikisht Komiteti nuk kryhen detyra funksionale themelore për spitalin.

III. Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e Buxhetit.

Spital Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë, që prej vitit 2015 ofron shërbim shëndetësor dhe për qytetet dhe komunat e tjera të rajonit të madh. Kjo ka bërë që numri i pacientëve të urgjencës dhe të shtruar të rriten duke ndikuar drejtëpërdrejtë në shpenzimet e shërbimit spitalor të financuara nga buxheti i shtetit për vitin 2015 dhe në vazhdim. Konstatohet se për zërin “barna dhe materiale mjekësore” tre vitet e fundit shpenzimet janë rritur ndjeshëm krahasimisht me vitet e më parshme por lidhur me këtë nuk është treguar kujdes në argumentimin për hartimin e PBA. Keqadministrimi i procesit të hartimit, planifikimit dhe realizimit të Buxhetit në SRGJ vjen si mungesë e analizave të detajuara statistikore në parashikimin e shpenzimeve vjetore duke bërë kështu një parashikim jo të saktë dhe kthim të përvitshëm të tepërcave nga fondet buxhetore gjatë tre viteve objekt auditimi në vlerën mbi 2,000,000 lekë. Sa më sipër është detajuar në materialin e më poshtëm.

Për vlerësimin e procesit të programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor për vitet 2015, 2016, 2017, 2018 të Spitali Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë (SRGJ), janë analizuar fillimisht planifikimet buxhetore afatmesme për përballimin e nevojave për vitet në vijim në bazë të eksperiencës së viteve të kaluara dhe nevojave reale si pasojë e ndryshimeve në vitin e pritshëm buxhetor. Në vijim janë analizuar të gjitha shkresat e miratimit të buxhetit vjetor së bashku me ndryshimet gjatë vitit në funksion të përcaktimit të planit përfundimtar dhe në kuadër të ndryshimeve të autorizuar nga nivelet përkatëse autorizuese. Plani përfundimtar i buxhetit sipas shkresave përkatëse është krahasuar me situacionin progresiv të thesarit për secilin vit.

Auditimi i fondeve të alokuara nga buxheti i shtetit është kryer në bazë të kërkesave të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Për verifikimin e hartimit, planifikimit dhe realizimit të Buxhetit të institucionit janë marrë në shqyrtim planifikimi paraprak sipas kërkesave të PBA, planifikimin vjetor sipas detajimit nga FSDKSH, planit përfundimtar pas ndryshimeve gjatë vitit të limiteve për llogaritë përkatëse dhe realizimin faktik.

Spitali Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë, në përputhje me nenin 24 të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, ka përgatitur kërkesat buxhetore të programit sipas procedurave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

përcaktuara në këto udhëzime. Bashkëngjitur planifikimit të vitit aktual dhe atij afatmesëm janë formularët shoqërues për argumentimin e kërkesave buxhetore në vitin 2015, 2016 dhe 2017.

Nga auditimi u konstatua se në mungesë të Këshillit Administrativ për SRGJ, hartimi i PBA për secilin vit është hartuar nga një grup pune me urdhër të titullarit në kundërshtim me Ligjin nr.9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në republikën e shqipërisë”, kreu II, neni 14, pika c), në të cilin citohet se “Këshilli administrativ ka si funksion...Propozimin për projektbuxhetin, ndarjen dhe destinacionin e tij”. Urdhrat e më sipërme nuk janë vënë në dispozicion nga SRGJ.

Për vitin 2015, SRGJ ka dërguar Projekt Buxhetin me shkresat nr.212 dhe 213 datë 09.07.2014, i shoqëruar me relacionin përmbledhës dhe detajimin e përllogaritjes së fondit të pagave, numrin e punonjësve, shpenzimet për mallra dhe shërbime, planifikimi i investimeve mbështetur në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë nr.4209 datë 16.06.2014. Përllogaritjet në zërin paga e sigurime shoqërore, janë kryer duke u mbështetur në numrin e punonjësve të strukturës së miratuar dhe në zbatim të VKM-ve në fuqi ku është parashikuar një rritje prej 4% (në raport me vitin ushtrimor) në fondin e pagave si rezultat i vjetërsisë së punës nga punonjësit e spitalit, orëve jashtë orarit dhe si pasojë e ndryshimit të strukturës duke shtuar numrin e mjekëve specialist. *Përllogaritjet në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime nuk është detajuar në mënyrë të hollësishme sipas kërkesave të MSH. Në relacion nuk është përshkruar gjëndja e detyrimeve të palikujduara në fillim të vitit 2014 dhe ecuria e shlyerjes së tyre si dhe nuk është përshkruar as planifikimi i të ardhurave dytësore të SRGJ. Lidhur me shpenzimet për “barna dhe materiale mjekësore” (shpenzime këto që gjatë viteve 2015-2017 janë rritur ndjeshëm) nuk është bërë një detajim dhe ose analizë e këtij zëri. Konkretisht në relacion është cituar si më poshtë: ...“Rritja me vlera të mëdha është në zërin “barna dhe materiale mjekësore”, kërkesa për këtë zë është vazhdimisht në rritje. Mungesa në vite dhe sot e në vazhdim bën të mundur rritjen e kërkesës për këtë zë”*.

-Shkresat për miratimin dhe ndryshimet në planifikim:

Në tabelën e më poshtme janë shkresat e Buxhetit të miratuar për vitin 2015 në Spitalin Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastër bashkë me ndryshimet dhe lëvizjet përkatëse dhe plani përfundimtar sipas përmbajtjes së shkresave me autorizimet përkatëse për fondet në dispozicion për tu shpenzuar:

Nr prot, Dt.	600	601	602	606	231
Shkresa nr.1808, dt.8.01.2015	155,535,000	26,000,000	76,470,000		
Të dhëna nga thesari	(115,555)			115,555	
Shkresa nr.140/34, dt.14.01.2015					15,250,000
Shkresa nr.1140/1, dt.27.01.2015	3,406,000	542,000	35,533,000		
Shkresa nr.3307/1, dt.04.03.2015			630,000		
Shkresa nr.2671/5, dt.24.06.2017			2,352,064		
Të dhëna nga thesari			347,873		
Shkresa nr.11490/1, dt.05.08.2015					116,000,000
Shkresa nr.11670/2, dt.21.08.2015		(600,000)	7,000,000		
Shkresa nr.14210/1, dt.15.10.2015					(17,638,000)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Shkresa nr.4952/3, dt.05.11.2015					(12,999,000)
Shkresa nr.4952/3, dt.05.11.2015					
Shkresa nr.15773/1, dt.13.11.2015	(4,000,000)		2,000,000		
Shkresa nr.3947, dt.24.12.2015	1,150,000		970,000		
Plani përfundimtar	155,975,445	25,942,000	125,302,937	115,555	100,613,000

Burimi i të dhënave: Shkresat e miratimit të buxhetit, situacionet progresive të Thesarit

Mbështetur në planin përfundimtar dhe në realizimin përfundimtar sipas situacioneve progresive të Thesarit për vitin 2015 kemi të dhënat si më poshtë:

Llogaritë	Plan	Fakt	Realizimi
600	155,975,445	153,738,646	99%
601	25,942,000	24,880,507	96%
602	125,302,937	120,378,753	96%
606	115,555	115,555	100%
231	100,613,000	100,611,600	99%

Burimi i të dhënave: Situacionet progresive të Thesarit

Edhe pse struktura për vitin 2015 nuk ka ndryshuar nga ajo në vitin 2014 nuk është arritur të bëhet një planifikim në masën 100% me vlerën e realizimit. Lidhur me llogarinë 602 janë trajtuar në mënyrë të përmblëdhur disa nga shpenzimet operative të realizuara sipas planifikimit fillestar në PBA dhe pasqyrës së realizimit sipas thesarit me burim financimin nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat dytësore:

-	-	PBA	Situacioni	Te ardhura dytesore	Shpenzimi total
602	<i>Mallra dhe sherbime te tjera</i>	<i>137,719,000</i>	<i>120,378,753</i>	<i>1,996,850</i>	<i>122,375,603</i>
6020	<i>Materiale dhe sherbime zyre dhe te pergjithshme</i>	<i>8,388,000</i>	<i>7,166,257</i>		<i>7,166,257</i>
6021003	<i>Ilaçe dhe materiale mjekesore</i>	<i>75,000,000</i>	<i>60,384,968</i>	<i>286,560</i>	<i>60,671,528</i>
6023	<i>Sherbime transporti</i>	<i>6,565,000</i>	<i>5,503,224</i>	<i>1,384,862</i>	<i>6,888,086</i>
6024	<i>Shpenzime udhetimi</i>	<i>3,700,000</i>	<i>4,801,100</i>		<i>4,801,100</i>
6025	<i>Shpenzime per mirembajtje te zakonshme</i>	<i>15,255,000</i>	<i>11,409,543</i>	<i>194,400</i>	<i>11,603,943</i>
6025200	<i>Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike</i>		<i>2,517,600</i>		<i>2,517,600</i>
6025300	<i>Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore</i>	<i>2,625,000</i>	<i>1,358,628</i>		<i>1,358,628</i>
6025500	<i>Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave te punes</i>	<i>8,400,000</i>	<i>6,335,715</i>	<i>194,400</i>	<i>6,530,115</i>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

6025600	Shpenzimeve per mirembajtjen e mjeteve te transportit	3,700,000	1,197,600		1,197,600
6025800	Shpenzime per mirembajtjen e pajisjeve te zyrave	530,000			
6029003.00	Shpenzime gjyqesore		1,233,100		1,233,100
6029008.00	Shpenzime per tatime & taksa te paguara nga institucioni			33,948	33,948

Nga tabela e mësipërme konstatohen ndryshime në realizimin e disa shpenzimeve operative të cilat nuk kanë qenë të planifikuara në PBA e vitit përkatës. Nga ana tjetër konstatohet realizimi i shpenzimeve në një shumë më të vogël sesa ajo e paraqitur në PBA e cila është e kushtëzuar nga çelja paraprake. Vlerat të cilat janë shpenzuar në buxhetin e vitit 2016 për të cilat nuk është planifikuar në fillim të vitit ose është planifikuar shumë më tepër nga se është realizuar. Nga këto diferenca të realizuara konstatohet një planifikim jo i saktë i nevojave të vitit të pritshëm buxhetor si pasojë e ndryshimit të niveleve të realizimit. Planifikimi kryhet në bazat e një përqindje të caktuar në rritje në krahasim me shpenzimin faktik të vitit të kaluar.

Për vitin 2016 SRGJ ka dërguar projektbuxhetin me shkresën nr.388 datë 21.07.2015 të shoqëruar me relacionin përmbledhës në shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë nr.2164 datë 06.05.2015. Argumentimi i parashikimit të shpenzimeve të pagave dhe për mallra e shërbime është i njëjtë me relacionin e vitit të më parshëm pa u bërë asnjë ndryshim në analizën e këtyre shpenzimeve për vitin aktual. Shpenzimet për “mallra dhe shërbime” (Ilogaria 602) janë rritur 10% më shumë se viti paraardhës. Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të dhënat nga thesari për ndryshimet dhe lëvizjet për vitin 2016 për fondet në dispozicion për tu shpenzuar por dokumentacioni i shkresave që autorizon ndryshimet e më sipërme nuk u vu në dispozicion nga sektori i financës duke bërë që lëvizjet të mos jenë të justifikueshme në mënyrë shkresore.

Nr prot, dt	600	601	602	606	231
Shkresa nr.1776/1 dt.29.01.2016	147,700,000	24,700,000	86,000,000		
mars	6,900,000	1,152,000	41,884,000		
mars	(195,360)			195,360	
prill	(30,000)			30,000	48,267,200
qershor	(30,000)			30,000	
korrik	(46,403)			46,403	
gusht			822,000		
shtator			2,000,000		11,500,000
tetor					
nentor	(800,000)	-400000	1200000		
dhjetor	1300000		5,600,000		



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

P.përfundimt ar	154,798,237	25,452,000	137,506,000	301,763	59,767,200
------------------------	--------------------	-------------------	--------------------	----------------	-------------------

Burimi i të dhënave: Shkresat e miratimit të buxhetit, situacionet progresive të Thesarit

Realizimi përfundimtar krahasuar me planin përfundimtar rakorduar sipas situacioneve progresive të Thesarit për vitin 2016 paraqitet:

Llogaritë	Plan	Fakt	Dif
600	154,798,237	154,485,871	99%
601	25,452,000	25,218,378	99%
602	137,506,000	136,221,970	99%
606	301,763	301,763	1
231	59,767,200	59,767,004	99%

Burimi i të dhënave: Situacionet progresive të Thesarit

Mbështur në të dhënat e marra nga situacioni progresiv i thesarit për vitin 2016 shpenzimet e parashikuara respektivisht për zërat më sipër janë realizuar thuajse në masën 100% për vitin 2016.

Për vitin 2017 SRGJ ka dërguar projekt buxhetin me shkresën nr.383/1 datë 21.07.2016 të shoqëruar me relacionin përmbledhës, mbështetur me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë nr.3338 datë 15.06.2016. ***Rezultoi se në relacionin shoqërues nuk është bërë argumentimi dhe analizimi për rritjen në masën 5% krahasuar me vitin 2016 të shpenzimeve për “barna dhe materiale mjekësore, shpenzime këto që përbëjnë pjesën më të madhe të llogarisë 602”.***

Një pjesë e shkresave të Buxhetit për ndryshimet gjatë vitit 2017 të fondeve të planifikuara nuk u vu në dispozicion nga sektori i financës. Lëvizjet sipas tabelës së më poshtme:

Nr prot, dt	600	601	602	606
Shkresa nr.18 dt.11.01.2017	152,600,000	24,320,000	88,850,000	
kaluar ne 606	(183,110)			183,110
Shkresa nr. 695 dt.14.02.2017	6,900,000	1,152,000	41,884,000	
shkurt 2017	(30,000)			30,000
qershor	(88,300)			88,300
shtator	(41,510)			41,510
nentor	21,500,000	3,800,000		
dhjetor	(97,085)			97,085
29.12.2017			11,240,000	
Shkresa nr.15773/1 dt.13.11.2015				
Shkresa nr.3947/ dt.24.12.2015				
Plani përfundimtar	180,559,995	29,272,000	141,974,000	440,005

Burimi i të dhënave: Shkresat e miratimit të buxhetit, situacionet progresive të Thesarit

Rezultatet e krahasimit të realizimit me planifikimin përfundimtar sipas situacioneve progresive të Thesarit për vitin 2017 janë si më poshtë:

Llogaritë	Plan	Fakt	Dif
600	180,559,995	178,072,099	98%



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

601	29,272,000	28,904,063	98%
602	141,974,000	134,591,912	94%
606	440,005	432,942	98%
231	-	-	-

Burimi i të dhënave: Situacionet progresive të Thesarit

Mosrealizimi më i madh për vitin 2017 është në llogarinë 602 për të cilën është bërë detajimi si më poshtë:

<i>Emertimi</i>	<i>PBA</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>Të ardhurat dytësore</i>	<i>Shpenzime ne total</i>
<i>Mallra dhe sherbime te tjera</i>	<i>138,830,000</i>	<i>141,974,000</i>	<i>134,591,912</i>	1,419,310	136,011,222
<i>Materiale dhe sherbime speciale</i>	<i>87,700,000</i>	<i>87,180,545</i>	<i>87,180,545</i>	349,200	87,529,745
Ilaçe dhe materiale mjekesore	81,600,000	82,533,033	82,609,001	349,200	82,958,201
Sherbime nga te trete	23,180,000	28,762,791	28,762,793	141,498	28,904,291
<i>Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave te punes</i>	-	<i>8,534,180</i>	<i>1,152,090</i>	-	<i>1,152,090</i>

Nga ku konstatohet mosrealizimi më i madh për zërin ‘**Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, pajisjeve teknike**’. Një pjesë e llogarive paraqitur më sipër janë në tejkallim të parashikimit fillestar që rezulton në një parashikim jo të saktë të nevojave gjatë vitit buxhetor. I njëjti fakt konstatohet edhe në shpenzimet e realizuara nën planifikimin fillestar, ku për disa llogari analitike të shpenzimeve sipas planifikimit të bërë në fillim të vitit nuk janë realizuar tërësisht nga zërat e buxhetit, por dhe nga të ardhurat dytësore si llogaria ‘Ilaçe dhe materiale mjekësore’.

Për vitin 2018 SRGJ ka dërguar projekt buxhetin me shkresën nr.365 datë 07.07.2017 të shoqëruar me relacionin përmbledhës dhe detajimin e përlllogaritjes së fondit të pagave, numrin e punonjësve, shpenzimet për mallra dhe shërbime, planifikimin e investimeve mbështetur me shkresën e Ministrisë së Shëndetësisë nr.2855 datë 07.06.2017.

Bazuar në realizimin e shpenzimeve të buxhetit të SRGJ, referuar planifikimit të tij, konstatohet se janë kthyer tepriçë fondesh në buxhet respektivisht për vitin 2015 vlera prej 8,222,476 lekë, për vitin 2016 vlera 2,089,156 lekë dhe për vitin 2017 vlera 10,244,984 lekë, Nga sa më sipër konstatohet një planifikim jo i saktë i nevojave të vitit të pritshëm buxhetor si pasojë e ndryshimit të niveleve të realizimit. Planifikimi kryhet në bazat e një përqindje të caktuar në rritje në krahasim me shpenzimin faktik të vitit të kaluar.

IV. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Auditimi i zbatimit të strukturës organizative sipas miratimit të Ministrisë së Shëndetësisë për periudhën objekt auditimi si dhe rregullshmëria e procedurave të rekrutimit dhe largimit nga puna për SRGJ. Gjithashtu objekt i këtij atverifikimi është përlllogaritja e pagave sipas elementeve përbërës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga verifikimi rezultoi që:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Gjatë periudhës objekt auditimi është bërë disa herë ndryshimi i strukturës së institucionit Spitali Rajonal Gjirokastrë “Omer Nishani” (SRGJ) konkretisht:

-Për vitin 2015 është zbatuar struktura e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë (MSH) me shkresën nr.4492 prot, datë 02.07.2014 me 260 punonjës gjithsej.

-Për vitin 2016 është miratuar struktura nga MSH me shkresën nr.259/1 prot, datë 18.01.2016 me 274 punonjës gjithsej.

-Për vitin 2017 është miratuar struktura nga MSH me shkresën nr.1467/1 prot, datë 15.03.2017 me 276 punonjës gjithsej.

- Për vitin 2018 është në zbatim ende struktura e vitit 2017 pasi nuk është miratuar ende projekt struktura e dërguar për miratim me shkresën nr.115 prot, datë 05.02.2018.

Zbatimi i strukturës organizative dhe shpenzimet për paga gjatë periudhës objekt auditimi (2015-2017) paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017
Paga, shperblime e shpenz. personeli	153,738,646	154,485,871	178,072,099
Kontribute shoqerore e shendetesore	24,880,507	25,218,378	28,904,063
Shpërblime personeli	0	998,686	1,129,667
Numri mesatar i punonjësve	260	268	266
Numri i miratuar i punonjësve	260	274	276

Nga auditimi me zgjedhje i muajve për verifikimin e strukturës plan-fakt konstatohet se ka lëvizje të pozicioneve brënda strukturës, por duke ruajtur numrin e përgjithshëm të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Lidhur me Shërbimin Spitalor të SRGJ në pjesën më të madhe të reparteve të shërbimit spitalor ka mangësi personeli në pozicionin e mjekut dhe kjo është zëvendësuar me rritjen e numrit të infermierëve dhe laborantëve duke bërë kështu që të devijohet nga struktura e miratuar nga MSH. Mungesa e mjekëve specialist në reparte të rëndësishme mund të shkaktojë probleme të rënda në mbarëvajtjen e këtij shërbimi. Devijimi nga struktura nuk është bërë me miratim nga Ministria e linjës por vetëm me urdhër të titullarëve. Lidhur me pjesën e administratës, sektorin teknikës, hotelerisë dhe mjedisit në periudha të caktuara ka patur tejkalim të numrit të strukturës nga ajo e miratuar. Konkretisht për vitin 2016 numri i miratuar për këto tre sektor është 105 punonjës ndërkohë që numri total faktik për muajin prill 2016 është 116 punonjës. Ku, rezultojnë 39 sanitare të rekrutuara nga 30 të miratuara dhe shtim në stafin e hotelerisë dhe mjedisit. Përparësi për SRGJ duhet të jetë plotësimi i Shërbimit Spitalor me stafin e nevojshëm dhe jo shtimi i administratës spitalore dhe sektorëve të hotelerisë dhe mjedisit.

Rregullorja e miratuar me shkresën nr.4884, datë 31.12.2008 me të cilën ka funksionuar Spitali Rajonal i Gjirokastrës është e papërshtatur me ndryshimet e bëra në strukturë gjatë viteve të fundit duke krijuar pengesë në mirëfunksionimin administrativ të institucionit. Gjithashtu kriteret e cituara në rregullore nuk janë aspak të qarta lidhur me detyrat e secilit pozicion duke qenë pengesë jo vetëm në procesin e administrimit por dhe të rekrutimit të stafit të ri në SRGJ.

Janë audituar 20 dosje për persona të punësuar të cilët janë pjesë e strukturës për periudhën objekt auditimi dhe janë konstatuar mangësi në dokumentacion. Më konkretisht rastet më të hasura kanë qenë mungesa e kërkesës dhe Cv, libreza e punës (7 raste), janë konstatuar mangësi në procedurën



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

e përzgjedhjes së aplikantëve dhe të emërimit në SRGJ, si psh: kandidati fitues nuk plotëson të gjitha kushtet e shpallura në njoftim, mungon shpallja e njoftimit për vende vakante dhe përcaktimi i kriterëve për disa raste, procesverali i vlerësimit me pikë i intervistës dhe kriterëve të vlerësimit nga komisioni ad-hoc, si dhe urdhrat e emërimit nuk ka pagën të specifikuar duke mos respektuar të gjitha kriteret e Urdhërit Nr.511 datë 13.12.2011 të Ministrisë së Shëndetësisë, “Për kriteret e punësimit në shërbimin shëndetësor publik”. Emërimet dhe largimet e punonjësve në SRGJ janë në mospërputhje me Urdhrin Nr.506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qera të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore” pika 1 dhe 2. Më konkretisht në tabelën e më poshtme rezultatet e dosjeve:

Personeli	Periudha	Pozicioni	Problematika në dosjen personale për marrjen në punë.
L.P	01.10.1998- 28.04.2016	k/laborante	I vetmi dokumentacion në dosje ishte urdhri infermierit i panoterizuar.
J.B	27.05.2016-vazhdon	Specialist It	Mungojnë: Miratim i Ministrit, proceverbali i testimit.
K.C	20.12.2017-Vazhdon	Përgjegjës Sektorit IT	Mungojnë: Miratim i Ministrit, procesverbali i testimit, njoftimi i pozicionit vakant.
Sh.K	1.12.2016- 16.05.2017	Infermiere	Mungojnë: Miratim i Ministrit, nuk përputhet ekperienca sipas njoftimit.
B.A	29.05.2017	Arkivist	Mungojnë:procesverbali i testimit, dhe CV
K.S	18.08.2017-vazhdim	Kaldaist	Mungojnë: Miratim i Ministrit, procesverbali i testimit, njoftimi pozicionit vakant, CV
A.L	02.11.2017-vazhdim	Infermiere zv	I vetmi dokumentacion në dosje është urdhri i emërimit nga titullari.
A.K	22.02.2017- 31.07.2017	Mjeke	Mungojnë: Kopje kontrate, procesverbal testimi, Miratim i Ministrit
A.C	22.08.2017-vazhdim	Pergjegjes stat/kosto	Mungojnë: procesverbal testimi, Miratim i Ministrit, njoftimi pozicionit vakant,
L.Q	09.01.2018-vazhdim	Pergjegjes setori teknik	Mungojnë: Miratimi i Ministrit, Zgjatja e kontratës, procesverbali testimit, nuk përputhet profesioni me njoftimin.
A.L	23.08.2017-vazhdim	infermiere	Mungojnë: Miratimi i Ministrit, CV
H.XH	04.04.2017-vazhdim	Jurist	Mungojnë: Miratim i Ministrit, Kopje kualifikimi, Raport mjekoligjor, CV
K.G	16.03.2017- 28.09.2018	Infermier urgjence	Mungojnë: Miratimi i Ministrit, procedura e largimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

M.M	27.02.2017- 26.04.2017-vazhdim	Spec.Sektorin teknik	Mungojnë: Njoftimi, procesverbal testimi, Miratim Ministri
K.P	08.03.2018-vazhdim	Infermiere	Mungojnë: Miratim Ministri, procesverbali i testimit
Sh.T	27.10.2016-vazhdim	mjek urgjence	Mungojnë: procesverbal testimi, Miratimi i Ministrit
M.SH	10.08.2016- 11.05.2018	mjeke	Mungojnë: Miratim i Ministrit, zgjatja e periudhës së kontratës
D.J	16.03.2017-vazhdim	Infermiere-mami	Mungojnë: procesverbali testimit, Miratimi i Ministrit. Shpallja e pozicionit
E.A	19.02.2016-vazhdim	Mjeke jashtme(Roje)	Mungojnë; procesverbal i testimit, Miratimi i Ministrit, Shpallja e pozicionit
A.Q	29.12.2017- 28.03.2018	Farmaciste	Mungojnë: procesverbali i testimit, shpallja e pozicionit, Miratimi i Ministrit.

Lidhur me problemet e evidentuara në dosjet e personelit mban përgjegjësi ish përgjegjëse e Burimeve Njerëzore të SRGJ Zj. Z.Q.

Nga verifikimi i procedurave të largimit nga puna të punonjësve të SRGJ rezultoi se procesverbali i komisionit për largim nga puna për një pjesë të punonjësve nuk citonte arsyen e largimit por vetëm vendimin e komisionit të ngritur. Nga 27 çështje gjyqësore kundrejt Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë, 14 çështje kanë përfunduar me Vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, duke detyruar SRGJ të njohë shpenzime gjyqësore për dëmshpërblimin financiar të punonjësve në **shumën 8,369,278 lekë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.**

Spitali Rajonal i Gjirokastrës si nevojë e pajisjes me mjekë roje për shkak të ngarkesës e cila nuk mund të mbulohet nga mjekët me kohë të plotë ka lidhur kontratë me 11 mjekë vullnetarë për vitin 2015, 8 për vitin 2016 dhe 7 për vitin 2017 në mbështetje të VKM nr. 18 datë 11.01.2017 “Për financimin e shërbimeve spitalore nga Skema e Detyrueshme e Kujdesit Shëndetësor për vitin 2017” të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Lidhur me auditimin e listpagesave

Në llogaritjen e pagave është respektuar VKM nr.1035 datë 27.11.2013 për disa shtesa e ndryshime në VKM nr.555 datë 11.08.2011 Për miratimin e strukturës dhe pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe punonjësve të infermierisë së Sistemin e MSH”, VKM nr.690 datë 09.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mëshitetës të institucioneve buxhetore”, I ndryshuar, ligji nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore”, I ndryshuar dhe ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar. Lidhur me dokumentacionin justifikues janë plotësuar gjithë listëprezencat mujore dhe listëpagesat janë firmosur nga specialistja e pagave, specialistja e burimeve njerëzore, shefja e financës dhe drejtori I institucionit. Gjithashtu në cdo listëpagesë janë evidentuar bashkëlidhur urdhrat e titullarit lidhur me rekrutimet e reja ose shkeputjet e marrëdhënieve financiare.

V.Auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlerë të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit etj).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Bazuar në auditimin me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që:

Nga auditimi i veprimeve të kryera në ditarin e bankës, urdhërpagesat ishin pasqyruar drejt nëpër llogaritë sintetike e analitike, sipas natyrës së shpenzimit, duke vepruar konform me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, me udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga shpenzimet e kryera për karburantin rezultoi se:

Janë kryer pagesa nëpërmjet bankës për kontrata furnizimi me karburant në të gjitha rastet pa paraqitur deklaratën doganore SAD të Operatorit Ekonomik, mbi bazën e të cilit do të llogaritej çmimi për njësi i karburantit, referuar datës së hyrjes së tij në pikën doganore Gjithashtu në llogaritjen e vlerës së faturës është vendosur dhe taksa e markimit në vlerën 0.614 lekë/litër e cila nuk parashikohet në Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar. Gjithashtu nga titullari i SRGJ-së në asnjë rast nuk është ngritur komision për mbikqyrjen e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IX, neni 77, pika 5 dhe 6.

Nga auditimi i shpenzimeve të karburantit u shqyrtuan dokumentacioni sipas tabelës më poshtë, mbi të cilën është janë llogaritur vlerat e taksës së markimit të paguara ndaj secilit OE fitues;

	Urdh. shpenz. nr	Datë	Likujd fatura nr	Datë	Vlera	Op. Ekon. fitues	Fletë hyrja nr	Datë	Sasi	Vlerë
1	331	29.08.2017	24	07.08.2017	814,900	K	7	07.08.2017	5000	3070
2	508	12.12.2017	427	09.11.2017	895,170	FP	10	09.11.2017	5630	3457
3	276	28.07.2017	11	06.06.2017	976,032	K	5	06.06.2017	6000	3684
4	186	07.06.2017	20	13.04.2017	899,447	K	4	13.04.2017	5620	3450
5	63	06.03.2017	121	03.02.2017	959,737	G	2	03.02.2017	6130	3763
6	21	07.02.2017	22	04.01.2017	628,113	K	1	04.01.2017	3596	2208
7	68	04.03.2016	645	04.12.2015	155,376	E	6	04.12.2015	1000	614
8	69	04.03.2016	657	11.12.2015	187,656	E	7	11.12.2015	1270	780
9	70	04.03.2016	687	27.12.2015	259,334	E	9	27.12.2015	1830	1123
10	71	17.03.2016	04	05.01.2016	178,686	E	1	05.01.2016	1250	767
11	175	12.05.2016	14	29.03.2016	558,399	K	4	29.03.2016	3960	2431
12	101	17.03.2016	88	18.02.2016	799,582	K	3	18.02.2016	5780	3550
13	202	15.06.2016	68	12.05.2016	1,236,480	K	5	12.05.2016	8000	4912
14	319	09.09.2016	21	01.08.2016	1,234,200	K	6	01.08.2016	8000	4912
15	433	15.11.2016	94	13.10.2016	661,574	K	7	13.10.2016	4056	2490
16	508	22.12.2016	18	25.11.2016	746,800	AD	8	25.11.2016	5000	3070
								Totali		44,281

Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Gjirokastrë

Shuma totale e mësipërme prej **44,281 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, e cila është përfitim i padrejtë nga Operatorët Ekonomikë.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi drejtuesit e SRGJ z.K.K, z.P.M si dhe shefen e financës znj.D.T.

Shpenzimet për automjetet.

Spitali Rajonal Gjirokastrë disponon 9 automjete sipas tabelës më poshtë.

Nr	Shoferi	Automjeti tip	Vit prodhimi	Shasia nr	Targa
1	S.G	Iveko	1999	ZCFC3652005255369	GJ6236A



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

2	E.M	Mercedes Benz	1990	ËDB1241281B206200	AA366EJ
3	H.V	Mercedes Benz Sprinter	2005	ËDB9026621R775343	GJ8744A
4	M.K	Mercedes Benz Sprinter	2005	ËDB9026611R781049	GJ8745A
5	H.P	Mercedes Benz Sprinter	2005	ËDB9026611R784620	GJ8749A
6	B.ZH	Mercedes Benz Sprinter	2005	ËDB9026611R780141	GJ8752A
7	T.D	Mercedes Benz Sprinter	2005	ËDB9026611R777344	AA335FS
8	V.L	FIAT DUCATO	1987	ZFA29000000481629	GJ4755A
9	V.H	Volkswagen Crafter	2014	ËV1ZZZ2EZ024342	AA972KX

Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Gjirokastrë

Në lidhje me automjetet që ka në dispozicion rezulton se, për automjetin tip mercedes benz me targë AA 366 EJ, referuar lejes së qarkullimit, nuk janë paguar detyrimet e taksave dhe kontrollit fizik për vitin 2016, 2017 dhe vitin 2018, veprime për të cilat sistemi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastrë do të gjenerojë gjoba, veprime kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi z.F.D dhe L.Q në cilësinë e kryetarit të degës teknike, si dhe shoferi E.M.

-Në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, shpenzimeve për goma, bateri, servise etj., për periudhën objekt auditimi referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se nga Dega Teknike, nuk janë mbajtur kartelat përkatëse për çdo mjet, ku të jenë të evidentuara të dhënat teknike të mjetit, defektet e konstatuara, shërbimet e kryera periodike etj.

Gjithashtu për automjetet nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj., shpenzime të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, pra nuk ka një metodologji të përcaktuar për ndjekjen e shpenzimeve për mirëmbajtje dhe shfrytëzimin e tyre, si dhe për gjurmën standarte të auditimit. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion për vitin 2017 rezulton se shpenzimet për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve janë kryher në fund të vitit në muajt nëntor-dhjetor për të gjitha automjetet. Nga këto dokumente duket qartë se riparimet nuk kryhen në momentin e bërjes së dokumentacionit, por ato kryhen më parë dhe në fund të vitit bëhet likuidimi i tyre, ç'ka tregon një kryerje joreale të bërjes së dokumentacionit, nga ana e Kryetarit të Degës Teknike, Shoferëve të automjeteve, dhe nga mosndjekja në mënyrë periodike e shpenzimeve nga Përgjegjësjë e Degës së Financës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, "Menaxhimi i aktiveve të njësitë e sektorit publik", pikat 19, 26, 35, 121, 122.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi z. F.D dhe L.Q, në cilësinë e kryetarit të degës teknike sipas periudhës përkatëse, znj.D.T në cilësinë e P.Deg.Financës, z.A.B dhe z. M.G në cilësinë e nëndrejtorit ekonomik si dhe shoferët e automjeteve të përmendur më sipër.

-Në lidhje me njohjen e detyrimeve në kontabilitet për shpenzimet gjyqësore, vendimet e Gjykatës së Apelit dhe vendimet e Gjykatës së shkallës së parë të Rethit Gjyqësor Gjirokastrë, konstatohet se;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se janë njohur shpenzime për vendime gjyqësore të cilat janë njohur në kontabilitet, detyrime të cilat SRGJ duhet t’u paguajë punonjësve të larguar, për të cilat jepen të dhënat si më poshtë;

Nr	Emer mbiemer	Vendimi i gjykates se Apelit (Rethi), nr. Date.	Drejtori i cili e ka larguar	Drejtor kur ka ardhur vendimi dhe është njohur detyrimi	Vlera sipas Vendimit te gjykates	Shpenz permb.	Vlera Totale
1	A.N	Nr 21-2013-103/35dt 23.01.2013	G.S	A.M	1,004,950		1,004,950
2	Dh.M	Nr 1216 dt 07.07.2014	A.M	A.M	219,150		219,150
4	E. H	Nr 1293 dt 4.06.2015	A.M	K.K	632,394	42,496	674,890
5	Gj.M	Nr. (86-2006-755) Dt.26.10.2016	A.M	K.K	614,409	73,729	688,138
6	A.B	Nr. 3331 Dt 12.10.2016	A.M	K.K	340,080	5,000	345,080
7	E.L	Nr 3300 Dt.11.07.2017	A.M	P.M	518,082	62,170	580,252
8	A. R	Nr.2800 Dt.20.06.2017	K.K	P.M	465,819	9,252	475,071
9	M.B	Nr.1387(86-2017-1381) Dt.05.04.2017	A.M	K.K	822,514	98,702	921,216
10	Th.B	Nr.4419 Dt.20.12.2016	K.K	K.K	1,970,596	113,509	2,084,105
11	Sh.M	Nr.933 Dt.06.03.2018	A.M	R.K	751,720	90,206	841,926
12	N.N	Nr.(20-2018-33/19) Dt.17.01.2018	P.M	R.K	369,765	36,000	405,765
13	D.Q	Nr.(21-2018-157/60) Dt.01.02.2018	P.M	R.K	71,319	18,000	89,319
14	R.J	Nr.(20-2018-254/177) Dt.15.03.2018	P.M	R.K	588,480	0	588,480
Totali					8,369,278	549,064	8,918,342

Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Gjirokastrë

Për periudhën objekt auditimi janë njohur në kontabilitet shpenzime për vendime gjyqësore për punonjës të larguar nga drejtuesit e institucionit duke detyruar punonjësit të ndjekin procedurat ligjore duke paditur SRGJ në Gjykatë, nga të cilat 14 çështje kanë përfunduar me Vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit duke e detyruar Spitalin Rajonal Gjirokastrë të paguajë vlerën **8,369,278 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit**, e cila përbën një keqpërdorim të shpenzimeve në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

(Nga punonjësit e larguar sipas tabelës më sipër janë likuiduar 3 punonjësit e parë konkretisht A.N Dh.M, E dhe H në shumën 1,898,990 lekë, pra shuma e palikuiduar është 8,369,278-1,898,990=7,019,353 lekë)

Gjithashtu nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar detyrime përbarimore për 9 punonjësit e larguar, në shumën **549,064 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, e cila përbën një keqpërdorim të shpenzimeve në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin z. G.S, ish-drejtorin z.A.M, ish-drejtorin z.K.K, ish-drejtorin z.P.M dhe ish-drejtorin z.R.K.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Njëkohësisht bazuar në të dhënat e SRGJ konstatohet se nga largimet e punonjësve nga puna është paditur institucioni nga punonjësit si më poshtë vijon;

Nr	Emër Mbiemër	Vendimi I Gjykatës së shkallës së parë	Drejtori i cili e ka larguar	Paga të fituara me vendim të shkallës së parë	Paga mujore	Totali në vlerë
1	B. K	Nr.170 (21-2018-516) Dt.29.03.2018	R.K	12.5	38,407	480,088
2	G. H	Nr.174 (21-2018-521) Dt.30.03.2018	R.K	13	40,977	532,701
3	V.S	Nr.(21-2018-491/165) Dt.27.03.2018	P.M	8.5	49,752	422,892
4	Z.Q	Nr.(21-2018-583) Dt.10.04.2018	R.K	14	57,960	811,440
7	E.C	Nr.465 (14-7-2016)	K.K	9.5	26,885	255,408
8	F.SH	Nr.633 Dt.18.10.2016	K.K	9.5	51,770	491,815
9	A. Sh	Nr.367 Dt.06.06.2016	A.M	8	43,280	346,240
12	V.N	Nr (210 /21 -2018-601)DT 12.04.2018	R.K	19.5	48,459	944,951
13	A.S	Nr 231(21-2018-698) DT26.04.2018	R.K	17	45,420	772,140
Totali						5,057,674

Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Gjirokastrë

Në lidhje me të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësit, Spitali Rajonal Gjirokastrë është paditur në Gjykatë nga 13 punonjës të cilët janë në proces gjykimi dhe referuar Vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë pretendohet se e kanë fituar këtë shkallë të gjyqimit duke kërkuar nga SRGJ një dëmshpërblim në vlerë totale **5,057,674 lekë, shumë e cila do të sjellë një efekt negative financiar të pritur për buxhetin e shtetit**, e cila përbën një keqpërdorim të shpenzimeve në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-Drejtorin e SRGJ z. R.K, ish-Drejtorin z.P.M, ish-drejtorin z.A.M dhe ish-drejtorin z.K.K.

Me urdhër shpenzimin nr. 174, datë 12.05.2016 është likuiduar për llogari të (QKEV) shuma prej 10,000 lekë. Ky shpenzim është kryer në zbatim të urdhërit nr. 227, datë 12.05.2016, të drejtorit të SRGJ z.K.K në të cilin citohet se “Në mbështetje të rregullores së brendshme të funksionimit të Spitalit Rajonal Gjirokastrë, për mbarvajtjen e punës në sektorin e financës”, Urdhëroj; Të përdoren 10,000 lekë nga llogaria 602 i të ardhurave dytësore të krijuara në institucionin tonë për të likuiduar faturën për arkëtim nr. 1154, datë 09.05.2016 e cila nuk është faturë tatimore, me institucion përfitues QKEV. Ky shpenzim është i pabazuar ligjërisht dhe pa asnjë dokumentacion justifikues, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Menaxhimi i aktiveve të njësitë e sektorit publik”. **Shuma prej 10,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Veprimi i mësipërm ngarkon me përgjegjësi drejtorin e SRGJ z.K.K.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Me urdhër shpenizmin nr. 169, datë 11.05.2016, është likuaduar në shumën 6,600 lekë për llogari të A.C sha.,vetëm me një dokument në po të njëjtën vlerë, pa asnjë dokumentacion shpjegues, justifikues dhe pa procedurë prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Menaxhimi i aktiveve të njësitë e sektorit publik”. **Shuma prej 6,600 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi drejtorin e SRGJ z.K.K dhe znj.D.T në cilësinë e nëpunësit zbatues.**

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,
- 2) Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,
- 3) Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.
- 4) VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IX, neni 77
- 5) Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z.A.M me detyrë, ish-Drejtor i SRGJ në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 2) Z. K.K me detyrë ish- Drejtor i SRGJ në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 3) Z.G.S me detyrë, ish-drejtor i SRGJ, në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 4) Z.P.M me detyrë ish- Drejtor i SRGJ në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 5) Z.R.K me detyrë ish-Drejtor i SRGJ në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 6) Z.A.B me detyrë zv/drejtor në cilësinë e nëpunësit zbatues.
- 7) Z.M.G me detyrë zv/drejtor në cilësinë e nëpunësit zbatues.
- 8) Znj. D.T me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës në cilësinë e nëpunësit zbatues.
- 9) Z.F.D, në cilësinë e Kryetarit të degës teknike.
- 10) Z.L.Q në cilësinë e Kryetarit të degës teknike.

Në observacionet e dërguara me shkresat nr. 1244 prot, datë 10.04.2018, nr. 1228, datë 06.04.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Gjirokastër, nga punonjësit znj. A.M, znj.A.M, znj.E.M dhe znj.M.N në lidhje me akt-konstatimin nr.4, në të cilin citohet se;

Në lidhje me observacionin e personave të përmendur në akt-konstatim, mbi pretendimin se për dy procedurat e blerjeve të vogla të kryera në vitin 2016, nuk kemi marrë pjesë në planifikimin e regjistrit të parashikimeve, dhe kemi zbatuar urdhrin e prokurimit të dalë nga titullari i SRGJ, sqarojmë se:

Përgjigje:

Përsa i përket observacionit vlen të theksohet se panvarësisht parashikimit të bërë në regjistrin e prokurimeve, duhet të zbatohet me përpikmëri Ligji i Prokurimit, Vkm dhe aktet e dala në fuqi, por në lidhje me urdhrin e ngritur nga titullari, përgjegjësia personale në funksion të observacionit, merret në konsideratë.

Në lidhje me observacionin e personave të përmendur në akt-konstatim, mbi pretendimin se për dy procedurat e blerjeve të vogla të kryera në vitin 2016, për shumën 1,594,973 lekë, sqarojmë se panvarësisht regjistrin të parashikimit, këto dy procedura duhet të kryeshin në një të vetme pasi bëhet fjalë për të njëjtin grupmallrash. Gjithashtu në lidhje me procedurat e prokurimit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

kryera në vitin 2017, për shumën 1,600,000 lekë për blerje kompjutera, printera dhe laptop, vlen i njëjti sqarim sa më sipër, pasi panvarësisht urdhrin të Ministrisë për blerje laptop për recetat elektronike, nga komisioni i prokurimit, duhet të shihet nëse ka në regjistër objekt prokurimi të njëjtë, për arsye të mos rënies ndesh me legjislacionin e Prokurimit Publik. Ndërkohë që nga ana e observuesve theksohet fakti se kanë zbatuar urdhrin e titullarit të institucionit, në këtë pikë merret në konsiderat observacioni, dhe përgjegjësia mbetet mbi titullarin i cili ka nxjerrë urdhrin e prokurimit.

Përgjigje: Përsa i përket konstatimit të grupit të auditimit qëndron observacioni në lidhje me shprehjen e sipërpërmendur, pasi inventarët fizikë sikurse u verifikuan nga grupi, ishin kryer, por konstatimi qëndron dhe bëhet fjalë gjithashtu për mos hartimin e regjistrave kontabël në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të cilin nuk keni paraqitur asnjë observacion, dhe për pasojë konstatimi qëndron.

Argumentet e paraqitura në observacion pranohen pjesërisht.

Në observacionet e dërguara me shkresën nr. 442/5 prot, datë 11.07.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Gjirokastrë, nga ish-drejtori z.A.M në lidhje me akt-konstatimin nr. 5, në të cilët është shprehur se;

Në lidhje me akt-konstatimin nr. 5, sa i përket largimit nga detyra për mosndjekjen e procedurave për likuidim vullnetar, nga momenti i njohjes së detyrimit me vendim të Gjykatës së Apelit për të cilat janë paguar shpenzime përmbarimore, dhe se në lidhje me largimet nga puna nuk është ndjekur procedura ligjore, shprehet se ka nisur procedurën e largimit nga puna sipas kodit të punës duke respektuar afatet ligjore dhe rregullat për të cilat kam dijeni se janë zbatuar.

Në lidhje me observimet e mësipërme sqarojmë se sa i përket shpenzimeve përmbarimore janë ngarkuar me përgjegjësi sikurse jeni shprehur, titullarët të cilët kanë qënë në detyrë në momentin e njohjes së vendimit, pra nuk mbani përgjegjësi nëse nuk janë kryer shpenzime përmbarimore në periudhën që keni qënë në detyrë. Sa i përket largimeve nga puna, referuar vendimeve të Gjykatës së Apelit, largimi i tyre është bërë në mospërputhje me Kodin e Punës, dhe nga ana juaj nuk është vënë asnjë dokumentacion në dispozicion për cilën procedurë pretendoni se janë ndjekur rregullat dhe afatet ligjore.

Sa më sipër observacioni merret në konsideratë pjesërisht.

- Në lidhje me ekstraktin e bankës për vitin 2017, si dhe dokumentacionin mbështetës për shpenzimet e kryera në periudhën objekt auditimi.

Nga auditimi i ushtruar në dokumentacionin përkatës të veprimeve të kryera me arkë rezultoi se ditari i arkës ishte i rakorduar dhe nënshkruar prej arkëtarit, regjistrimet janë bërë në mënyrë kronologjike, duke përfshirë çdo të dhënë të dokumentit justifikues ku mbështetet ky regjistrim. Çdo muaj është kuadruar ditari dhe gjendja kontabël është e barabartë me gjendjen në librin e arkës, gjithashtu për të ardhurat e arkëtuara janë prerë mandat arkëtimet përkatëse të cilat janë pasqyruar në librin e arkës si dhe janë prerë mandat pagesat përkatëse. Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për transaksionet bankare për shpenzimet e kryera për 6-mujorin e fundit të vitit 2015, për vitin 2016 si dhe vitit 2017, rezultoi se Spitali Rajonal Gjirokastrë ka kryer shpenzime me vlera të ndryshme, kryesisht për material kancelarike, shtypshkrime, shërbim interneti, mirëmbajtje, blerje medikamentesh, ushqime për nevoja të SRV etj. Gjithashtu rezultoi se shumica e shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës janë pagesat e stafit si dhe sigurimet shoqërore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Më poshtë janë paraqitur disa urdhër shpenzime të audituar për vitin 2017 :

- Urdhër shpenzimi nr.18, datë 07.02.2017, “*Gaz mjekësor*” në vlerën 140,562 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.A” sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.1, datë 19.01.2017,faturë me TVSH me nr.517,datë 19.01.2017, aktkolaudimi datë 19.01.2017,kontrata shtesë nr.35/1 datë 19.01.2017
- Urdhër shpenzimi nr.19, datë 07.02.2017, “*Gaz mjekësor*” në vlerën 24,989 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.A” sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.2, datë 21.01.2017,faturë me TVSH me nr.520,datë 21.01.2017, aktkolaudimi datë 21.01.2017
- Urdhër shpenzimi nr.20, datë 07.02.2017, “*Gaz mjekësor*” në vlerën 49,977 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.A” sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.3, datë 23.01.2017,faturë me TVSH me nr.521,datë 23.01.2017, aktkolaudimi datë 23.01.2017
- Urdhër shpenzimi nr.37, datë 17.02.2017, “*Gaz mjekësor*” në vlerën 49,977 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.A” sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.4, datë 26.01.2017,faturë me TVSH me nr.525,datë 26.01.2017, aktkolaudimi datë 26.01.2017
- Urdhër shpenzimi nr.38, datë 17.02.2017, “*Gaz mjekësor*” në vlerën 35,140 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.A” sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.6, datë 07.02.2017,faturë me TVSH me nr.532,datë 07.02.2017, aktkolaudimi datë 07.02.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.29, datë 07.02.2017, “*Materiale mjekimi*” në vlerën 416,527 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ E” sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.9, datë 20.01.2017,faturë me TVSH me nr.40,datë 20.01.2017, aktkolaudimi datë 20.01.2017,kontrata shtesë nr.22 datë 12.01.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.30, datë 07.02.2017, “*Materiale mjekimi*” në vlerën 295,323 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M” sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.10, datë 27.01.2017,faturë me TVSH me nr.9851,datë 27.01.2017, aktkolaudimi datë 27.01.2017,kontrata shtesë nr.20/1 datë 12.01.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.31, datë 07.02.2017, “*Materiale mjeksore për shërbimin e hemodializës*” në vlerën 5,179,860 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ B-A” sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.11, datë 27.01.2017,faturë me TVSH me nr.020,datë 27.01.2017, aktkolaudimi datë 27.01.2017,kontrata shtesë nr.23/1 datë 12.01.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.32, datë 07.02.2017, “*Materiale mjekimi*” në vlerën 232,708 lekë për llogari të operatorit ekonomik “B-A” sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.12, datë 27.01.2017,faturë me TVSH me nr.019,datë 27.01.2017, aktkolaudimi datë 27.01.2017,kontrata shtesë nr.26/1 datë 12.01.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.189, datë 08.06.2017, “*Shërbim Printimi*” në vlerën 147,702 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ E” shpk, Disponohet flet-hyrja nr.35, datë 19.05.2017,faturë me TVSH me nr.13,datë 19.05.2017, aktkolaudimi datë 19.05.2017, Urdhër prokurimi nr.140 datë 12.04.2017, kërkesa e zyrës së planit me aparatet dhe specifikimet përkatëse, Argumentimi i çmimit, preventivi, ftesa për ofertë, printim i klasifikimit të sistemit, raporti përmbledhës i komisionit të blerjeve e vlerë të vogla, formulari i njoftimit të fituesit, formulari i ofertave, ekstrakti i QKB, ekstrakti historik, kontrata e ngjashme (mbështetur për hartimin e fondit limit) dhe kontrata e shërbimit nr.140/1 datë 19.04.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.192, datë 14.06.2017, “*Mirëmbajtje pajisje mjekësore*” në vlerën 1,152,090 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ B.E”,Disponohet Raport Shërbim 26.01.2017 , 27.02.2017, 21.03.2017, 13.01.2017,15.02.2017, 13.03.2017 faturë me TVSH me nr.315,datë 13.04.2017, aktkolaudimi datë 19.05.2017,kontrata nr.725/1 datë 30.12.2016.
- Urdhër shpenzimi nr.198, datë 15.06.2017, “*Medikamente*” në vlerën 260,035 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ A” shpk,Disponohet flet-hyrja nr.63, datë 26.05.2017,faturë me TVSH me nr.65921,datë 26.05.2017, aktkolaudimi datë 26.05.2017, kantrata nr.174 datë 16.05.2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

- Urdhër shpenzimi nr.228, datë 10.07.2017, “Blerje Ushqimesh” në vlerën 112,800 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.CC” shpk për kontratën nr.171 datë 15.05.2017., disponohet flet-hyrja nr.16, datë 20.05.2017,faturë me TVSH me nr.138 datë 20.05.2017, aktkolaudimi datë 20.05.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.233, datë 14.07.2017, “Blerje Ushqimesh” në vlerën 102,043 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.CC” shpk për kontratën nr.171 datë 15.05.2017., disponohet flet-hyrja nr.20,nr.21 datë 30.05.2017,faturë me TVSH me nr.57,nr.58 datë 30.05.2017, aktkolaudimi datë 30.05.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.234, datë 14.07.2017, “Blerje Ushqimesh” në vlerën 115,007 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.CC” shpk për kontratën nr.171 datë 15.05.2017., disponohet flet-hyrja nr.22,23 datë 07.06.2017,faturë me TVSH me nr.60,61 datë 07.06.2017, aktkolaudimi datë 07.06.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.231, datë 13.07.2017, “Energji Elektrike” në vlerën 944,932 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ OSHEE” sha për muajin qershor, disponon faturën e konsumit mujor.
- Urdhër shpenzimi nr.308, datë 01.08.2017, “Medikamente” në vlerën 954,600 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ T” shpk për kontratën nr.230 datë 14.06.2017., disponohet flet-hyrja nr.105 datë 20.07.2017,faturë me TVSH me nr.65401813 datë 20.07.2017, aktkolaudimi datë 20.07.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.318, datë 14.08.2017, “Materiale mjekimi” në vlerën 1,574,042 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ OD” shpk për kontratën nr.134 datë 07.04.2017., disponohet flet-hyrja nr.108 datë 27.07.2017,faturë me TVSH me nr.225930899 datë 27.07.2017, aktkolaudimi datë 27.07.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.326, datë 24.08.2017, “Blerje Ushqimesh” në vlerën 106,068 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.CC” shpk për kontratën nr.171 datë 15.05.2017, disponohet flet-hyrja nr.26,27 datë 26.07.2017,faturë me TVSH me nr.49,50 datë 26.07.2017, aktkolaudimi datë 26.07.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.331, datë 29.08.2017, “Blerje Naftë” në vlerën 814,900 lekë për llogari të operatorit ekonomik “K” shpk për kontratën nr.198/1 datë 06.06.2017, disponohet flet-hyrja nr.7 datë 07.08.2017,faturë me TVSH me nr.24 datë 07.08.2017, aktkolaudimi datë 07.08.2017, përlllogaritjae cmimit të karburantit.
- Urdhër shpenzimi nr.341, datë 30.08.2017, “Evadim mbeturinash” në vlerën 87,999 lekë për llogari të operatorit ekonomik “A.G” shpk, disponohet aktkolaudimi datë 31.05.2017,faturë me TVSH me nr.55 datë 31.07.2017, kontrata nr.116/1 datë 29.03.2017.
- Me urdhër shpenzim nr.344 datë 30.08.2017 “Medikamente” me vlerë 168,856 lekë për llogari të operatorit “C.PH SHPK” disponohen fletë hyrje nr.121/1 datë 18.08.2017, fatura nr.174143 datë 18.08.2017, aktkolaudimi i datës 18.08.2017 dhe kontrata nr.331/2 dt.18.08.2017.
- Për blerjen “Medikamente,B2” është përdorur procedura e prokurimit me vlerë të vogël me urdhër prokurimi nr.331 datë 15.08.2017 nga është shpallur fitues operatori “C.PH” dhe është nënshkruar kontrata nr.303 datë 31.07.2017. *Nga auditimi u konstatua se është shkelur neni 3 pika 1 e kontratës “20% e mallit në muajin e parë, 20% në të dytin, 10% të tretin, 10% të katërtin dhe pjesën tjetër deri në fund të kontratës. Shitësi është i detyruar të lëvrojë të gjithë sasnë e kontraktuar brenda datës 15.12.2017” pasi nga aktkolaudimi i datës 18.08.2017 rezulton se është bërë gjithë lëvrimi i mallit të kontratës dhe nuk është kryer shpërndarja sic është parashikuar në kushtet e kontratës.*
- Urdhër shpenzimi nr.355, datë 08.09.2017, “Materiale Sall Operacioni” në vlerën 22,080 lekë për llogari të operatorit ekonomik “A.G” shpk, disponohet fletë-hyrje nr.63 datë 28.08.2017, faturë me TVSH me nr.65 datë 28.08.2017, aktkolaudimi datë 28.08.2017,Urdhërprokurimi nr.347/1 datë 28.08.2017, preventivi, procesverbali i prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

- Urdhër shpenzimi nr.377, datë 18.09.2017, “Blerje pajisje Kondicionere” në vlerën 48,000 lekë për llogari të operatorit ekonomik “AB” shpk, disponohet fletë-hyrje nr.65 datë 30.08.2017, faturë me TVSH me nr.16 datë 30.08.2017, aktkolaudimi datë 30.08.2017, Urdhërprokurimi nr.351 datë 28.08.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.393, datë 22.09.2017, “Materiale Pastrimi” në vlerën 142,500 lekë për llogari të operatorit ekonomik “SG” shpk, disponohet fletë-hyrje nr.60 datë 21.08.2017, faturë me TVSH me nr.111 datë 21.08.2017, aktkolaudimi datë 21.08.2017, kontrata nr.334 datë 16.08.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.407, datë 17.10.2017, “Medikamente” në vlerën 234,225 lekë për llogari të operatorit ekonomik “T” shpk, disponohet fletë-hyrje nr.141 datë 27.09.2017, faturë me TVSH me nr.61502036 datë 27.09.2017, aktkolaudimi datë 27.09.2017, kontrata nr.232 datë 14.06.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.417, datë 17.10.2017, “Shërbim Printimi” në vlerën 121,890 lekë për llogari të operatorit ekonomik “E” shpk për kontratën nr.140/1 datë 19.04.2017, disponohet fletë-hyrje nr.71 datë 18.09.2017, faturë me TVSH me nr.52 datë 18.09.2017, aktkolaudimi datë 18.09.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.430, datë 25.10.2017, “Kancelari” në vlerën 98,268 lekë për llogari të operatorit ekonomik “Z.M” shpk, disponohet fletë-hyrje nr.75 datë 30.09.2017, faturë me TVSH me nr.27 datë 30.09.2017, aktkolaudimi datë 30.09.2017, Urdhër Prokurimi nr.380/1 datë 27.09.2017, procesverbali i prokurimit.
- Urdhër shpenzimi nr.445, datë 02.11.2017, “Mirëmbajtje ashensori” në vlerën 244,074 lekë për llogari të operatorit ekonomik “T.T” shpk, disponohet, faturë me TVSH me nr.1 datë 29.10.2017, aktmarrja në dorëzim datë 30.05.2017, 28.06.2017, 31.07.2017,31.08.2017 29.09.2017, 30.10.2017, situacioni i punimeve, preventivi i ofertës, kontrata nr.178 datë 17.05.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.448, datë 07.11.2017, “Evadim mbeturinash” në vlerën 87,999 lekë për llogari të operatorit ekonomik “A.G” shpk, disponohet faturë me TVSH me nr.72 datë 06.10.2017, aktkolaudimi datë 31.08.2017, 30.09.2017, 31.07.2017,30.04.2017,mungon kontrata nr.116/1 datë 29.03.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.470, datë 23.11.2017, “Gaz mjekësor” në vlerën 18,384 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.A” sh.p.k. Disponohet fletë-hyrja nr.82, datë 27.10.2017,faturë me TVSH me nr.733,datë 27.10.2017, aktkolaudimi datë 27.10.2017, mungon kontrata nr.3792 datë 28.09.2017.
- Urdhër shpenzimi nr.487, datë 05.12.2017, “Blerje Ushqimesh” në vlerën 106,734 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ M.CC” shpk për kontratën nr.171 datë 15.05.2017., disponohet fletë-hyrja nr.53,54 datë 25.10.2017,faturë me TVSH me nr.312, 313 datë 25.10.2017, aktkolaudimi datë 25.10.2017.
- Urdhër shpenzime nr.497, datë 11.12.2017 “Uniforma dhe veshje speciale” në vlerën 739,944 lekë për llogari të operatorit ekonomik “A.V”, disponon fletë-hyrje 20.11.2017, fatura nr.18 datë 20.11.2017, aktkolaudimi 20.11.2017, kontrata nr.385/3 datë 20.11.2017, urdhërprokurimi nr.373 datë 20.09.2017, procesverbali i prokurimit.
- Me Urdhër Shpenzim Nr.132 datë 05.05.2017 “Shtypshkrime” me vlerë 658,800 lekë për llogari të operatorit “R.G” disponohen fletë hyrje nr.17,18,19,20,21,22 datë 03.04.2017, faturat nr.29,30,31,32,33,34 datë 03.04.2017, aktkolaudimet e datës 03.04.2017, kontrata nr.125 datë 28.03.2017 me vlerë 658,800 lekë pa tvsh. Për blerjen “Shtypshkrime për Spitalin Gjirokastër” është përdorur procedura e prokurimit me vlerë të vogël në sistemin elektronik të APP me urdhër prokurimi nr.117 datë 24.03.2017 me fond limit 749,625 lekë pa tvsh. Kanë paraqitur ofertë 6 operatorë ekonomikë.Tenderi është zhvilluar në datën 27.03.2017 ku është shpallur fitues operatori “R.G” me vlerë të ofertës 549,000 lekë pa tvsh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Nëpërmjet bankës janë likuiduar shpenzimet telefonike

SRGJ për periudhën e audituar ka lidhur kontratë me kompaninë “A” sh.a e cila kryen dhe shërbimet e internetit. Kjo kompani kryen shërbimet e saj telefonike vetëm për telefonat fikse që ndodhen në SRGJ (si tek urgjenca, pediatria, patologjia etj) Urdhër Shpenzimet për këtë shpenzim të përmuajshëm kanë bashkëlidhur faturat e telefonave fikse për secilin repart.

- Urdhër shpenzimi nr.29, datë 07.02.2017, “Medikamente” në vlerën 956,014 lekë për llogari të operatorit ekonomik “ FF” për kontratën nr.45/1 datë 12.01.2017.sh.p.k. Disponohet flet-hyrja nr.15, datë 09.02.2017,faturë me TVSH me nr.5089,datë 09.02.2017, aktkolaudimi datë 09.02.2017.

-Nëpërmjet bankës janë likuiduar shpenzimet e kryera për udhëtime dieta.

Mbështetur në të dhënat e buxhetit për shpenzimet e zërit 6024 “Shpenzime Udhetime” rezultoi se për vitin 2015 shpenzimet për udhëtime të brendshme ishin në vlerën 4,801,100 lekë, vitin 2016 shpenzimet për udhëtime të brendshme ishin në vlerën 3,887,915 lekë, vitin 2017 shpenzimet për udhëtime të brendshme ishin në vlerën 1,937,594 lekë. Shpenzimet për udhëtim e dieta kryesisht janë kryer drejt Tiranës nga shoferët dhe stafi mjekësor shoqërues i pacientëve, nga punonjësit e administratës për problematika të natyrës seminare, trajnime në MSH dhe FSHKDSH. Nga verifikimi i dokumentacionit për shpenzime dieta u verifikua se urdhër shërbimet e likuuduara janë të firmosura nga personat përgjegjës dhe janë të shoqëruara me autorizimin e titullarit të spitalit. Pjesa më e madhe shpenzimeve për udhëtime dieta janë plotësuar me urdhër shërbimet, në të cilat paraqitet paraqitet destinacioni i shërbimit për secilin punonjës, duke i plotësuar të gjitha rubrikat, si dhe bashkëlidhur kanë faturat e hotelit, dokumentacionin justifikues për qëllimin e kryerjes së shërbimit, të tilla si ftesa, njoftime trajnimi. Nga auditimi u konstatua se pjesa më e madhe e problematikave në dokumentacionin e shpenzime dieta kanë qenë qershor 2015- qershor 2016 ndërkohë që për periudhën në vazhdim jo vetëm janë ulur ndjeshëm shpenzimet për dieta por dhe është mbajtur dokumentacion I rregullt dhe i plotë bazuar në VKM nr.997 datë 10.12.2010 I ndryshuar me VKMnr.329 datë 20.04.2016 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, si dhe Udhëzimi I MT nr.125 datë 26.12.2011 “Për distancat dhe tarifrat e biletave”. Problemet e konstatuara lidhur me shpenzimet e udhëtime dieta janë si më poshtë:

Shpenzime dieta për personat si më poshtë janë shoqëruar me fatura të thjeshta tatimore për fjetje në hotel në kundërshtim me VKM nr.1058 datë 21.10.2009 “Për përcaktimin minimal të kufirit për tatimin mbi vlerën e shtuar” I ndryshuar:

-Z.Q 25.02.2015 dhe 26.05.2015 gjithsej 2 ditë në vlerën 6,000 lekë

-K.LI 25.02.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 3,000 lekë

-D.Q 1.10.2015 gjithsej 1 ditë qëndrimi në vlerën 3,000lekë

-M.B 5.11.2015 gjithsej 1 ditë qëndrimi në vlerën 3,000 lekë

-K.M 5.11.2015 gjithsej 1 ditë qëndrimi në vlerën 3,000 lekë

Shuma 18,000 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Për sa më sipër mbanë përgjegjësi z.K.K medetyrë ish drejtor I spitalit, zj.D.T me detyrë përgjegjëse sektorit të financës, z.S.P dhe z.A.Sh me detyrë ish shef I financës dhe z.A.M me detyrë ish drejtor I spitalit.

Nga verifikimi I dokumentacionit rezultuan dhe disa shpenzime dieta të pa justifikuara me dokumentacion bashkangjitur ku të specifikojë arsyen e lëvizjes së punonjësit me shërbim jashtë qendrës së punës, këto pagesa janë në kundërshtim me VKM nr.997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës Brenda vendit” si dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin public, pika III, nr.35,gërma b “Dokumenta vërtetues”.

- Z.Q 16.03.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë
- R.J 16.03.2015, 23.06.2015 gjithsej 2 ditë në vlerën 11,000 lekë
- E.M 16.03.2015, 30.04.2015,25.08.2015 gjithsej 3 ditë në vlerën 16,500 lekë
- F.D 20.07.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë
- A.M 28.07.2015, 06.07.2015 gjithsej 2 ditë në vlerën 11,000 lekë
- K.M 20.07.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë
- V.H 2.10.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë
- M.Ll 5.11.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë
- V.K 5.11.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë

Shuma 89,800 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Për sa më sipër mban përgjegjësi z.K.K me detyrë ish drejtor I spitalit, z.D.T dhe detyrë përgjegjëse e financës, z.S.P dhe z.A.Sh me detyrë ish përgjegjëse sektorit të financës dhe ish drejtori z.A.M.

Një tjetër problem i konstatuar nga grupi i auditimit është se janë kryer shpenzime dieta në ditët e pushimit zyrtar si dhe mospërputhje date fature fjetje me datën e shërbimit të dokumentuar nëpërmjet autorizimit nga Titullari në kundërshtim me VKM nr.997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qëndrës së punës Brenda vendit” si dhe Udhëzimin e MF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin public, pika III, nr.35,gërma b “Dokumenta vërtetues”. Rezulton për punonjësit si më poshtë:

- E.M 24.05.2015, 27.12.2015, 06.02.2016, 28.02.2016,14.03.2016, 28.04.2016 gjithsej 6 ditë qëndrim në vlerën 18,000 lekë
- L.O 05.08.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë
- A.M 1.11.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë
- F.D 1.11.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë
- T.K 14.11.2015, 28.01.2016 gjithsej 2 ditë qëndrim në vlerën 19,800 lekë
- Th.B 17.11.2015 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 5,500 lekë
- K.K 27.12.2015,06.02.2016, 27.03.2016, 14.03.2016 gjithsej 4 ditë qëndrim në vlerën 10,000 lekë
- E.Sh 31.01.2016 gjithsej 1 ditë qëndrim në vlerën 2,500 lekë

Shuma 67,300 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Për sa më sipër mban përgjegjësi z.K.K me detyrë ish drejtor I spitalit, z.D.T dhe detyrë përgjegjëse e financës, z.S.P dhe z.A.Sh me detyrë ish përgjegjëse sektorit të financës dhe ish drejtori z.A.M.

Lidhur me observacionin nr.440/39 datë 05.07.2018 për aktkonstatimin nr.5/2 pretendimet tuaja merren në konsideratë.

-Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me bankë për blerjet me vlera të vogla, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për vitin 2015
- 2) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për vitin 2016
- 3) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për vitin 2017, si dhe
- 4) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për vitin 2018.
- 5) Procedurat me zgjedhje sipas anekseve bashkëlidhur këtij akt-konstatimi të blerjeve me vlera të vogla për periudhën objekt auditimi.
- 6) Shpenzimet e bankës për procedurat e blerjeve të vogla.

Nga verifikimi me zgjedhje i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi që:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Për vitin 2015 nga titullari i autoritetit kontraktor (AK) z.A.M me urdhërin nr. 37/1, dt. 27.1.2015 është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla, i përbërë nga: A.Ll kryetare dhe anëtarët F.D dhe S.P i cili ka funksionuar deri në fund të vitit.

Për vitin 2016 nga titullari i autoritetit kontraktor (AK) z.K.K me urdhërin nr. 14, dt. 12.01.2016 është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla, i përbërë nga: F.D kryetar dhe anëtarët A.Ll dhe R.J i cili ka funksionuar deri në fund të vitit.

Për vitin 2017 nga titullari i autoritetit kontraktor (AK) z.K.K me urdhërin nr. 25, dt. 12.01.2017 është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla, i përbërë nga: F.D kryetar dhe anëtarët A.Ll dhe R.J. Me urdhërin e titullarit nr. 115, datë 24.03.2017 është bërë ndryshimi ku është zëvendësuar A.Ll me H.XH i cili ka funksionuar deri në fund të vitit.

Për vitin 2018 nga titullari i autoritetit kontraktor (AK) z.R.K me urdhërin nr. 6, dt. 09.01.2017 është krijuar komisioni i prokurimit për blerjet me vlera të vogla, i përbërë nga: N.Sh kryetare dhe anëtarët B.A dhe A.Sh.

Për vitin 2015 u audituan 9 procedura prokurimi të cilat janë pasqyruar në aneksin e këtij akt-konstatimi, nga të cilat rezultoi se;

Në të 9 procedurat u është dëgjuar ftesë për ofertë vetëm 3 operatorëve ekonomikë dhe jo 5 OE, veprim i cili tregon një kufizim të pjesëmarrjes në këto procedura, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, neni 40, pika 5, Udhëzimin nr. 1, datë 27.01.2015 “Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar, pika 5.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit.

Me urdhërin e prokurimit nr. 66, datë 03.03.2015, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Evadim mbeturinash”, me fond limit 275,310 lekë. Komisioni ka hartuar një raport përmbledhës duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “A.G”. Në lidhje me këtë procedurë konstatohet se nuk është kryer një llogaritje e saktë e fondit limit, nuk përcaktohet vendi i marrjes dhe i hedhjes së mbeturinave, për të ërcaktuar saktësisht kryerjen e shërbimit nga OE- sipërmarrës. Është kryer likuidimi i faturave nr. 48, datë 09.06.2015, me u.shp nr 208, datë 23.06.2015 në vlerën 99,000 lekë, fatura me nr. 55, datë 08.09.2015, me u.shp nr 409, datë 25.11.2015, në vlerën 99,000 lekë, fatura me nr. 69, datë 14.12.2015, me u.shp nr. 484, datë 14.12.2015 në vlerën 132,000 lekë ndaj OE fitues.

Verimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin anëtarët e komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 103, datë 25.03.2015, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Materiale të buta” me fond limit 799,652 lekë. Komisioni ka përcaktuar si ofertë fituese subjektin “S”shpk me vlerë oferte 542,000 lekë pa tvsh. Është kryer likuidimi i faturës nr. 55, datë 28.04.2015 ndaj këtij operatori me UXH nr. 176, me datë 12.05.2015 në shumën 650,400 lekë, dhe mallrat janë bërë hyrje me FH nr. 12, datë 28.04.2015 në magazinën e SRGJ.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 52, datë 18.02.2015, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Blerje goma” me fond limit 390,000 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 09.03.2015, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “EC”. Është kryer likuidimi i faturës nr. 5, datë 12.03.2015 ndaj këtij



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

operatori me UXH nr. 174, me datë 12.05.2015 në shumën 354,000 lekë. Dhe mallrat janë bërë hyrje në magazinën e SRGJ me FH nr. 4, datë 12.03.2015, në sasinë e kërkuar.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 164, datë 28.05.2015, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Mirëmbajtje pajisjesh mjeksore” me fond limit 240,000lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 29.05.2015, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “E”. Është kryer likuidimi i faturës nr. 378, datë 01.06.2015 ndaj këtij operatori me UXH nr. 468, me datë 14.12.2015 në shumën 288,000 lekë. Është mbajtur procesverbali pa nr. Prot, datë 01.06.2015 për kryerjen e shërbimit nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 51, datë 17.02.2015, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Mirembajtje sterilizatori” me fond limit 235,040 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 19.02.2015, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “M”. Është kryer likuidimi i faturës nr. 247, datë 18.03.2015 ndaj këtij operatori me UXH nr. 161, me datë 12.05.2015 në shumën 276,000 lekë.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 97, datë 20.03.2015, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Shërbime printimi” me fond limit 399,760 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 27.03.2015, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “F.M”. Është kryer likuidimi i faturës nr. 38, datë 30.05.2015 ndaj këtij operatori me UXH nr. 469, me datë 14.12.2015 në shumën 454,800 lekë. Është mbajtur procesverbal pa nr. Prot, datë 18.11.2015, për marrjen në dorëzim të mallrave të kërkuar, të cilat janë bërë hyrje në magazinën e SRGJ në sasinë e prokuruar.

Për vitin 2016 u audituan 11 procedura prokurimi të blerjeve me vlera të vogla, të cilat janë pasqyruar në aneksin e këtij akt-konstatimi, nga të cilat rezultoi se;

Në të gjitha rastet e këtyre procedurave u është dëguar ftesë për ofertë vetëm 3 operatorëve ekonomikë dhe jo 5 OE, veprim i cili tregon një kufizim të pjesëmarrjes në këto procedura, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, neni 40, pika 5, Udhëzimin nr. 1, datë 27.01.2015 “Për Proçedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar, pika 5.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit.

Janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat normale të prokurimit, në shumën totale 1,124,140 lekë pa TVSH, procedura të cilat duhet të kryeshin tenderim, dhe konkretisht është kryer procedura “Blerje karburant”, në muajin mars 2016 me fond limit në shumën 465,440 lekë pa tvsh, dhe procedura “Blerje karburant”, me fond limit në shumën 658,700 lekë pa tvsh në muajin nëntor 2016, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 40, pika 1.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin z.K.K, dhe anëtarët e Komisionit të blerjeve me vlera të vogla z.F.D, znj.A.Ll dhe znj.R.J.

Me urdhërin e prokurimit nr. 46, datë 28.01.2016, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Shërbim me roje private” me fond limit 733,099 lekë. Komisioni me procesverbalin pa nr. Prot, datë 29.01.2016 ka përcaktuar si ofertë fituese subjektin “A”shpk me vlerë oferte 638,388 lekë pa tvsh i cili është miratuar edhe nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

titullari i SRGJ. Është hartuar dhe lidhur kontrata e shërbimit me nr46/1, datë 03.02.2016, midis drejtuesit të spitalit GJ z.K.K dhe përfaqësuesit të OE fitues z. E.Sh. Është kryer likuidimi i faturës nr. 36, datë 31.03.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 117, me datë 06.04.2016 në shumën 255,355 lekë, i faturës nr. 25, datë 29.02.2016 me UXH nr. 72, me datë 17.03.2016 në shumën 255,355 lekë dhe i faturës nr. 46, datë 30.04.2016 me UXH nr. 164, me datë 11.05.2016 në shumën 255,355 lekë, të cilat janë likuiduar bazuar në faturat e OE fitues dhe procesverbaleve të mbajtura midis përfaqësuesit të firmës z. E.Sh dhe përfaqësuesit të SRGJ z.F.D. Nuk ka asnjë dokumentacion justifikues për mënyrën e kryerjes së shërbimit, vendin e rojes, ndërrimet e turneve, personat që kanë qënë në dispozicion të kryerjes së këtij shërbimi, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, **të cilat ngarkojnë me përgjegjësi z.F.D.**

Në lidhje me zbatimin e kontratës së mësipërme konstatohet se nga titullari i institucionit nuk është ngritur komision për zbatimin dhe mbikqyrjen e kontratës, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 77.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK-së, z. K.K.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 183, datë 30.03.2016, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për "Shërbime printimi" me fond limit 307,200 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 07.04.2016, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin "F.M". Është kryer likuidimi i faturës nr. 45, datë 25.04.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 167, me datë 11.05.2016 në shumën 166,800 lekë, i faturës nr. 245, datë 07.12.2016, me UXH nr. 489, datë 14.12.2016, në shumën 166,800 lekë. Mallrat janë bërë hyrje në magazinën e SRGJ me FH nr. 24, datë 25.04.2016, dhe FH nr. 83, datë 07.12.2016, në sasinë e kërkuar.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 201, datë 12.04.2016, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për "Mirëmbajtje imiantistike" me fond limit 647,922lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 18.04.2016, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin "A.G". Është kryer likuidimi i faturave nr. 1, 2, 3, datë 29.09.2016.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 417, me datë 27.10.2016 në shumën 195,588 lekë, i faturave nr. 9, 10, 11, 12, datë 30.11.2016, me UXH nr. 488, datë 14.12.2016, në shumën 376,908 lekë dhe likuidimi i faturës nr. 14, datë 23.12.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 524, me datë 28.12.2016 në shumën 74,190 lekë. Për këtë shërbim janë mbajtur aktet përkatës për kryerjen e shërbimit nga komisioni I ngritur për këtë qëllim.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 402, datë 25.08.2016, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për "Blerje Goma për automjetet" me fond limit 318,800 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 26.08.2016, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin "H". Është kryer likuidimi i faturës nr. 112, datë 29.08.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 367, me datë 12.10.2016 në shumën 311,400 lekë. Mallrat janë bërë hyrje në magazinë me FH nr. 57, datë 29.08.2016 pasi janë marrë në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 383, datë 02.08.2016, është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla i cili ka filluar procedurën e prokurimit për "Riparim autoklave" me fond limit 260,000 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 03.08.2016, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin "B". Është kryer likuidimi i faturës nr. 329, datë 17.08.2016 ndaj këtij



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

operatori me UXH nr. 396, me datë 25.10.2016 në shumën 306,000 lekë. Është mbajtur procesverbal pa nr. Prot, datë 10.08.2016, për kryerjen e shërbimeve të riparimit të autoklavës, nga komisioni i ngritur për zbatimin e kontratës.

➤ Me urdhërin e prokurimit nr. 238/1 datë 18.05.2016, është urdhëruar komisioni I prokurimit për blerje me vlera të vogla I cili ka filluar procedurën e prokurimit për “Mirëmbajtje ashensori”, me fond limit 319,032 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me date 19.05.2016, duke përcaktuar si ofertë fituese subjektin “T.T”, me vlerë oferte 319,030 lekë. Është kryer likuidimi i faturës me nr. 24, datë 04.11.2016 ndaj këtij operatori me UXH nr. 462, datë 24.11.2016, në shumën 240,000 lekë. Janë mbajtur procesverbalet pa nr. prot, me datat përkatëse për kryerjet e shërbimit të mirëmbajtjes së ashensorit, për secilën periudhë nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.

Për vitin 2017 u audituan 15 procedura prokurimi të blerjeve me vlera të vogla, të cilat janë pasqyruar në aneksin e këtij akt-konstatimi, nga të cilat rezultoi se;

Janë kryer 4 procedura blerje me vlera të vogla duke copëzuar fondin dhe duke anashkuar procedurat normale të prokurimit, pra procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim. Nga këto, 2 procedura me vlerë të vogël me objekt “Blerje karburanti” **në shumën totale 1,550,000 lekë pa TVSH**, dhe konkretisht është kryer procedura “Blerje karburant në muajin shkurt 2017”, me fond limit në shumën 800,000 lekë, dhe procedura “Blerje karburant”, me fond limit në shumën 750,000 lekë në muajin prill 2017. Gjithashtu janë kryer 2 procedura me objekt “Roje private” **në shumën totale 1,483,257 lekë pa TVSH**, konkretisht procedura me objekt “Roje private” me fond limit në shumën 733,099 lekë e zhvilluar në muajin shkurt 2017, dhe procedura me objekt “Roje private”, me fond limit në shumën 750,158 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale prokurimi, veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 40, pika 1.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin z.K.K, dhe anëtarët e Komisionit të blerjeve me vlera të vogla z.F.D, znj.A.Ll dhe znj.R.J.

Lidhur me dy procedura prokurimi me vlerë të vogël për vitin 2017 (objekt auditimi)

- Mirëmbajtje e objekteve ndërtimore dhe impiantistikës

- Me Urdhër Shpenzim Nr.317 datë 23.08.2017 “Materiale për mirëmbajtjen e objekteve” me vlerë 332,400 lekë për llogari të operatorit “A.G” disponohen fletë hyrje nr.53 datë 28.07.2017, faturat nr.59 datë 28.07.2017, aktkollaudimet e datës 28.07.2017, kontrata nr.297 datë 25.07.2017 .

- Me Urdhër Shpenzim Nr.317 datë 23.08.2017 “Materiale për mirëmbajtjen e objekteve” me vlerë 332,400 lekë për llogari të operatorit “A.G” disponohen fletë hyrje nr.53 datë 28.07.2017, faturat nr.59 datë 28.07.2017, aktkollaudimet e datës 28.07.2017.

- Me Urdhër Shpenzim Nr.317 datë 23.08.2017 “Materiale për mirëmbajtjen e objekteve” me vlerë 332,400 lekë për llogari të operatorit “A.G” disponohen fletë hyrje nr.53 datë 28.07.2017, faturat nr.59 datë 28.07.2017, aktkollaudimet e datës 28.07.2017.

- Me urdhër e prokurimit nr.144 datë 25.04.2017 është realizuar procedura e prokurimit më datë 28.04.2017 me mjete elektronike. Për këtë procedurë kanë paraqitur ofertë 20 (njëzet) operatorë ekonomik. Pas zhvillimit të procedurës janë shpallur fitues 5 operatorët ekonomikë si më poshtë:

- 1.T-D me vlerë të ofertës 459,999 lekë pa tvsh
- 2.T SHPK me vlerë të ofertës 467,777 lekë pa tvsh
- 3.A me vlerë të ofertës 474,500 lekë pa tvsh
- 4.N.H me vlerë të ofertës 488,500 lekë pa tvsh



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

5.K.M me vlerë të ofertës 489,000 lekë pa tvsh

Nga auditimi i kryer në sistemin elektronik të APP-së, u konstatua se komisioni i blerjeve ka mbyllur procedurën në sistemin elektronik duke shpallur fitues “T-D” dhe figuron si procedurë e mbyllur në sistemin elektronik. Ndërkohë që nuk është lidhur kontratë me këtë operator dhe as nuk është vazhduar njoftimi i operatorëve të tjerë fitues sipas rradhës fituese.

Me urdhër prokurimi nr.256, datë 04.07.2017 më datë 06.07.2017 është zhvilluar sërish me mjete elektronike procedura e prokurimit me vlerë të vogël me fond limit **558.650 lekë pa tvsh** ku kanë paraqitur ofertë 21 operatorë ekonomikë dhe 5 të parët sipas klasifikimit të operatorëve fitues janë si më poshtë:

1. E.L me vlerë të ofertës 412,500 lekë pa tvsh
2. A.B me vlerë të ofertës 468,900 lekë pa tvsh
3. B.B me vlerë të ofertës 478,900 lekë pa tvsh
4. A.D me vlerë të ofertës 498,600 lekë pa tvsh
5. K.M me vlerë të ofertës 499,000 lekë pa tvsh

Ndërkohë operatori A.G me verë të ofertës 550,000 lekë pa tvsh është renditur në vendin e 19-të.

Nga auditimi i kryer në sistemin elektronik të APP-së u konstatua se komisioni i blerjeve ka shpallur fitues operatorin “E.L” i cili nuk është paraqitur për lidhjen e kontratës dhe është vazhduar me njoftimin e ofertuesve të tjerë deri në rendin e 5-të sipas Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël” por asnjë prej tyre nuk është paraqitur për lidhjen e kontratës. Procedura e zhvilluar në sistem nuk është mbyll me asnjë operator fitues.

Pasi është shpallur dy herë radhazi në sistemin elektronik të prokurimit të procedurës me vlerë të vogël dhe kjo procedurë prokurimi është anuluar për shkak të mungesës së konkurrencës, atëherë autoriteti mund të vijojë me realizimin e procedurës në rrugë shkresore. Është hartuar urdhër prokurimi nr.296 datë 25.07.2017 për blerje materiale të ndryshme për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore dhe impiantistikës për SRG. Fondi limit i përllogaritur është 558 650 lekë pa tvsh. Preventivi është hartuar sipas kontratës së fundit nr.201/1 datë 19.04.2016.

Kanë paraqitur ofertat operatorët:

1. A.G me vlerë të ofertës 555,150 lekë pa tvsh
2. F.M me vlerë të ofertës 557,150 lekë pa tvsh
3. Y.M me vlerë të ofertës 557,900 lekë pa tvsh

Komisioni shpallë fitues në datë 25.07.2017 A.G. Dhe po në këtë datë lidhet kontrata e furnizimit nr.297 datë 25.07.2017. Kontraktori duhet të paraqes sigurimin e kontratës në masën 10% të vlerës së kontratës pasi operatori ekonomik shpallet fitues . Nga auditimi I dokumentacionit shoqërues u konstatua se: Operatori i shpallur fitues ka paraqitur sigurimin e kontratës me datën 24.07.2017 pa dalë akoma urdhër prokurimi i cili mban datën 25.07.2017, duke lënë të kuptohet se kjo procedurë është e paracaktuar për këtë operator nisur dhe nga anulimi i dy procedurave në sistemin elektronik. Procedura prokurimit për vlera të vogla është në kundërshtim me ligjin e prokurimit pasi sa më sipër lë të kuptohet se fituesi i tenderit është paracaktuar nga Autoriteti kontraktor. ***Për pasojë vlera e kontratës prej 666,180 lekë përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të shtetit dhe mban përgjegjësi ish drejtori Z. P.M në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktorë dhe anëtarët e njësisë së prokurimit.***

Z. P.M lidhur me observacionin tuaj me nr.440/3 datë 08.08.2018 po ju sqarojmë:

-“Nga ana e audituesve është përmendur se sigurimi i kontratës është një ditë para nga shpallja e fituesit dhe lidhja e kontratës. Shpjegoj se ky dokument është paraqitur nga subjekti dhe pse bëhej



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

fjalë për prokurimin në vlerë të vogël dhe se ky dokument nuk është i nevojshëm, subjekti e ka sjellë vet dhe ndërsa komisioni nuk duhej ta kishte pranuar. Madje dhe kontrata për këto lloj prokurimesh nuk është e nevojshme. Siç shpjegova në mënyrë të përsëritur më lartë i gjithë dokumentacioni është i përpiluar nga komisioni i ngritur që në fillim të vitit, komisioni i ngritur kur unë e gjeta në detyrë, kur kam filluar detyrën e drejtorin.”

-Sigurimi I kontratës mbanë datën 24.07.2017 ndërkohë që urdhër prokurimi për procedurën e prokurimit është në datë 25.07.2017 me pak fjalë operatori fitues ishte në dijeni përpara daljes së urdhër prokurimit për këtë Blerje me vlerë të vogël se jo vetëm do të ishte fitues por do të kishte dhe një kontratë (për të cilën ju me të drejtë shpreheni se nuk është e detyrueshme) duke bërë të dyshimtë kështu dhe dijenin e operatorit për nënshkrimin e kësaj kontrate me kusht mbajtjen e sigurimit 10% një ditë para urdhër prokurimit.

- Më sipër nuk jemi shprehur se ka pas ndërhyrje në sistemin online. Sa i takon njësisë së prokurimit do të ngarkohet me përgjegjësi por ju si titullar i Autoritetit Kontraktor nuk ju përjashton nga përgjegjësia profesioni juaj si mjek kardiolog.

-Sigurimi i godinave të spitalit Gjirokastrë

-Me Urdhër Shpenzim Nr.190 datë 08.06.2017 “Shpenzimet e siguracionit të godinave” me vlerë 397,000 lekë për llogari të operatorit “S.U.G.A” disponohet dokumentacioni i procedurës së prokurimit.

- Me urdhër prokurimi nr.146 datë 26.04.2017 me fond limit me vlerë 399,000 lekë iniciuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël “Sigurimi i godinave të spitalit Gjirokastrë”. Argumentimi i fondit limit është bërë sipas kontratës së fundit për periudhën 08.04.2016-08.04.2017 dhe mbulon rreziqet e Tërmetit dhe Përmbytjes për Godinën Qëndrore dhe Godinën e Maternitetit për Spitalin Gjirokastrë. Është zhvilluar procedura e tenderit në datë 28.04.2017 ku paraqitën ofertë 2(dy) operatorë ekonomik :

1. S.U.G.A me vlerë të ofertës 397,000 lekë.
2. A-S me vlerë të ofertës 399,000 lekë.

Komisioni vlerësue shpall fitues operatorin S.U.G.A. Nga auditimi u konstatua se edhe pse argumentimi i fondit limit është kryer mbështetur në kontratën e mëparshme të sigurimit, Kontrata për periudhën 3.05.2017-3.05.2018 me vlerë 397,000 lekë mbulon vetëm rrezikun e Tërmetit për Godinën Qëndrore dhe Godinën e Maternitetit të Spitalit Rajonal Gjirokastrë ndryshe nga kontrata e mëparshme që për vlerën 399,000 mbulon rrezikun e Tërmetit dhe Përmbytjes. Nëse marrim në konsideratë dhe faktin që qyteti i Gjirokastrës është i rrezikuar nga përmbytjet gjatë periudhës së dimrit mund të themi se kjo kontratë duhet të vazhdonte në linjën e asaj më parë. **Për pasojë 1/2 e vlerës së kontratës 198,500 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të buxhetit të shtetit dhe duhet kthehet nga përfituesi “S.U.G.A” shpk.**

Sa më sipër sipas konstatimeve përkatëse arrihet në konkluzionin që veprimet e kryera bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 1) Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.
- 2) VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
- 3) Udhëzimin nr. 1, datë 21.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, pika 3, paragrafi i dytë.
- 4) Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar,
- 5) Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 11) Z. K.K me detyrë ish- Drejtor i Spitalit Rajonal Gjirokastrë.
- 12) Z.A.M me detyrë ish-drejtor i SRGJ.
- 13) Z.P.M me detyrë ish-drejtor i Spitalit Rajonal Gjirokastrë.
- 14) Z.A.Sh me detyrë ish- shef finance.
- 15) Z. F.D me detyrë anëtar i komisionit të blerjeve të vogla.
- 16) Znj.A.LI me detyrë anëtar i komisionit të blerjeve të vogla.
- 17) Znj.R.J me detyrë anëtar i komisionit të blerjeve të vogla.

Në observacionet e dërguara me shkresat nr. 440/39 prot, datë 05.07.2018, nga punonjësi z.A.Sh në lidhje me akt-konstatimin nr. 5/1, në të cilin citohet se;

Së pari, në lidhje me procedurën e blerjeve të vogla të kryera në vitin 2015, me objekt “Evadim mbeturinash”, nuk kam qënë me detyrë përgjegjës i zyrës së financës dhe nuk ka qënë detyrë e imja llogaritja e fondit limit, gjithashtu për pretendimin e dëmit ekonomik të lënë për kryerjen e shpenzimit për evadim mbeturinash në vlerën 99,000 lekë po ju vë në dispozicion procesverbalin e kryerjes së shërbimit, për të cilin sqarojmë se:

Përgjigje:

Përsa i përket observacionit merret në konsideratë ky pretendim bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, të cilat nuk ishin në dokumentet justifikues të bashkëlidhur tek banka gjatë procesit të auditimit në subjekt, gjithashtu janë kryer reflektimet përkatëse në material.

Në observacionet e dërguara me shkresën nr. 442/5 prot, datë 11.07.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Gjirokastrë, nga ish-drejtori z.A.M në lidhje me akt-konstatimin nr. 5/1, për të cilin sqarojmë se:

Në këtë pikë observacioni është marrë në konsideratë, sikurse sqaruar edhe më sipër.

VI. Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi që:

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pika 4 e nenit 11 dhe të pikës 74 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011, në të cilin përcaktohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës, Spitali Rajonal Gjirokastrë ka kryer;

Për vitin 2015;

Titullari i SRGJ ka hartuar disa urdhëra për inventarizimin e aktiveve që është kryer për këtë vit dhe konkretisht;

Me Urdhrin nr. 195/2, datë 09.10.2015, nga drejtori i SRGJ z.A.M, është ngritur komisioni i inventarizimit për verifikimin e materialeve të inventarit i përbërë nga V.T, J.K dhe F.SH. Me urdhërin nr. 195/3, datë 09.10.2015, drejtori i SRGJ z.A.M, është ngritur komisioni për asgjësimin e materialeve të inventarit, me përbërje, F.D, M.B.S.G dhe B.K. Komisioni për asgjësimin e inventarëve të cilët do të asgjësohen përbëhet nga 4 persona dhe jo nga 5 siç parashikohet në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 100, pra është vepruar në kundërshtim me legjislacionin e sipërpërmendur.

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin z.A.M.

Gjatë vitit 2015 janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive të imëta të cilat kanë përbërje material metalik, të cilat mund të vlerësoheshin dhe të nxirreshin në ankand për shitje skrap, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 102 dhe 109 i cili citon se;

“Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga rregjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillesare, groposur ose djegur”.

Ngarkohen me përgjegjësi ish-drejtori i SRGJ z.K.K, në cilësinë e nëpunësit autorizues, D.T në cilësinë e nëpunësit zbatues, F.D, M.B, S.G dhe B.K në cilësinë e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjesimit.

Relacioni nuk përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsytet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, gjithashtu në relacion nuk janë argumentuar arsytet për vlerësimin e secilit prej tyre, si dhe përse do të nxirren jashtë përdorimit.

Komisioni i cili ka kryer asgjesimin, ka mbajtur procesverbal me datë 31.12.2015, pa nr. Prot, për llogarinë 214 në vlerën 69,684 lekë, për llogarinë 218 në vlerën 498,847 lekë dhe për llogarinë 32 në vlerën 261,428 lekë dhe shuma totale është 829,779 lekë. Ky procesverbal nuk është i miratuar nga titullari i SRGJ, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Është kryer heqja nga kontabiliteti i SRGJ nga nëpunësi zbatues z.D.T, pa ndjekur procedurën e saktë sipas Udhëzimit, gjithashtu pa nënshkrimin e titullarit, dhe pa dokumentacionin e duhur justifikues, me arsytet e nxjerrjes jashtë përdorimit, destinacionin përfundimtar të tyre etj.

Është hartuar relacion me nr. 450/2 prot, datë 31.12.2015 drejtuar titullarit të SRGJ në të cilin kërkohet miratimi i asgjesimit të inventarëve të mësipërm. Ky akt është nënshkruar nga D.T p/financës, nga V.T llog inventarizuese, dhe është miratuar nga zv.Drejtori Ekonomik A.B. Në këtë relacion nuk përshkruhet asnjë argument mbi secilin zë të aktiveve të cilat do të dalin jashtë përdorimit dhe do të asgjësohen, nuk përcaktohet destinacioni final ku do të kryhet asgjesimi i tyre, gjithashtu nga titullari i SRGJ nuk ka asnjë autorizim për caktimin e z.A.B si nëpunës Autorizues për verpime të mëtejshme të procesit të inventarizimit, pra nuk ka fuqi ligjore për vendimarrje të tillë, pasi referuar Ligjit nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, vendimarrja i takon titullarit të insitucionit.

Ngarkohen me përgjegjësi ish-drejtori i SRGJ z.K.K, në cilësinë e nëpunësit autorizues, përgjegjësi ish-zv.drejtori i SRGJ z.A.B, D.T në cilësinë e nëpunësit zbatues, znj.V.T, F.D, M.B, S.G dhe B.K në cilësinë e komisionit të miratimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjesimit.

Me Urdhrin nr. 450/1, datë 31.12.2015 drejtori i SRGJ z.K.K është ngritur komisioni i inventarizimit për inventarin e magazinave i përbërë nga V.T me detyrë inventarizuese, V.S përgjegjës i hotelërisë, dhe L.K ekonomiste.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Me urdhërat e mëposhtëm nga drejtori i SRGJ z.K.K janë krijuar komisionet e inventarizimeve për vitin 2015.

Nr	Urdhëri nr	Datë	Komisioni për inventarin e;	Anëtarët
1	449/1	23.12.2015	Repartit të Dializës, Dispanceri, Maternitet, Laborator, Administratë	E.P R.J K.M
2	449/2	23.12.2015	Skanerit, Elektricitist, Reparti i Oksigjenit, Kaldaja + Impianti i Diegies së Mbetjeve Spitalore, Morgu	D.Q E.Zh E.L
3	449/3	23.12.2015	Sherbimi i poliklinikës, Urgjencës dhe Kirurgjisë	F.Q M.S F.A
4	449/4	23.12.2015	Shërbimit të Reanimacionit, Salla e Operacionit Kirurgji, Puntë i Gjakut, Pediatri	R.J E.Zh A.D
5	449/5	23.12.2015	Reparti i Imazherisë, Rep. i Lavanterisë. Rep i kuzhinës	L.K M.M A.C
6	449/6	23.12.2015	Shërb. i Puntit Baktoreologjik. Rep i EZHE-së, Rep i EKG	E.P E.L A.LI
7	449/7	23.12.2015	Shërbimi Patologji-Infektiv	E.P E.LL A.LI
8	459	29.12.2015	Mjeteve të transportit	M.B D.Q A.M

Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Gjirokastër

Në secilin urdhër të hartuar ku janë caktuar personat përkatës, në asnjë rast nuk përcaktohet pozicioni i punës, apo specialiteti përkatës.

-Komisioni i Inventarizimit nuk ka përcaktuar personat përgjegjës për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, arësyet e gjendjes së tyre, për dëmtimet e konstatuara dhe shkaqet e tyre, dhe në asnjë rast nuk është hartuar relacion përkatës për veprime të mëtejshme nga Nënpunësi Autorizues, në kundërshtim nenin 85 gërma c, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i cili citon se;

“Komisioni i Inventarizimit duhet të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës...”

Ngarkohen me përgjegjësi ish-drejtori i SRGJ z.K.K, në cilësinë e nëpunësit autorizues, D.T në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe anëtarët e komisioneve përkatëse.

Për vitin 2016;

Me urdhërat e mëposhtëm nga drejtori i SRGJ z.K.K janë krijuar komisionet e inventarizimeve për vitin 2015.

Nr	Urdhëri nr	Datë	Komisioni për inventarin e;	Anëtarët
----	------------	------	-----------------------------	----------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

1	715	26.12.2016	Skanerit, Reparti i Oksigjenit, dhoma e Elektricitetit, Kaldaja dhe Morgu	S.P K.M F.Q
2	716	26.12.2016	Reparti i Imazherisë, Rep. i Lavanterisë. Rep i kuzhinës	R.J K.M M.B
3	717	26.12.2016	Shërbimi Patologji-Infektiv	M.M F.I M.B
4	718	26.12.2016	Repartit të Dializës, Dispanceri, Maternitet, Laborator, Administratë	E.P D.Q M.S
5	719	26.12.2016	Repartit të Reanimacionit, Salla e Operacionit, Rep.Punti i Gjakut, Rep.e Pediatri	F.A A.M F.D
6	720	26.12.2016	Shërbimi i poliklinikës, Shërb i Urgjencës dhe Rep. e Kirurgjisë	E.Zh A.LI V.S
7	720/1	26.12.2016	Shërb.i Puntit Baktoreologjik. Rep i EZHE-së, Rep i EKG, Laborator, administratë, Automjete	M.M E.P F.I

Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Gjirokastrë

Në secilin urdhër të hartuar ku janë caktuar personat përkatës, në asnjë rast nuk përcaktohet pozicioni i punës, apo specialiteti përkatës.

Nga titullari i SRGJ nuk është krijuar një komision i posaçëm i cili të mbikqyrë dhe të ndjekë procesin e inventarizimit, në të cilin duhej të caktohej nga nënpunësi zbatues për ndjekjen e këtij procesi, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Komisioni i Inventarizimit nuk ka përcaktuar personat përgjegjës për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, arësyet e gjendjes së tyre, për dëmtimet e konstatuara dhe shkaqet e tyre, dhe në asnjë rast nuk është hartuar relacion përkatës për veprime të mëtejshme nga Nënpunësi Autorizues, në kundërshtim nenin 85 gërma c, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i cili citon se;

“Komisioni i Inventarizimit duhet të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës...”

Gjithashtu komisioni i Inventarizimit nuk ka përcaktuar personat përgjegjës për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, arësyet e gjendjes së tyre, për dëmtimet e konstatuara dhe shkaqet e tyre, dhe në asnjë rast nuk është hartuar relacion përkatës për veprime të mëtejshme nga Nënpunësi Autorizues, në kundërshtim nenin 85 gërma c, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

Ngarkohen me përgjegjësi ish-drejtori i SRGJ z.K.K, në cilësinë e nëpunësit autorizues, D.T në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe anëtarët e komisioneve përkatëse.

Për vitin 2017;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Me urdhërin nr. 449, datë 15.11.2017, është krijuar komision për verifikimin e pajisjeve dhe asetëve që janë jashtë përdorimit, mbi të cilat të bëhet dhe propozimi nëse duhet të nxirren jashtë përdorimit këto pasjisje, i përbërë prej L.Q kryetar dhe anëtarët S.P dhe V.B. Me shkresën nr. 450 prot, urdhëri pa nr., datë 15.12.2017, të drejtorit të SRGJ z. P.M është krijuar komisioni për kryerjen e inventarizimit të institucionit me komision qëndror M.S kryetare dhe anëtarët B.A, J.B, M.M e J.K. Inventarizimi do të ndiqet nga specialistja përgjegjëse për inventarizimin z.V.T. Afati i përfundimit të kryerjes së inventarit dhe dhe hartimi i relacionit përfundimtar është caktuar data 15.12.2017.

Gjithashtu në urdhërin e krijuar është vendosur z.A.Sh i cili ka qënë në pozicionin e auditit të brendshëm të Spitalit Rajonal Gjirokastër, veprim ky i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 17, gërma a).

Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish-drejtorin e SRGJ z.P.M.

Me urdhërin nr. 488 prot, datë 20.12.2017, nga drejtori z.R.K, është krijuar komisioni i asgjesimit të materialeve të inventarit me përbërje, L.M me detyrë përgjegjëse i sektorit të shërbimeve mjedisore, K.Ç me detyrë përgjegjëse i sektorit të teknologjisë, D.Ç me detyrë përgjegjëse i sektorit të higjenës.

Me shkresën nr. 450/1prot, datë 18.12.2017, nga D.T dhe V.T është hartuar relacioni mbi inventarët e realizuara në fund të vitit 2017, në të cilin janë konstatuar inventar ekonomik për nxjerrje jashtë përdorimit në vlerë si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i sektorit	Material inventari/vlera	Mjete mjeksore/vlera	Inventar ekonomik/vlera
1	Reparti i shoferëve	26580		
2	Pediatria	62583	62757	104600
3	Patologjia	164483	42294	132680
4	EZHE	932	166276	
5	Infektivi	74484	16378	
6	Dhoma e mjekut	2130		
7	Materniteti	358612	31130	20500
8	Kirurgjia	229439	97961	172632
9	Salla e operac	359214	582404	18200
10	Radiologji	22026	234600	117
11	Punti i gjakut	6646		1300
12	Reanimacion	38087	10980	
13	Laborator	38380	106143	3150
14	Dializë	3520	48808	
15	Oksigjen	104312		
16	Poliklinika	51707	18868	6130
17	Punti baktereologjik	3100	183	
18	Morgu	8580		
19	Lavanteria	4529		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

20	Kuzhina	34201		58780
21	Kaldaja	39758		1100
22	Elektracisti	8400		
23	Administrata	82843		218222
24	Totali	1724546	1418782	737411

Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Gjirokastrë

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme shuma totale e materialeve të inventarit të cilat janë asgjesur është 3,880,739 lekë. Në lidhje me materialet e mësipëre u kërkua të vihej në dispozicion të grupit të auditimit dokumentacion justifikues për këto materiale, por u sollën një set fotokopje fotografish, të cilat nuk japin një pamje të arësyeshme për justifikimin dhe vërtetësinë e asgjesimit të tyre.

Gjithashtu nga komisioni i cili ka hartuar relacionin janë shprehur se komisioni i inventarizimit ka konstatuar mungesa material i butë në shumën 73,800 lekë, mungesa në kuzhinë në shumën 13,275 lekë dhe mungesa në repartin e oksigjenit në shumën 7,700 lekë dhe shuma totale **prej 94,775 lekë është konstatuar si dëm ekonomik për buxhetin e SRGJ**. Kjo shumë u është vënë në ngarkim personave përgjegjës dhe janë kryer regjistrimet kontabile në pasqyrat financiare të institucionit.

Në lidhje me vlerën prej 3,880,739 lekë të materileve të asgjesuara, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk përcaktohet mënyra e asgjesimit të tyre, nuk përcaktohet destinacioni përfundimtar, nuk ka dokumentacion justifikues, nuk ka miratim nga nëpunësi autorizues për procesin e asgjesimit, veprime e mosveprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 106 dhe 111-114. Shuma prej 3,880,739 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi ish-drejtori i SRGJ z.R.K, në cilësinë e nëpunësit autorizues, D.T në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe anëtarët e komisioneve përkatëse.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se Spitali Rajonal Gjirokastrë, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, nuk ka të evidentuar numrin e saktë të aktiveve, nuk ka kryer inventarizime fizike për mjetet themelore (asetet), në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-30.

Regjistri aktual kontabël i aktiveve referuar kartelave të tyre nuk i plotëson kërkesat e nenit 30 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i cili citon se;

“Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e bërjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Komisioni i Inventarizimit nuk ka përcaktuar personat përgjegjës për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, arsyet e gjendjes së tyre, si dhe për dëmtimet e konstatuara dhe shkaqet e tyre, në kundërshtim nënin 85 gërma c, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i cili citon se;

“Komisioni i Inventarizimit duhet të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës...”

Nga sa më sipër rezulton, se nga drejtori i Spitalit Rajonal Gjirokastër për secilën periudhë nuk janë marrë masat e duhura për kryerjen e procedurave të inventarit që duhet të kryhet në fund të vitit për të gjitha aktivet që ka në dispozicion SRGJ, gjithashtu nga nëpunësi zbatues nuk është marrë asnjë iniciativë për hartimin e të gjitha regjistrave kontabël në dispozicion, kryerjen e inventarit ekonomik dhe vlerësimit të të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktivet afatshkurtra dhe detyrimeve dhe të drejtave, veprime në kundërshtim të Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzime Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74, e cila citon se;

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Konkretisht nga sa më sipër konstatohet se nuk është kryer asnjëherë inventar fizik i aktiveve (Tokë-truall, Ndërtesa), të cilat ndodhen në kontabilitetin e SRGJ pasi nuk disponohet dokumentacion ligjor, nuk është marrë asnjë iniciativë për të kryer rregjistrimin në Zyrat Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastër, nuk mund të gjykohe nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni pra nuk verifikohet ekzistenca dhe dokumentacioni mbështetës i tyre, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, me Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

Në lidhje me procesin e inventarizimit fizik, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve për periudhën objekt auditimi konstatohet gjithashtu se në asnjë vit nuk është hartuar Gjurma Standarte e Auditit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 122.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi ish-drejtorët e SRGJ z. A.M, z.K.K, z. P.M. z.R.K në cilësinë e nënësit autorizues, z.A.B e z.M.G në cilësinë e N/Drejtorit Ekonomik, dhe znj.D.T në cilësinë e nënpunësit zbatues.

Në lidhje me mbajtjen e evidencës kontabile, respektimin e afateve për nxjerrjen e bilancit, dërgimin në organet e varësisë, analizën e debitorëve, kreditorëve rezultoi;

Spitalin Rajonal Gjirokastër, gjatë periudhës objekt auditimi ka zhvilluar një aktivitet normal në menaxhimin e fondeve publike. Kontabiliteti është organizuar dhe mbajtur në pajtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Ngjarjet dhe veprimet ekonomike janë regjistruar në regjistrat kontabël dhe mbahen në programin excel.

-Bilancet e çdo viti janë përgatitur brënda datës së fundit të muajit shkurt të vitit pasardhës dhe janë dërguar brenda afatit ligjor në Degën e Thesarit (DTH) Gjirokastër, shoqëruar me shkresat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

përcjellëse respektive për secilin vit dhe janë dërguar gjithashtu Drejtorisë së Financës së Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), konkretisht me shkresën nr. 137 prot, datë 26.02.2016 janë dërguar pasqyrat financiare të vitit 2015 në MSH dhe me shkresën nr. 137/1 datë 26.02.2016 në DTH. Me shkresën nr. 162 prot, datë 27.02.2017 janë dërguar Pasqyrat Financiare të vitit 2016 në MSH ndërsa me shkresën nr. 162/1prot, datë 27.02.2017 janë dërguar në DTH. Me shkresën nr. 72/3prot, datë 02.03.2018, janë dërguar PF të vitit 2017 në MSH, dhe me shkresën nr. 72/1 prot, datë 27.02.2018 janë dërguar në DTH.

-Të gjitha regjistrimet kontabile, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen në programin excel pasi insitucioni nuk ka të instaluar program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për njohjen dhe përdorimin e dokumentit elektronik, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij. Nga ana e institucionit nuk janë marrë iniciativa për instalimin dhe implementimin e një programi financiar duke vazhduar duke vepruar në mospërputhje dhe kundërshtim me Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar.

Për këto veprime dhe mosveprime mbajnë përgjegjësi ish-drejtori z.R.K , ish-drejtori znj.P.M, ish-drejtori z.K.K, sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar, nëpunësit zbatues z.A.B dhe z.M.G dhe P.Sektorit të Financës znj.D.T.

-Në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve të qëndrueshme të bilancit të vitit 2015, është kryer pakësime në zërin Instalime teknike, makineri, pajisje dhe velga pune në shumën 42,241,453 lekë. Kjo shumë ka ardhur si pasojë e konstatimit të bërë nga Përgjegjësjë e Sektorit të Financës znj.D.T të cilës ju kërkuan shpjegime në lidhje me pasqyrimin e kësaj shume në PF. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se në vitin 2012 me shkresën nr. 479, datë 02.02.2012, nga Drejtoria e Planifikimit Spitalor në Ministrinë e Shëndëtsisë është dërguar vendimi për zbatim nga Spitali Rajonal Gjirokastër, në lidhje me zbatimin e VKM nr. 888, datë 21.12.2011, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Spitalit Ushtarak Gjirokastër, nga Ministria e Shëndetsisë te Ministria e Brendshme, dhe për një shtesë në Vendimin nr. 250, datë 24.04.2003, të KM “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajshme shtetërore, të cilat i kalonë në përgjegjësi administrimi, Ministrisë së Rendit Publik”, i ndryshuar. Me fletëhyrjen nr. 6, datë 31.12.2012 janë bërë hyrje në magazinën e SRGJ disa artikuj të ardhur nga Spitali Ushtarak Gjirokastër, ndër të cilat një mikroskop meokular i cili ishte në vlerën 436,782.36 lekë. Ky artikull është rregjistruar në bilancin e vitit 2012 në vlerën 43,678,236 lekë. Në vitin 2015 është konstatuar se ky artikull është regjistruar gabim në pasqyrat financiare të SRGJ dhe janë kryer sistemimet kontabël në formatin nr. 6, të pasqyrave financiare, Gjendja dhe ndryshimet e AQT-ve. Ky aktiv është pakësuar në vlerën 42,241,453 lekë, ndërkohë që duhet të pakësohej me vlerën 43,241,453 lekë pra është pakësuar në 1,000,000 lekë më pak. *Këto veprime kanë sjellë një mosparaqitje të saktë dhe me besueshmëri të të dhënave financiare të institucionit të SRGJ, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe me Planin e Përgjithshëm Kontabël të Institucioneve Buxhetore në Republikën e Shqipërisë.*

-Për të 3 vitet, konstatohet se, relacioni dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare paraqitet i thjeshtë, me informacion të përgjithshëm, ku konstatohet se mungojnë sqarime të nevojshme për ecurinë e zërave të pasqyrave financiare. Mungojnë tërësisht shpjegimet dhe analiza e pasqyrës së flukseve monetare, në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 1 “Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare”, pika 67, ku përcaktohet se “Informacioni në pasqyrat financiare duhet të paraqitet në mënyrë të tillë që ai të jetë informues dhe pa ekuivok, për ata përdorues të pasqyrave financiare që kanë njohuri të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit për të kuptuar pasqyrat financiare”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

26.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaja”, dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik SNKP 1, paragrafi 128. Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare janë element i rëndësishëm, të cilat duhet ndër të tjera të sigurojnë edhe atë informacion shtesë, që nuk mund të paraqitet në të gjitha formatet e pasqyrave financiare.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi P.Sektorit të Financës znj.D.T.

Në lidhje me zërin ndërtesa dhe troje të cilat paraqiten në kontabilitetin e institucionit SRGJ, rezulton se për këto aktive nuk ka asnjë dokumentacion pronësie, nga ana e drejtuesve të këtij institucioni për periudhën objekt auditimi konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për ti regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Gjithashtu nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, veprime të cilat janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, me Ligjin Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

Për këto veprime e mosveprime ngarkohet me përgjegjësi ish-drejtorja z.K.K, ish-drejtori z.P.M, z.R.K sipas periudhave në të cilat kanë drejtuar, dhe P.Sektorit të Financës znj.D.T.

Referuar pasqyrave financiare të vitit 2015, 2016 dhe 2017 rezulton se;

Nga ana e institucionit nuk është kryer asnjëherë analizë në lidhje me gjendjen e llogarive debitoare dhe kreditore, për arkëtimin e shumave debitoare dhe likuidimin që SRGJ ka ndaj të tretëve, mbi të cilën të merren masa të mëtejshme për uljen e këtyre detyrimeve, apo arkëtimeve.

Në vitin 2015 gjendja debitoare për gjoba, penalitete dhe detyrime të cilat janë gjeneruar për punonjësit e institucionit nga kontrollat e FSDKSH-së apo gjoba e penalitete të operatorëve privatë, detyrime këto të cilat duhet të mblidhen dhe arkëtohen nga Spitali Rajonal Gjirokastrë, konstatohet se vlera në fund të vitit 2015 paraqitet në shumën 588,653 lekë. Në fund të vitit 2016 paraqitet në shumën 2,692,090 lekë dhe në fund të vitit 2017 paraqitet në shumën 1,952,840 lekë. Nga ana e institucionit nuk janë marrë masat e duhura për nisjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 9, neni 12, pika g dhe gj, dhe shuma prej 1,952,840 lekë konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Gjithashtu paraqiten edhe debitorë të tjerë të cilët janë operatorë ekonomik apo mbikqyrës punimesh të cilët nuk kanë zbatuar kushtet e kontratave duke gjeneruar penalitete dhe gjoba, të cilat janë njohur në pasqyrat financiare të SRGJ. Këto penalitete janë konstatuar nga kontrollat e vazhdueshme të kryera nga FSDKSH ndaj SRGJ. Këta debitorë pasqyrohen në tabelën më poshtë;

Nr	Emër Mbiemër/Subjekti	Përshkrimi i subjektit	Shuma
1	T.M	Operator ekonomik fitues tenderi	555,940
2	P.Dh	Mbikqyrës punimesh	553,106
3	C-B Sh.p.k	Operator ekonomik fitues tenderi	384,368
4	A.Zh	Mbikqyrës punimesh	47,900
5	A.T	N/Drejtori Teknik	34,628



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

6	F SHPK	Operator ekonomik fitues tenderi	376,800
7	T-D SHPK	Operator ekonomik fitues tenderi	456,000
8	J.C SHPK	Operator ekonomik fitues tenderi	476,400
TOTALI			2,885,142

Burimi të dhënave; Spitali Rajonal Gjirokastrë

Nga ana e insitucionit nuk janë marrë masat e duhura për nisjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 9, neni 12, pika g dhe gj, dhe shuma prej 2,885,142 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

Për këto veprime dhe mosveprime mban përgjegjësi ish-drejtori z.K.K, ish-drejtorin z.P.M dhe ish-drejtorin z.R.K.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

1. Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar,
2. Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe
3. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 1) Z.A.M me detyrë, ish-Drejtor i SRGj në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 2) Z. K.K me detyrë ish- Drejtor i SRGj në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 3) Z.P.M me detyrë ish- Drejtor i SRGj në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 4) Z.R.K me detyrë ish-Drejtor i SRGj në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 5) Znj. D.T me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës në cilësinë e nëpunësit zbatues.
- 6) Z.A.B me detyrë zv.drejtor ekonomik në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 7) Z.F.D, Z.M.B, Z.B.K dhe Znj.V.T në cilësinë e anëtarëve të komisionit të asgjësimit.

Në observacionin e dërguara me shkresën nr. 440/52 prot, datë 01.08.2018 dhe nr. 442/9 datë 03.08.2018 të protokollit të KLSH nga punonjësit K.K, A.B, D.T, F.D, M.B, S.G dhe B.K të cilët janë atakuar në këtë Projektraport Auditimi ju bëjmë me dije se;

Nga ana e observuesve është kërkuar marrja parasysht e observacionit për sa i përket procedurave të nxjerrjesh jashtë përdorimi të materialeve në këtë institucion. Për këtë observuesit ka sjellë urdhrin nr. 195/2, datë 09.10.2015 të ish.drejtorit të spitalit A.M për ngritjen e komisionit të verifikimit të materilave për nxjerrje jashtë përdorimi të përbërë nga: V.T, J.K dhe F.SH. Urdhëri nr. 195/3 datë 09.10.2015 të ish.drejtorit të spitalit A.M për ngritjen e komisionit të asgjësimit të materilave për nxjerrje jashtë përdorimi të përbërë nga: F.D, M.B, S.G dhe B.K. Gjithashtu bashkëlidhur me observacionin është sjellë dhe dokumentacioni vërtetues për procesin e asgjësimit të këtyre materialeve, Tabelën me të dhënat informuese për secilin artikull, fletë daljet e magazinës që vërtetojnë datën e futjes në përdorim nga subjektit të këtyre artikujve, kartelat individuale të magazinës për secilin artikull.

Nisur nga sa më sipër observacioni merret në konsideratë.

VII. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Ne Spitalin Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastër për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 68 procedura prokurimi si dhe 34 kontrata shtesë me vlerë prej 435.6 milion lekë.

Nga grupi i auditimit janë audituar 26 procedura prokurimi si dhe 11 kontrata shtesë me vlerë 276.4 milionë lekë, 63 % e investimeve të realizuar ose 38% e procedurave kryesisht ato me vlerë më të madhe dhe me rrisht më të lartë.

Vlera prej 159.2 milion lekë për tendera të pa audituar i përket shpenzimeve për material mjeksore për imazherinë, oksigjen mjeksorë, ushqime pasi nga përlllogaritja e përvitshme dhe mesatarja e të shtruarve rezultoi të mos kishte rritje krrhasimisht me vitet e mëparshme etj.

-Ne lidhje me procedurat për blerje Medikamente, Material mjekimi si dhe Kite&reagent në këtë institucion u konstatua se edhe pse është e parashikuar qartë në kontratën e lidhur mes palëve kushtet e furnizimit dhe afatet e furnizimit, nga ana e operatorëve ekonomik fitues në kundërshtim me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 659-704 “Kontratat”, si dhe kontratën respektive nenet 3 dhe 6 të saj, me dijeni të plotë kanë furnizuar me medikamente, materiale mjeksore apo Kite&Reagent jo në përputhje me cilësinë e kërkuar dhe pranuar mes palëve si dhe kanë kryer furnizimet me këto artikuj jo në afatin e miratuar. Nga ana e ish-drejtorit K.K edhe pse janë evidentuar këto mangësi në kundërshtim me kontratën në dy raste ka miratuar kërkesën për shtyrje afati pa bazë ligjore të furnizimit me këto artikuj.

-Nga auditimi u konstatua se:

1. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Medikamente”-Janar 2016.

Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi nr.81prot.datë 05.02.2016 z.K.K	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 81, datë 05.02.2016 Znj. A.LI	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 81/1,datë 05.02.2016 Z. A.B Kryetar Znj. F.D Znj. R.J
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Negociim pa shpallje”	Znj. G.B Znj. M.B	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 11,835,827 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “FF” SHPK9,630,623lekë pa tvsh Oferta vetëm për 175 nga 230 lote	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,205,204 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 12.02.2016 Ora 12:00	9.Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 O.E. b)S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b.Zbatimi i Kontratës me objekt: “Blerje medikamente”		
14.Lidhja e kontratës Nr.108 prot., datë 19.02.2016	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 9,630,623.17lekë	16.Likuiduar 8,882,033 lekë3

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar nga relacioni nr. 57 prot datë 02.02.2016 për mungesën e medikamente në këtë institucion si dhe kërkesat e secilit pavion. Në referencë të relacionit nr. 57 datë 02.02.2016 nga pavionet nën drejtori ekonomik A.B ka hartuar një relacion të dytë nr. 30/1 datë 04.02.2016 duke ja përcjellë titullarit dhe marrë miratimin e tij.

-Me shkresën nr. 25 prot. datë 12.01.2016 Drejtori i spitalit K.K i kërkon Ministrisë së Shëndetësisë miratim procedure.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Me shkresën nr. 516 datë 26.01.2016 Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Administrimit të Spitalit ka dërguar shkresën për riformulim të planifikimit për nevojat për medikamente dhe materiale mjeksore për vitin 2016.

-Me shkresën nr. 600/1 datë 29.01.2016 Minsitria e Shëndetësisë ka dërguar shkresën për *lejimin e institucioneve spitalore të kryejnë procedurate e prokurimit për disa nga medikamentet dhe disa nga materialet mjeksore të vitit 2016.*

a) *Për medikamentet, fondi limit i të cilave në kërkesat totale të përqëndruara për çdo artikull është nën vlerën 800 000 lekë, pa TVSH (sipas kërkesës së miratuar për çdo spital.*

b) *për mbulimin e nevojave për medikamente dhe materiale mjekimi për periudhën fillim viti deri më 15 prill 2016, në pritje të realizimit të procedurave të përqëndruara të prokurimit, sipas kërkesës së miratuar për çdo institucion.*

Në kundërshtim me Shkresën nr. 600/1 datë 29.01.2016 të Ministrit të Shëndetësisë z.I.B të pikës a të saj e cila citon: *Për medikamentet, fondi limit i të cilave në kërkesat totale të përqëndruara për çdo artikull është nën vlerën 800 000 lekë, pa TVSH..*

Spitali Rajonal Omer Nishani ka hartuar preventivin për medikamente dhe miratuar nga drejtori K.K dhe për medikamete kërkesa e të cilave për procedurën e përqëndruar është më e madhe se 800,000 lekë pa TVSh, për medikamentet si më poshtë:

Nr	Sistemi	Principiaktiv	forma	Përqe. vlere	Sipasofertes -15.4.2016
1	Anti-infektive	Cefazolinë sodium	1 gram	814,684	221,080
2	Anti-infektive	Ceftriaxone	1 gram	1,272,063	459,840
3	Gjakudheorganet	Heparin Sodium	25000ui	859,120	
4	Gjakudheorganet	Sodium Chloride	0.9%-1000ml	3,421,674	79,500
5	Sistemnervor	Paracetamol	1 gr	936,190	
	Totali				

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 81 datë 05.02.2016 për procedurën e prokurimit “Blerje medikamente” me fond limit 11,835,827 lekë pa TVSH si dhe ka krijuar Njësinë e prokurimit të përbërë nga: A.LI, G.B dhe M.B.

Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 81/1 datë 05.02.2016 për procedurën e prokurimit “Blerje medikamente” si dhe ka krijuar ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: A.B kryetarë, F.D dhe R.J anëtare.

Me procesverbalin datë 05.02.2016 njësia e prokurimit e ngritur pranë spitalit Rajonal Omer Nishani e përbërë nga A.LI, G.B dhe M.B ka hartuar dokumentat e tenderit dhe ka dërguar ftesat për ofertë 6 operatorëve si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “RO PHARMA” shpk Tiranë Nipt; K83104001J
2. Operatori ekonomik “FF” shpk Tiranë Nipt; K21405001N
3. Operatori ekonomik “IA” shpk Tiranë Nipt; K21912001N
4. Operatori ekonomik “F” shpk Tiranë Nipt; K01514009I
5. Operatori ekonomik “I” shpk Tiranë Nipt; K91530017T
6. Operatori ekonomik “S” shpk Tiranë Nipt; J62903574L

Me procesverbalin datë 12.02.2016 të hapjes së ofertave nuk u paraqit asnjë ofertë.

Me vendimin nr. 93 datë 12.02.2016 titullari i autoritetit kontraktorë ka shpallur anulimin e procedurës së prokurimit “Blerje medikamente”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Me vendimin nr. 93 datë 12.02.2016 titullari i autoritetit kontraktorë ka shpallur anulimin e procedurës së prokurimit “Blerje medikamente”.

b. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Drejtori i spitali K.K ka nxjerrë urdhërin nr. 51/1 datë 02.02.2016 për hartimin e kërkesave për blerje barna e materiale mjekimi duke ngritur komisionin e përbërë nga R.Ku N/drejtor teknik, M.Z P/Farmacisë dhe J.K K/Infermier.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar nga nën drejtori ekonomik me relacionin nr. 95/1 prot datë 12.02.2016 praqitur drejtorit të spitalit K.K dhe miratuar prej tij ku citohet: Nisur nga dështimi i procedurës së parë nga numri i madh i artikujve dhe pamundësisë për realizimin e tyre propozojmë që kjo procedurë prokurimi të zhvillohet e ndarë me lote.

-Me shkresën nr. 50 prot. datë 28.01.2016 Përgjegjësjë e farmacisë M.Z ka informuar drejtorin e spitalit për kushtet e këqia të farmacisë si dhe mungesën e theksuar për barna

-Me shkresën nr. 600/1 datë 29.01.2016 Minsitria e Shëndetësisë ka dërguar shkresën për *lejimin e institucioneve spitalore të kryejnë proceduratë e prokurimit për disa nga medikamentet dhe disa nga materialet mjeksore të vitit 2016.*

a) Për medikamentet, fondi limit i të cilave në kërkesat totale të përqëndruara për çdo artikull është nën vlerën 800 000 lekë, pa TVSH (sipas kërkesës së miratuar për çdo spital.

b) për mbulimin e nevojave për medikamente dhe materiale mjekimi për periudhën fillim viti deri më 15 prill 2016, në pritje të realizimit të procedurave të përqëndruara të prokurimit, sipas kërkesës së miratuar për çdo institucion.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 99 datë 15.02.2016 për procedurën e prokurimit “Blerje medikamente” me fond limit 11,835,827 lekë pa TVSH si dhe ka krijuar Njësinë e prokurimit të përbërë nga: A.LI, G.B dhe M.B.

Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 100 datë 15.02.2016 për procedurën e prokurimit “Blerje medikamente” si dhe ka krijuar ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: A.B kryetarë, F.D dhe R.J anëtare.

Me procesverbalin datë 15.02.2016 njësia e prokurimit e ngritur pranë spitalit Rajonal Omer Nishani e përbërë nga A.LI, G.B dhe M.B ka hartuar dokumentat e tenderit dhe ka dërguar ftesat për ofertë 6 operatorëve si më poshtë:

- 1.Operatori ekonomik “RO PHARMA” shpk Tiranë Nipt; K83104001J
- 2.Operatori ekonomik “FF” shpk Tiranë Nipt; K21405001N
- 3.Operatori ekonomik “IA” shpk Tiranë Nipt; K21912001N
- 4.Operatori ekonomik “C” shpk Tiranë Nipt; J61908046W
- 5.Operatori ekonomik “S” shpk Tiranë Nipt; J62903574L

Me procesverbalin datë 19.02.2016 të hapjes së ofertave ku ka paraqitur ofertë vetëm një operatorë ekonomik “FF” shpk me ofertë 9,630,623 lekë.

Me procesverbalin datë 19.02.2016 të vlerësimit ofertave ku është kualifikuar dhe rënditur në vend të parë si ofertë e vetme e sukseshme ajo e operatorit ekonomik “FF” shpk me ofertë 9,630,623 lekë për 175 lote në procedurë.

Me vendimin nr. 100/1 datë 19.02.2016 titullari i autoritetit kontraktorë ka shpallur fitues operatorin e ekonomik “FF” shpk në procedurën e prokurimit “Blerje medikamentesh” me vlerë 9,630,623 lekë pa tvsh.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

a.Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 108 prot., datë 19.02.2016, me vlerë 9,630,623.17lekë, me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 19.03.2016. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër K.K dhe administratori i shoqërisë “F” shpk A.T.

Nga auditimi i furnizimeve për verifikimin e zbatimit të kontratës u konstatua se:

Në kontratën e lidhur mes palëve në nenin 3 Afati i lëvrimit janë përcaktuar dhe pranuar nga palët kushtet e lëvrimit të mallit si dhe penalitetet në vonesat në lëvrimit.

Gjithashtu në këtë kontratë në nenin 6 Cilësia e mallit është përcaktuar dhe pranuar nga palët që data e skadencës në asnjë rast nuk duhet të jetë më e madhe se ½ e kohës midis datës së prodhimit dhe asaj të skadencës (në pjesën më të madhe të kontratave citohet dhe se jo më të vogël se 12 muaj kalendarik).

Referuar furnizimeve ky operator ka kryer 7 furnizime në një vlerë totale prej 8,882,033 lekë dhe ka mbetur pa furnizuar 748,590 lekë, nga ana e autoritetit kontraktorë edhe pse nuk e ka realizuar kontratën me sukses nuk është mbajtu sigurimi i kontratës në vlerën prej 963,063 lekë.

1-Me urdhër shpenzimin nr.66 datë 04.03.2016 është likujduar fatura nr. 2547 datë 25.02.2016 me vlerë 2,136,070 lekë, furnizimi i parë sipas kontratës shoqëruar me flet hyrjen nr. 13 datë 25.02.2016 nënshkruar nga ish përgjegjsja e farmacisë M.Z.

Referuar procesverbalit të kolaudimit dhe marrjes në dorzim datë 25.02.2016 për faturën nr. 2547 datë 25.02.2016 të hartuar nga komisioni i përbëra nga M.Z, Sh.C, V.T dhe J.K u konstatua se janë pranuar dy artikuj barna Ciprofloxacine me datë skadence Dhjetor 2016 dhe Vitamina B1 me datë skadence Shtator 2016, barna të cilat nuk duheshin pranuar nga komisioni i kolaudimit dhe marrjes dorzim duke respektuar një afat minimal skadence pre 12 muajsh pa llogaritur kushtet e ruajtjes se medikamenteve në farmacinë e sptalit që automatikisht ja përgjysmojnë jetgjatësinë.

Nr	Emertimi	Forma	njësia	çmimi	Sasia	Vlera	fatura	skadencia
1	Ciprofloxacine	400mg/200ml	Flakon	1,362.7	25	34,068	2547 dt. 25.02.2016	Dhjet 16
2	Vitamina B1	50 mg- 1 ml	Ampul	54	100	5,400	2547 dt. 25.02.2016	Shtato 16
						39,468		

Pranimi i barnave jo në përputhje me kushtet e kontratës ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit kolaudimit dhe marrjes në dorzim.

2-Me urdhër shpenzimin nr.113 datë 06.04.2016 është likujduar fatura nr. 8579 datë 10.03.2016 me vlere 1,903,621lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 18 datë 10.03.2016 nënshkruar nga ish përgjegjsja e farmacisë M.Z.

Referuar procesverbalit të kolaudimit dhe marrjes në dorzim datë 10.03.2016 për faturën nr. 8579 datë 10.03.2016 të hartuar nga komisioni i përbëra nga M.Z, Sh.C, V.T dhe J.K u konstatua se është pranuar një artikull barna Bromhexine me datë skadence Shtator 2016, barna të cilat nuk duheshin pranuar nga komisioni i kolaudimit dhe marrjes dorzim duke respektuar një afat minimal skadence pre 12 muajsh.

Nr	Emertimi	Forma	njësia	çmimi	Sasia	Vlera	fatura	skadencia
1	Bromhexine	8mg	Tablet	4.32	50	216	8579dt.06.04.2016	Shtator 16
						216		

Pranimi i barnave jo në përputhje me kushtet e kontratës ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit kolaudimit dhe marrjes në dorzim.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

3-Me urdhër shpenzimin nr.114 datë 06.04.2016 është likujduar fatura nr. 8588 datë 16.03.2016 me vlerë 2,681,750 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 19 datë 19.03.2016 nënshkruar nga ish përgjegjsja e farmacisë M.Z.

Referuar procesverbalit të kolaudit dhe marrjes në dorzim datë 16.03.2016 për faturën nr. 8588 datë 16.03.2016 të hartuar nga komisioni i përbëra nga M.Z, Sh.C, V.T dhe J.K u konstatua se janë pranuar dy artikuj barna Insulinë mikse 25/75 me datë skadence Djetor 2016 dhe Caneine sodium benzoate me datë skadence tetor 2016, barna të cilat nuk duheshin pranuar nga komisioni i kolaudit dhe marrjes dorzim duke respektuar një afat minimal skadence pre 12 muajsh.

Nr	Emertimi	Forma	njësia	çmimi	Sasia	Vlera	fatura	skadencia
1	Insulinëmikste	100UI/ML	Shiring	564.73	5	2823.6	8588dt.19.03.2016	Dhjetor 16
2	Caneinesodiu	20%-1ml	Ampul	48.6	5	243	8588dt.19.03.2016	Tetor 16
						3,066.6		

Pranimi i barnave jo në përputhje me kushtet e kontratës ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit kolaudit dhe marrjes në dorzim.

-Me shkresën nr. 178 prot datë 21.03.2016, dy ditë pas përfundimit të afatit për lëvrimitin total të kontratës operatori ekonomik me përfaësues drejtuesin teknik P.H ka bërë kërkesën për shtyrjen e afatit të furnizimit me medikamente për arsye se nuk i disponon të gjitha medikamentet dhe pasi ai nuk është importues i të gjithë gamës së tyre.

Edhe pse shkresa ka ardhur dy ditë pas përfundimit të afatit ish drejtori i spitalit Gjirokastër ka miratuar këtë kërkesë më datë 13.04.2016 nr. 178/1 prot. duke shtyrë afatin deri më 15.04.2016 ndërkohë që deri në këtë datë ky operator ka vazhduar furnizimit pa pasur pengesa në llogaritjen e penaliteteve nga SRGJ.

Miratimi i shtesës së afati pa arsye të ligjshme, pasi sasi e kërkuar nga SRGJ është minimale krahasuar me Spitalet e tjerë Rajonal apo spitalin e Tiranës **si dhe në asnjë pikë të kontratës nuk parashikohet të ketë shtesë afati në ekzekutimin e kontratës për 1 apo më shumë arsye ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin K.K.**

4-Me urdhër shpenzimin nr.115 datë 06.04.2016 është likujduar fatura nr. 8588 datë 16.03.2016 me vlerë 11,549 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 21 datë 23.03.2016 nënshkruar nga ish përgjegjsja e farmacisë M.Z.

Referuar nenit 3 Afati i lëvrimit pika 8. Ku shprehet se: Nëse shitësi vonon lëvrimitin e mallit në depon e Spitalit përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet 4/1000 të vlerës së mallit të palëvruar për cdo ditë vonese.

Afati maksimal i furnizimit të gjithë mallit është datë 19.03.2016, deri më këtë datë operatori ekonomik ka furnizuar vetëm 6,721,441 lekë ose 70% të vlerës.

Për furnizimin e datës 23.3.2016 sipas flethyrjes autoriteti kontraktorë duhet ti llogariste penalitetin $2,909,182 \times 4/1000 \times 3$ ditë = **34,910 lekë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit i pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “FF” SHPK.**

5-Me urdhër shpenzimin nr.116 datë 06.04.2016 është likujduar fatura nr. 8588 datë 16.03.2016 me vlerë 252,106 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 22 datë 25.03.2016 nënshkruar nga ish përgjegjsja e farmacisë M.Z.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Referuar nenit 3 Afati i lëvrimit pika 8. Ku shprehet se: Nëse shitësi vonon lëvrimin e mallit në depon e Spitalit përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet 4/1000 të vlerës së mallit të palëvruar për cdo ditë vonese.

Afati maksimal i furnizimit të gjithë mallit është datë 19.03.2016, deri më këtë datë operatori ekonomik ka furnizuar vetëm 6,732,990 lekë ose 70% të vlerës.

Për furnizimin e datës 25.3.2016 sipas flethyrjes autoriteti kontraktorë duhet ti llogariste penalitetin $2,897,633 \times 4/1000 \times 5$ ditë = **57,952 lekë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit i pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “FF” SHPK.**

6-Me urdhër shpenzimin nr.143 datë 21.04.2016 është likujduar fatura nr. 8588 datë 16.03.2016 me vlerë 118,650 lekë shoqëruar me flet hyrjen nr. 23 datë 31.03.2016 nënshkruar nga ish përgjegjsja e farmacisë M.Z.

Referuar nenit 3 Afati i lëvrimit pika 8. Ku shprehet se: Nëse shitësi vonon lëvrimin e mallit në depon e Spitalit përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë, do ti paguaj blerësit penalitet 4/1000 të vlerës së mallit të palëvruar për cdo ditë vonese.

Afati maksimal i furnizimit të gjithë mallit është datë 19.03.2016, deri më këtë datë operatori ekonomik ka furnizuar vetëm 6,985,096 lekë ose 72.5% të vlerës.

Për furnizimin e datës 25.3.2016 sipas flethyrjes autoriteti kontraktorë duhet ti llogariste penalitetin $2,645,527 \times 4/1000 \times 11$ ditë = **116,403 lekë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit i pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “FF” SHPK.**

F.v pusëtë lidhje e rrjetit me rrjetin e jashtëm të shkarkimit të ujërave të zeza HD-PE, thellësia mbi 1m 100x100.	copë	5	20000	100,000
SHUMA TOTALE				2,459,500

Tabela A

Nga sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. T.S.

III. Nga verifikimi në objekt dhe dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit u konstatua se nuk janë kryer punime të cilat rezultojnë të paguara në situacionin me vlerë **474,198 lekë pa TVSh (Tabela B)**. Përkatësisht për:

Zërin V. 1 Shtresë lustër çim 1:2 për nivelim t=2cm në tarracë. Shtresa e lustrës së çimentos është paguar në situacion 1087 m². Në librezën e masave është pasqyruar 1087 m² shtresë lustër çimento. Nga matjet e kryera sipas projektit të azhurnuar dhe matjet faktike sipërfaqja e tarracës+parapet rezulton 899.8 m² (Paraqitur në mënyrë të detajuar në anekse). Diferenca e sipërfaqes së shtresës së lustër çimento është 187.2 m². Vlera e diferencës prej 187.2 m², është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zërin V. 2 H/izolim 2 duar guajn alumini (1kk+1al t=4mm). Shtresa e hidroizolimit është paguar në situacion 1118 m². Në librezën e masave është pasqyruar 1118 m² hidroizolim. Nga matjet e kryera sipas projektit të azhurnuar dhe matjet faktike sipërfaqja e tarracës+ parapet rezulton 899.8 m² (Paraqitur në mënyrë të detajuar në anekse). Diferenca e sipërfaqes të hidroizolimit është 218.2 m³. Vlera e diferencës prej 218.2 m², është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Zërin VII. 2 Suvatim mur tulle i brendshëm. Sipërfaqja e suvatimit të brendshëm është paguar në situacion 5560 m². Në librezën e masave është pasqyruar 5625m² suvatim i brendshëm. Nga matjet e kryera sipas projektit të azhurnuar dhe matjet faktike, sipërfaqja suvatimit të brendshëm rezulton 5625m²- 509.1 m²= 5115.9 m². Në librezën e masave është zbritur gjysma e sipërfaqeve të dyerve dhe dritare, ku faktikisht duhej zbritur sipërfaqja e plotë, sepse për dritaret është zbritur sipërfaqja e tyre gjatë llogaritjes së suvatimit të jashtëm, ndërsa për dyert nuk kuptohet pse është zbritur gjysma e sipërfaqes dhe jo e plotë. (Diferencat e zbritjeve janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në anekse). Diferenca e sipërfaqes të suvatimit të brendshëm është 5560m²-5115.9 m²= 444.1 m². Vlera e diferencës prej 444.1 m², është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

	“Rikonstruksion i Godinës së Maternitetit Gjirokastër”	Njësia	Çmimi	Sasia Situacion	Sasia Librezë	Sasia Faktike	Diferenca	Diferenca
Zëri	EMERTIMI		Lekë	Njësi	Njësi	Njësi	Sasi	Lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Kontrata bazë								
V. Punime tarrace								
1	Shtresë lustër cim 1:2 për nivelim t=2cm në tarracë	m2	300	1087	1087	899,8	187,2	56,160
2	H/izolim 2duar guajan alumini (1kk+1al t=4mm)	m2	1,000	1118	1118	899,8	218,2	218,200
VII. Punime suvatimi veshje								
1	Suvatim mur tulle i brendshëm	m2	450	5560	5625	5115,9	444,1	199,838
DIFERENCA								474,198

Tabela B

Nga sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. T.S.

IV. Nga verifikimi në objekt, dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit, dhe dokumentacioni i negocimit i ndodhur në dosjen e kontratës shtesë, u konstatua rritje fiktive e çmimeve të zërave, mos realizmin i disa zërave sipas preventivit dhe situacionit në vlerën **57,200 lekë pa TVSh (Tabela C)**. Përkatësisht për:

Zërin VI. 4 Shtresë pllaka porcelanat importi 60x60 cm (korridoret). Nga verifikimi në objekt, konstatohet se në korridore nuk është vendosur pllakë porcelanat importi me dimensione 60x60 cm, por ‘Shtresë pllaka gres importi 40x40 cm’. Në situacion është paguar për pllakë porcelanat importi me dimensione 60x60cm me vlerën 1,500 lekë/m². Çmimi i “Shtresë pllaka gres importi 40x40 cm” i ofertuar në preventiv është 1,400 lekë /m². Diferenca në çmim midis pllakës 60x60cm të paguar në situacion me pllakën 40x40 cm të vendosur në fakt është 1,500 lekë/m² – 1,400 lekë/m² = 100 lekë/m². Vlera 100 lekë/m², është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Sipërmarrësi dhe grupi i negocimit për çmimet e zërit të mësipërm duhet ti ish referuar çmimeve të përcaktuar në Manualin 2 të çmimeve të ndërtimit të miratuar me VKM Nr. 629, datë 15.7.2015. Veprimet e mësipërme janë kundërshtim me: VENDIMIN Nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” ku përcaktohet se: 9) *Preventivat, pa përjashtim, për objektet e reja, me financimin, publik ose privat, të projektuara nga subjekte, shtetërore apo private, që ushtrojnë veprimtari në fushën e projektimit dhe të preventivimit të objekteve të ndërtimit, të llogariten duke përdorur çmimet e manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, bazuar në analizat teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit, të përfshira në manual.* 10) *Të gjitha subjektet, private apo publike, që kryejnë veprimtari në fushën e tregtimit të materialeve apo të produkteve të ndërtimit ose në fushën e ndërtimit e që marrin pjesë në tenderë publike, detyrohen të paraqesin analizat teknike për çmimet e ofertave të tyre për çdo zë punimi ndërtimor, sipas formatit të unifikuar dhe programit të miratuar dhe metodologjisë së përcaktuar në kreun I të udhëzimit nr. 2, datë 8.5.2003 të Këshillit të Ministrave.* 11) *Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programime të fondeve, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të llogarisin çmimet e zërave të punës, për të përcaktuar vlerën limit të objektit, në bazë të manualit të miratuar të çmimeve të ndërtimit, mbështetur në analizat teknike të çmimeve.* 12) *Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë prokurime të punimeve të ndërtimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatorë të huaj, detyrohen të kontrollojnë çmimet për zërat e punës, të ofertave të paraqitura në tender, me çmimet e bazuara në manualin e çmimeve të ndërtimit dhe në analizat teknike të këtyre çmimeve, të llogaritura, me programin e miratuar”, të cilat kanë sjell një dëm ekonomik me vlerën 57,200 lekë pa TVSh (paraqitur në mënyrë të detajuar në Tabelën C).*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Nga sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e grupit të negocimit të përbërë nga z. A.B, znj. F.D dhe z. S.P.

<i>"Rikonstrukcion i Godinës së Maternitetit Gjirokastrë"</i>	Njësia	Sasi Situacion	Çmimi Situacion	Çmimi Manual 2015	Diferenca	Diferenca
EMERTIMI		Njësi	Njësi	Njësi	Çmim	Lekë
Kontrata bazë						
VI. Punime shtresash						
Shtresë pllaka porcelanat importi 60x60 cm (korridorët)	m ²	572	1500	1400	100	57,200
DIFERENCA						57,200

Tabela C

Si përfundim, sipërmarrësi i punimeve "A K" ShPK ka përfituar më tepër vlerën **531,398 lekë pa TVSh** nga të cilat vlera 474,198 lekë pa TVSh për punime të pakryera si dhe vlera 57,200 lekë pa TVSh prej rritjes në mënyrë fiktive të kontratës shtesë si pasojë e rritjes së çmimeve të zërave të negociuar, në kundërshtim kjo me pikën 5.1 të Udhëzimit të KM Nr. 3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve" i ndryshuar, Ligjin 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe Vendimin Nr. 514, Datë 15.8.2007 "Për Informatizimin e Llogaritjes së Kostos dhe Hartimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit". Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. T.S, përfaqësues i "M.S" ShPK.

Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 7, datë 19.04.2018.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve ing. T.S përfaqësues ligjor i subjektit "M.S" ShPK, është bërë observacioni me nr. 442/3 prot. datë 09.07.2018 nga ana e të cilit pretendohet se:

Argumente dhe shpjegime nga subjekti i audituar:

1. Ka qenë në praktikën e investimeve shtetërore, me destinacion rikonstrukcion objekteve që nuk është materializuar kuadri ligjor e nënligjor për nxjerrjen e lejeve të ndërtimit në fjalë të cilat sot kanë një trajtim më rigoroz me ligjshmërinë;
2. Në lidhje me tabelën A ku janë hequr punime në vlerën 2,459,500 lekë pa argumente teknike sqarojmë se në çdo projekt ekzistojnë diferenca në volume të projektit me preventivin. Edhe në këtë projekt ka diferenca me pluse dhe minuse të cilat rrjedhin nga mos hartimi i saktë i preventivit si dhe gjatë implementimit të të kërkesave të përfituesit;
3. Në lidhje me tabelën B

a. Zërin V. 1 Shtresë lustër çimento 1:2 për nivelim $t=2\text{cm}$ në tarracë

b. Zërin V. 2 H/izolim 2 duar guajn alumini (1kk+1al $t=4\text{mm}$)

Këta zëra janë llogaritur në librezën e masave përkatëse dhe për to janë llogaritur pjerrësitë e, ngritjet dhe shkeljet mbi trashësinë e parapeteve sipas detajit të ri të miratuar (shkelja e parapetit vetëm për h/izolimimin). Për këtë arsye ka dhe diferencë.

4. Në lidhje me zërin Suvatim mure tulle i brendshëm sqarojmë se volumet janë përlllogaritur korrekt në librezën e masave në sasinë 5625 m² dhe janë vjelë 5560 m². Dritaret janë zbritur 50 % nga brenda dhe 80 % nga jashtë duke zbatuar udhëzimet e manualit në fuqi si dhe shpatullimet janë në mure të trasha e me korniza të dala nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

jashtë. Në po të njëjtën mënyre është bërë edhe zbritja e dyerve me 50 % nga brenda dhomës dhe 50 % nga korridori për të mbuluar shpatullimet që në rastin konkret shpatullat e dyerve janë me paturë e me mure të trasha dhe përsëri kjo zbritje nuk arrin ti mbulojë shpatullimet.

Sqarime nga grupi i auditimit:

1, 2 Pretendimet tuaja lidhur me mungesën e lejes së ndërtimit dhe ndryshimet në mënyrë të paargumentuar teknikisht të volumeve të punimeve nuk merren në konsideratë pasi nuk i përmbahen konstatimeve të aktkonstatimit si dhe nuk sjellin argumente dhe fakte shtesë.

3 Pretendimet tuaja lidhur me shtresat në tarracë nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi nga përlllogaritjet e sakta sipas anekseve rezultoi sa përshkruhet në aktin e konstatimit.

4 Pretendimet tuaja lidhur me punimet e suvatimit nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit pasi paturat e dyerve nuk rezultuan të suvatuara në 100% të zërit. Gjithashtu, në rastin kur patura e dyerve nga brenda dhomave zbritet në masën 50 %, gjatë përlllogaritjeve të volumeve të suvatimit për muret nga pjesa e korridorit, volumi i dyerve duhet të zbritet në masën 100 %. I njëjti argumentim shërben edhe për rastin e dritareve. Për sa më sipër pretendimet tuaja nuk qëndrojnë e si të tilla ato nuk merren në konsideratë nga grupi i auditimit.

Grupi i auditimit merr në konsideratë observacionin lidhur me certifikatat e cilësisë së fan coilave pas dorëzimit të tyre si dhe argumentet e dhëna mbi zërin ‘Transport mbeturinash auto’ pasi transporti i materialeve është bërë në një distancë më të largët se ajo që përfshin sasia e transportit në analizë. Gjithashtu merren në konsideratë edhe argumentet e dhëna lidhur me zërat ‘Suvatim i jashtëm’, ‘Lyrje me hidromat me dy duar në ambientet e brendshme’ dhe ‘Lyrje me bojë hidroplastike importi cilësi e I-rë në fasadë’ pas argumentimeve të dhen lidhur me diferencën e kuotave mes kateve dhe përfshirjen në këtë lartësi të thyerjeve të mureve.

Pas marrjes konsideratë të këtyre zërave është bërë edhe përlllogaritja e saktë e dëmit ekonomik.

6. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Kite&Reagente” - Korrik 2015.

Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese:

Të dhëna për tenderin	K.V.O.	Nj.P.P.
a	B	c
Urdhër Prok. Nr 211 Prot., datë 20.07.2015 -Fondi limit 1,715,715 lekë pa tvsh -Proc. e Prok. “Kërkesë për propozim” -Data e zhvillimit të prokurimit 30.07.2015, Ora 11:30 -Kanë marrë pjesë 5 (pesë) operator ekonomik -Fitues “G-A F” SHPK Tiranë -Vlera e kontratës 1,651,126 lekë pa tvsh -Titullar A.M	A.B F.D R.J	L.M K.M G.B

Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Me urdhrin e prokurimit nr. 188 prot., datë 16.06.2015 ishte urdhëruar prokurimi i fondit limit prej 1,715,715 lekë pa tvsh (1,981,351 lekë me tvsh) me procedurë prokurimi: “Kërkesë për propozim” për kontratën me objekt “Kite & Reagente” me fonde të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit. Hartimi i dokumentacionit të tenderit është bazuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike 2015, mbështetur në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, procedura e përzgjedhur është “Kërkesë për propozim pasi fondi limit është nën kufirin e ulet monetar. Kriteri i përzgjedhjes së fituesit do të jetë kriteri “cmimi më i ulët”. Pasi është zhvilluar procedura e tenderit në datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

26.06.2015 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave për 8 operatorë që morën pjesë. Nga ana e KVO në procedurë e datës 26.06.2015 për **“Blerje Kite&Reagent”** janë skualifikuar 7 (shtatë) operator ekonomikë (OE), nga të cilët edhe OE “G” sh.p.k me vlerë oferte 1,309,074.9 lekë. Skualifikimi është bërë me argumentimin se këtij OE i mungon Ekstrakti i regjistrimit tregtarë si dhe ekstraktim mbi historikun e subjekteve të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Në referencë të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 53 pika 4 KVO ka kryer një skualifikim të pa drejtë mbështetur në VKM nr.914 datë 29.12.2014 ,Neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 3 “Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal”. Përtej kësaj “ekstrakti historik dhe tregtarë” janë dokumenta lehtësisht të verifikueshme në sistemin elektronik të QKB, jo pa qëllim ligjvënisi këto dokumenta i ka vënë në dispozicion online për verifikimin e ndonjë të dhënë të pa qartë nga të interesuarit. Në këtë rast KVO nuk ka menduar për economicitetin e procedurës nisur nga oferta e marrë që është 23.8% më e ulët se fondi limit por ka preferuar të skualifikojë këtë operatorë dhe të rikryej procedurën e prokurimit.

Me urdhrin e prokurimit nr. 211 prot., datë 20.07.2015 ishte urdhëruar prokurimi i fondit limit prej 1,715,715 lekë pa tvsh (1,981,351 lekë me tvsh) me procedurë prokurimi: *“Kërkesë për propozim”* për kontratën me objekt *“Kite & Reagente”* me fonde të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit. Pasi është zhvilluar procedura e tenderit në datë 26.06.2015 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave për 8 operatorë që morën pjesë. Nga ana e KVO

Nga ana e KVO në procedurë e datës 30.07.2015 për **“Blerje Kite&Reagent”** kanë marrë pjesë 5 OE, nga të cilët janë kualifikuar 2 OE, “G-A F” me ofertë prej 1,651,126 dhe “G” sh.p.k me vlerë oferte 1,700,226 lekë. Operatori i renditur i dyti i cili në procedurën e anuluar kish ofruar 1,309,074.9 dhe skualifikuar padrejtësiht në këtë procedurë ofron 1,700,226 lekë ose 23% më tepër. OE fitues i kësaj procedure është “G-A F”.

Si pasojë e veprimeve të mësipërme, për arsye të skualifikimit të OE me ofertë më të vogël në procedurën e anuluar me pa të drejtë, për devijime të cilat nuk ndryshojnë në thelb ofertën, si dhe për shkak të kualifikimit dhe shpalljes fitues të një OE me ofertë më të lartë edhe pse në procedurë e përsërit, *është krijuar një efekt financiarë negativ me vlerë 342,051 lekë [1,651,126 lekë (oferta fituese) – 1,309,075 lekë (oferta fillestare e OE G)].*

Mbi zbatimin e kontratës

Në procedurën e prokurimit me objekt **“Blerje Kite&Reagent”** viti 2015 për periudhën e furnizimit nga 03.09.2015-31.12.2015 me vlerë kontrate 1,981,351 lekë me tvsh dhe OE “G-A F” SHPK. Nga zbatimit i kontratës nr. 274 datë 03.09.2015 për furnizim me Kite-Reagent lidhur ndërmjet OE “G-A F” SHPK dhe spitalit “Omer Nishani” Gjirokastër u konstatua një sasi Kite&Reagentësh jo në përputhje me cilësinë e kërkuar referuar neni 6 pika 2 e cila përcakton “Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit ...duhet të jetë jo më e vogël se 18 muaj”, ndërkohë që medikamentet e furnizuara dhe pranuar nga autoriteti kontraktorë e kanë më pak se 12 muaj afatin e skadencës. Më konkretisht rezultuan si më poshtë:

Kite&Reagente	Sasia	Cmimi	Vlera	Hyrja	Skadencia
Teste HBAIC Quo-Test	333	420	139,860	03.09.2015	16-mars
Minitrol Normal	1	600	600	03.09.2015	15-dhjetor
Minitrol High	3	600	1800	03.09.2015	15-dhjetor
Minitrol loë	3	600	1800	03.09.2015	15-dhjetor
Total			144,060		



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Furnizimi me Kite & Reagentet e më sipërme nuk duhet të ishte bërë nga operatori ekonomik dhe as të ishin pranuar nga komisioni i marrjes në dorëzim. **Vlera 144,060 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, referuar nenit 6 të kontratës pika 2 dhe duhet kthehet nga përfituesi “G-A F” SHPK që me dijëni ka furnizuar me Kite&Reagen jo në përputhje me kontratën.**

Lidhur me pagesat

- Me Urdhër shpenzimit nr.507 datë 23.12.2015 “Kite&Reagente” me vlerë 383,693 lekë për llogari të operatorit “G.A.F” disponohet fletë hyrje nr.134 datë 29.10.2015, fatura me nr.182 datë 29.10.2015, aktkolaudimi i datës 29.10.2015.

-Me Urdhër shpenzimit nr.508 datë 23.12.2015 “Kite&Reagente” me vlerë 1,554,860 lekë për llogari të operatorit “G.A.F” disponohet fletë hyrje nr.126, nr.126/1 datë 03.09.2015, fatura me nr.57 datë 03.09.2015, aktkolaudimi i datës 03.09.2015.

7. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Kite&Reagent” -maj 2016.

Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

Të dhëna për tenderin	K.V.O.	Nj.P.P.
A	b	c
-Urdhër Prok. Nr 236 Prot., datë 16.05.2016 -Fondi limit 3,684,600 lekë pa tvsh -Proc. e Prok. “Kërkesë për propozim” -Data e zhvillimit të prokurimit 26.05.2016, Ora 10:00 -Kanë marrë pjesë 3 (tre) operator ekonomik -Fitues “G-A F” SHPK -Vlera e kontratës 3,679,350 lekë pa t.v.sh -Titullar K.K	A.B F.D R.J	A.LI E.P G.B

Me urdhrin e prokurimit nr. 236 prot., datë 16.05.2016 ishte urdhëruar prokurimi i fondit limit prej 3,684,600 lekë pa tvsh me procedurë prokurimi: “Kërkesë për propozim” për kontratën me objekt “Kite & Reagente” me fonde të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit. Hartimi i dokumentacionit të tenderit është bazuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike 2016, mbështetur në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, procedura e përzgjedhur është “Kërkesë për propozim pasi fondi limit është nën kufirin e ulet monetar. Kriteri i përzgjedhjes së fituesit do të jetë kriteri “cmimi më i ulët”. Pasi është zhvilluar procedura e tenderit në datë 26.05.2016 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave për 3 operatorë që morën pjesë. Nga ana e KVO në procedurë e datës 26.05.2016 për “Blerje Kite&Reagent” janë skualifikuar 2 operator ekonomikë (OE) konkretisht “G” sh.p.k dhe “K” të cilët nuk kanë paraqitur ofertë dhe është shpallur fitues operatori “G-A F” SHPK me vlerë të ofertës 3,679,350 lekë.

Mbi zbatimin e kontratës

Në procedure e prokurimit me objekt “Blerje Kite&Reagent” viti 2016 për periudhën e furnizimit nga 07.07.2016-15.12.2016 me vlerë kontrate 4,415,220 lekë dhe operatorë fitues “G-A F” SHPK: Nga zbatimin i kontratës nr. 347 datë 07.07.2016 për furnizim me Kite-Reagent lidhur ndërmjet operatorit fitues “G-A F” SHPK dhe spitalit “Omer Nishani” Gjirokastër u konstatua një sasi Kite&Reagentësh jo në përputhje me cilësinë e kërkuar referuar nenit 6 pika 2 e cila përcakton “Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit ...duhet të jetë jo më e vogël se 18 muaj”, ndërkohë që medikamentet e furnizuara dhe pranuar nga autoriteti kontraktorë e kanë deri në 1 vit afatin e skadencës. Më konkretisht rezultuan si më poshtë:

Kite & Reagente	Sasia	Cmimi	Vlera	Hyrja	Skadencia
----------------------------	--------------	--------------	--------------	--------------	------------------



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Crp	300	696	208,800	15.07.2016	16-Nentor
Fr	300	696	208,800	15.07.2016	16-Tetor
Aslo	300	696	208,800	15.07.2016	16-Nentor
Feritin	90	720	64,800	15.07.2016	16-Shtator
IGE totale	90	696	62,640	15.07.2016	16-Shtator
Mikroalbumin urine	90	696	62,640	15.07.2016	16-Nentor
D-dimer	90	696	62,640	15.07.2016	16-Gusht
Cistatin	45	720	32,400	15.07.2016	16-Shtator
Total			911,520		

Gjithashtu dhe në pikën 10 të nenit 3 Afati I lëvrimit shprehet se : Kjo kontratë do të mbulojë furnizimet të nevojshme vetëm deri më datë 15/12/2016 ndërkohë që 8 nga këto artikuj kite/reagentë që nga grupi I auditimit janë cilësuar si të pa përshtatshme kanë afate skadence nga muaji Gusht deri në Nëntor të vitit 2016 pra as periudhën e mbulimit me furnizime nuk e arrijnë.

Furnizimi me Kite & Reagentet e më sipërme nuk duhet të ishte bërë nga operatori ekonomik dhe as të ishin pranuar nga komisioni i marrjes në dorëzim. **Përsa më sipër vlera 911,520 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, referuar nenit 6 të kontratës pika 2 dhe duhet kthehet nga përfituesi “G-A F” SHPK, që me dijëni ka furnizuar me Kite&Reagent jo në përputhje me kontratën.**

U konstatua një sasi Kite&Reagentësh të pa furnizuara në vlerën prej **144,000 lekë** të totalit të kontratës, problematikë e konstatuara edhe në kontrata të tjera në këtë institucion. Edhe pse nga operatori ekonomik nuk është realizuar kontrata me sukses nga ana e autoritetit kontraktorë **nuk është mbajtur sigurimi i kontratës në vlerën 10% të saj 441,522 lekë** referuar nenit 9 të kontratës mes palëve i cili përcakton “Kjo shumë do të çbllokohet prej blerësit Brenda 30 ditëve nga përfundimi I kontratës”. në mbështetje të nenit 8 të kontratës nëse shitësi vonon lëvrimin e mallit në depon e spitalit përtej afateve kohore të përcaktuara në kontratë do ti paguajë blerësit penalitet 4/1000 të vlerës së mallit të palëvruar për cdo ditë vonese kështu mosfurnizimi deri tani me Kite&Reagente ka një penalitet në vlerën **320,256 lekë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit i pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “G-A F” SHPK.**

Lidhur me pagesat

-Me urdhër shpenzimin nr.263 datë 26.07.2016 “Kite&Reagente” me vlerë 3,517,284 lekë për llogari të operatorit “G.A.F” disponohet fletë hyrje nr.78 datë 15.07.2016, fatura me nr.755 datë 15.07.2016, aktkolaudimi i datës 15.07.2015.

8. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Kite&Reagent” -Mars 2017.

Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

Të dhëna për tenderin	K.V.O.	Nj.P.P.
a	b	c
-Urdhër Prok. Nr 102 Prot., datë 08.03.2017 -Fondi limit 3,290,500 lekë pa tvsh -Proc. e Prok. “Kërkesë për propozim” -Data e zhvillimit të prokurimit 20.03.2017, Ora 10:00 -Kanë marrë pjesë 3 (tre) operator ekonomik -Fitues “G-A F” SHPK -Vlera e kontratës 3,288,700 lekë pa t.v.sh -Titullar K.K	M.G F.D R.J	D.L E.P G.B



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Me urdhrin e prokurimit nr. 102 prot., datë 08.03.2017 ishte urdhëruar prokurimi i fondit limit prej 3,290,500 lekë pa tvsh me procedurë prokurimi: “Kërkesë për propozim” për kontratën me objekt “Kite & Reagente” me fonde të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit. Hartimi i dokumentacionit të tenderit është bazuar në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike 2017, mbështetur në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, procedura e përzgjedhur është “Kërkesë për propozim pasi fondi limit është nën kufirin e ulet monetar. Kriteri i përzgjedhjes së fituesit do të jetë kriteri “cmimi më i ulët”. Pasi është zhvilluar procedura e tenderit në datë 20.03.2017 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave për 3 operatorë që morën pjesë. Nga ana e KVO në procedurë e datës 20.03.2017 për “Blerje Kite&Reagent” janë skualifikuar 2 operator ekonomikë (OE), “G” sh.p.k dhe “K” të cilët nuk kanë paraqitur ofertë. Operator fitues është shpallur “G-A F” SHPK.

Zbatimi i kontratës

Është lidhur kontrata nr.137 datë 10.04.2017 me vlerë 3,946,440 lekë me tvsh për periudhën e furnizimit 10.04.2017-15.12.2017. Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës u konstatua se një pjesë e ilaceve të lëvruara nga kjo kontratë kishin datë skadimi në më pak se një vit nga dita e lëvrimin të mallit në farmaci në kundërshtim me Nenin 6 pika 1 e kontratës: “Data e skadencës në ditën e lëvrimin të mallit të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhit dhe asaj të skadencës”. Nga krahasimi i datës së lëvrimin të mallit në farmaci dhe datës së skadencës së evidentuar në aktkolaudim u konstatua se kite reagentët e më poshtëm kishin një afat skadence më pak se një vit:

Kite & Reagente	Sasia	Cmimi	Vlera	Hyrja	Skadencia
ABX Minidil	4	5400	21600	17-Korrik	17-Tetor
ck-nac	1500	30	45000	17-Maj	17-Shtator
ABX minidil	4	4500	18000	17-Maj	17- Tetor
ABX miniclean	2	3500	7000	17-Maj	17-Nëntor
CRP	360	580	208800	17-Maj	17- Nëntor
RF	360	580	208800	17-Maj	17- Nëntor
Ferititin	270	600	162000	17-Maj	17- Nëntor
IGE	210	580	121800	17-Maj	17- Nëntor
D-Dimer	330	580	191400	17-Maj	17- Nëntor
CKMB	600	90	54000	17-Maj	17- Nëntor
TOTALI			1,016,800		

Furnizimi me Kite & Reagentet e më sipërme nuk duhet të ishte bërë nga operatori ekonomik dhe as të ishin pranuar nga komisioni i marrjes në dorëzim kjo pasi jo vetëm është në kundërshtim me kushtet e kontratës por është dhe e dëmshme për shëndetin e pacientëve të këtij spitali. **Si pasojë vlera 1,016,800 lekë përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit i pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “G-A F” SHPK.** Për më tepër që në pikën 10 të nenit 3 Afati I lëvrimin shprehet se : Kjo kontratë do të mbulojë furnizimet të nevojshme vetëm deri më datë 15/12/2017 ndërkohë që këto kite/reagentë që nga grupi I auditimit janë cilësuar si të pa përshtatshme kanë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

afate skadence nga muaji Shtator deri në Nëntor të vitit 2017 pra as periudhën e mbulimit me furnizime nuk e arrijnë.

Lidhur me pagesat:

-Me urdhër shpenzim nr.305 datë 01.08.2017 “Kite & Reagente” me vlerë 124,320 lekë për llogari të operatorit “G.A.F” disponohet fletë hyrje nr.98 datë 11.07.2017, fatura me nr.412 datë 11.07.2017 , aktkolaudimi i datës 11.07.2017.

- Me urdhër shpenzim nr.169 datë 29.05.2017 “Kite & Reagente” me vlerë 1,079,760 lekë për llogari të operatorit “G.A.F” disponohet fletë hyrje nr.47 datë 28.04.2017, fatura me nr.250 datë 28.04.2017 , aktkolaudimi i datës 28.04.2017.

-Me urdhër shpenzim nr.203 datë 29.06.2017 “Kite & Reagente” me vlerë 2,705,640 lekë për llogari të operatorit “G.A.F” disponohet fletë hyrje nr.64 datë 29.05.2017, fatura me nr.314 datë 29.05.2017 , aktkolaudimi i datës 29.05.2017.

- Me urdhër shpenzim nr.560 datë 28.12.2017 “Kite & Reagente” me vlerë 124,320 lekë për llogari të operatorit “G.A.F” disponohet fletë hyrje nr.154 dt.7.12.2017, fatura me nr. 789 dt.07.12.2017 , aktkolaudimi i datës 07.12.2017.

9. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: **“Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”-Gusht 2014.**

2. Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi nr. 251 prot.datë 01.08.2014 z.A.M	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 251, datë 01.08.2014 Znj. A.LI	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 251,datë 01.08.2014 Z. A.B Kryetar Znj. F.D Znj. R.J
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Znj. K.M Znj. V.D	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,208,330lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “N.M” person fizik 2,186,650lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 21,680 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 13.08.2014 Ora 11:00	9.Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 O.E. b)S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b.Zbatimi i Kontratës me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”		
14.Lidhja e kontratës Nr.366 prot., datë 05.11.2014	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 2,623,980lekë	16.Likuiduar 2,623,980

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar rishtaz në këte institucion pasi ngarhaj është realizuar me kaldajë me solar, por për shkak të amortizimit dhe rrjedhjeve në boljer dhe shpezimit vjetorë që kishitë është menduar ngrohja me pellet.

Në iniciimin e kësaj procedurë autoriteti kontraktorë ka nxjerr fondin limit për këtë procedurë vetëm për një zë “lëndë djegëse pellet” ndërkohë që për kaldajën dhe brucatorin e kërkuar bashkë me lëndën djegëse autoriteti kontraktorë nuk është shprehur por i ka ngarkuar në cmimin për kg të pelletit edhe pse janë dy procese krejt të kundërta, njëra është pajisje furnizim vendosje me huapërdorimi dhe tjetra është mall konsumi.

Në asnjë moment në procedurën e prokurimit nuk shpreht mënyra e llogaritjes së fondit limit e llogaritur nga kryetri i degës së planit K.M dhe miratuar nga drejtori A.M në kundërshtim me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Ligjin 9643 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 01 datë 10.01.2007 “Rregullat e prokurimit publik” ku shpreht se: autoriteti kontraktorë në cdo rast duhet të dokumentojë llogaritje e fondit limit.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi K.Mn në cilësinë e kryetares së degës së planit dhe drejtorit të spitalit A.M.

Hartimi i specifikimeve teknike për kaldajën dhe brucatorin janë hartuar nga N.Z. Janë hartuar specifikimet teknike për lëndën djegëse “Pellet” si dhe specifikimet teknike për kaldajën e cila do të ofrohet nga operatori fitues i kësaj procedure. Nga verifikimi i këtyre specifikimeve u konstatua se:

Specifikimet teknike të hartuara nga z. N.Z për kaldajën Tipi KN-AT janë hartuar jo në përputhje me nenin 23 “specifikimet teknike” të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj.

Hartimi i këtyre specifikimeve ka bërë që të ngushtohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomik në këtë procedurë nga të dhënat e shënuara nga N.Z në specifikimet teknike për kaldajën që do ofrohet, disa nga elementet e specifikuar kufizojnë konkurrencën në pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë dhe orientojnë tregun dhe autoritetin kontraktorë tek operatori fitues “N.M” person fizik janë: dimensione në një ekzaktësi fikse në mm, L= 2750 mm, Gjatësi= 2180 mm, Gjërësi= 1720 mm si dhe peshën ekzakte në kg= 1855 kg.

Për hartimin e specifikimeve teknike jo në përputhje me nenin 23 të ligjit 9643 datë datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj, me pasojë kufizimin e konkurrencës ngarkohet me përgjegjësi N.Z ish-kaldaist si dhe njësia e prokurimit e përbërë nga A.Ll, K.M dhe V.D për hartimin dhe miratimin e këtyre specifikimeve në DST e procedurës.

-Drejtori i Spitalit A.M ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 251 datë 01.08.2014 për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: S.P kryetarë, F.D dhe M.B anëtare.

-Drejtori i Spitalit A.M ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 251 datë 01.08.2014 për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,208,330 lekë pa TVSH si dhe ka krijuar Njësinë e prokurimit të përbërë nga: A.Ll, K.M dhe V.D.

-Drejtori i Spitalit A.M ka nxjerrë Formualrin e Njoftimit të Kontratës nr. 251/1 datë 01.08.2014 për procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,208,330 lekë pa TVSH datë zhvillimi tenderi 13.08.2014 ora 10:30.

-Sipas procesverbalit datë 15/04/2014 për hapjen e ofertave vlerësimin e procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,208,330 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 2 operatorë ekonomik:

- 1-Operatori ekonomik “N.M” me nipt L23028201S dhe ofertë ekonomike 2,208,330 lekë.
- 2-Operatori ekonomik “P” pa ofertë.

-Sipas procesverbalit datë 15/08/2014 për vlerësimin e ofertave procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,208,330 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 2 operatorë dhe u kualifikua 1 operatorë ekonomik me ofertë 2,186,650 lekë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Me shkresën datë 20.08.2014 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është hartuar raporti përmbledhës si dhe është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor.

Me vendimin nr. 251/2 datë 26.08.2014 titullari i autoritetit kontraktorë A.M ka shpalluar fitues operatorin ekonomik “N.M” me vlerë 2,186,650 lekë.

Me shkresën datë 26.08.2014 nga drejtori i institucionit është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

a.Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 286 prot., datë 29.08.2014, me vlerë 2,186,650lekë pa tvsh (2,623,980 lekë me tvsh), me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2014. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit GjirokastërA.M dhe nga personi fizik “N.M”.

Nga ana e drejtorit të institucionit nuk është ngritur grup për mbikqyrjen e kontratës së lidhur dhe marrjen në dorzim të kaldajës dhe pelletit të furnizuar dukë vënë në rrezik realizimin e saj me sukses në kohë e cilësinë kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 1, 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu VIII, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës” pika 2, gjithashtu në përfundim të kontratës autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu VIII, pika 2. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish drejtorin A.M.

-Nga verifikimi fizik i kaldajës u konsatua se: kaldajës i mungon targeti i të dhënave i cili duhet të ishte i stampuar në trupit e kaldajës në pllaket metalike element që e bën të pamundur identifikimin tipit dhe të dhënave të kaldajës, për të dëshmuar përmbajtjen e specifikimeve sipas kësaj procedure si dhe kjo kaldajë e instaluar dhe e marrë në dorzim nga drejtori i spitalit pasi nuk ka ngritur grup marrje në dorzim pa plotësuar asnjë nga dimensionet sipas specifikimeve teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktorë dhe të kualifikuar nga ky i fundit ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin A.M.

10. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”-Tetor 2015.

2. Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi nr. 326/1 prot.datë 08.10.2015 z.A.M	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 326/1, datë 08.10.2015 Znj. L.M	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 326,datë 08.10.2015 Z. A.B Kryetar Znj. F.D Znj. R.J
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Znj. K.M Znj. G.B	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,479,297lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “N.M” person fizik 2,454,750 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 24,547 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 19.10.2015 Ora 10:00	9.Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 O.E. b)S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b.Zbatimi i Kontratës me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”		
14.Lidhja e kontratës Nr.366 prot., datë 05.11.2015	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 2,945,700lekë	16.Likuiduar 2,945,700



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

b. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar nga nevojat e përvitshme për lëndë djegëse për ngrohje (pellet) hartuar kërkesë nga përgjegjësi i zyrës teknike F.D datë 01.10.2015. Përgjegjësi i zyrës teknike F.D sëbashku me kërkesën për lëndë djegëse ka hartuar dhe specifikimet e tyre në referencë të detyrës që mban. Janë hartuar specifikimet teknike për lëndën djegëse “Pellet” **si dhe specifikimet teknike për kaldajën e cila do të ofrohet nga operatori fitues i kësaj procedure.**Nga verifikimi i këtyre specifikimeve u konstatua se:

Specifikimet teknike të hartuara nga z. F.D për kaldajën Tipi KN-AT janë hartuar jo në përputhje me nenin 23 “specifikimet teknike” të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj.

Hartimi i këtyre specifikimeve ka bërë që të ngushtohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomik në këtë procedurë nga të dhënat e shënuara nga N.Z në specifikimet teknike për kaldajën që do ofrohet, disa nga elementet e specifikuar kufizojnë konkurrencën në pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë dhe orientojnë tregun dhe autoritetin kontraktorë tek operatori fitues “N.M” person fizik janë: dimensione në një ekzaktësi fikse në mm, L= 2750 mm, Gjatësi= 2180 mm, Gjërësi= 1720 mm si dhe peshën ekzakte në kg= 1855 kg.

Për hartimin e specifikimeve teknike jo në përputhje me nenin 23 të ligjit 9643 datë datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj, me pasojë kufizimin e konkurrencës ngarkohet me përgjegjësi F.D ish-përgjegjës i degës teknike si dhe njësia e prokurimit e përbërë nga L.M, K.M dhe G.B për hartimin dhe miratimin e këtyre specifikimeve në DST e procedurës.

-Drejtori i Spitalit A.M ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 326 datë 08.10.2015 për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: A.B kryetarë, F.D dhe R.J anëtare.

Komisioni i vlerësimit të ofertave i ngritur me urdhër të titullarit nuk është në përputhje me nenin 64 “hapja e ofertave” VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, pasi zyrtari F.D është dhe personi i cili ka hartuar specifikimet teknike për këtë procedurë.

-Drejtori i Spitalit A.M ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 326/1 datë 08.10.2015 për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,479,297 lekë pa TVSH si dhe ka krijuar Njësinë e prokurimit të përbërë nga: L.M, K.M dhe G.B.

Fondi limit i kësaj kontrate është nxjerrë komisioni i studimit të tregut i përbërë nga V.S, E.P dhe D.Q datë 05.10.2015 ku kanë nxjerrë një çmim mesatarë prej 50.5 lek/kg.

Nisur nga kronologjia e shkresave referuar numrit të protokollit që mbajnë ish-drejtori A.M më parë K komisionin e vlerësimit të ofertave pa nxjerrë akoma urdhër prokurimit për procedurën.

-Drejtori i Spitalit A.M ka nxjerrë Formualrin e Njoftimit të Kontratës nr. 326/2 datë 08.10.2015 për procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,479,297 lekë pa TVSH datë zhvillimi tenderi 19.10.2015 ora 10:00.

-Sipas procesverbalit datë 19/10/2015 për hapjen e ofertave vlerësimin e procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,479,297 lekë pa TVSH, hartuar nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 1 operatorë ekonomik:

1-Operatori ekonomik “N.M” me nipt L23028201S dhe ofertë ekonomike 2,454,750 lekë.

-Sipas procesverbalit datë 22/10/2015 për vlerësimin e ofertave procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,479,297 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë dhe u kualifikua 1 operatorë ekonomik me ofertë 2,454,750 lekë.

Me shkresën datë 30.10.2015 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është hartuar raporti përmbledhës si dhe është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor.

Me vendimin nr. 345 datë 30.10.2015 titullari i autoritetit kontraktorë A.M ka shpalluar fitues operatorin ekonomik “N.M” me vlerë 2,457,750 lekë.

Me shkresën datë 30.10.2017 nga drejtori i institucionit është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

a.Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 366 prot., datë 05.11.2015, me vlerë 2,454,750lekë pa tvsh (2,945,700 lekë me tvsh), me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2015. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit GjirokastërA.M dhe nga personi fizik “N.M”.

Nga ana e drejtorit të institucionit nuk është ngritur grup për mbikqyrjen e kontratës së lidhur dhe marrjen në dorzim të kaldajës dhe pelletit të furnizuar dukë vënë në rrezik realizimin e saj me sukses në kohë e cilësinë kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës” neni 77, gjithashtu në përfundim të kontratës autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX neni 77, pika 1. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish drejtorin A.M.

Kjo për vetë faktin e sipërcituar në hartimin e dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike, u konstatua një zvogëlim i konkurrencës në hartimin e specifikimeve teknike, si dhe nga mos lëvizja e kësaj kaldaja nga momenti i instalimit në vitin e parë 2014 e deri më sot. Fakt ky që tregon për një procedurë të iniciuar dhe realizuar në një ambient të pafavorshëm për operatorët ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin A.M.

-Nga verifikimi fizik i kaldajës u konsatua se: kaldajës i mungon targeti i të dhënave i cili duhet të ishte i stampuar në trupit e kaldajës në pllaket metalike elemet që e bën të pamundur identifikimin tipit dhe të dhënave të kaldajës, për të dëshmuar përmbajtjen e specifikimeve sipas kësaj procedure si dhe kjo kaldajë e instaluar dhe e marrë në dorzim nga drejtori i spitalit pasi nuk ka ngritur grup marrje në dorzim pa plotësuar asnjë nga dimensionet sipas specifikimeve teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktorë dhe të kualifikuar nga ky i fundit ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin A.M.

-Në përgjigje të observacionit nr. 442/5 datë 11.07.2018 dërguar nga A.M në lidhje me aktkostatimin nr. 7/2 bëjmë me dije se merret pjesërisht në konsideratë. Është e vërtet që vendi i instalimit të kaldajës është në një sipërfaqe shumë të kufizuar dhe me dimensione të caktuara dhe pa mundësi zgjerimi por gjatë hartimit të specifikimeve teknike Njësia e prokurimit apo grupi i ngritur për këtë detyrë duhet të marrë në konsideratë dhe kufizimet ligjore.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

11. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: **“Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”-Tetor 2016.**

2. Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi nr. 455 prot.datë 20.10.2016 z.K.K	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 455, datë 20.10.2016 Znj. A.Ll	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 456, datë 20.10.2016 Z. A.B Kryetar Znj. F.D Znj. R.J
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Znj. E.P Znj. G.B	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,425,000lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “N.M” person fizik 2,425,000lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) – lekë
8. Data e hapjes së tenderit 31.10.2016 Ora 12:00	9.Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 O.E. b)S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b.Zbatimi i Kontratës me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”		
14.Lidhja e kontratës Nr.627 prot., datë 18.11.2016	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 2,910,000lekë	16.Likuiduar 2,910,000

Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar nga nevojat e përvitshme për lëndë djegëse për ngrohje (pellet) hartuar kërkesë nga përgjegjësi i zyrës teknike F.D datë 18.10.2016. Përgjegjësi i zyrës teknike F.D sëbashku me kërkesën për lëndë djegëse ka hartuar dhe specifikimet e tyre në referencë të detyrës që mban. Janë hartuar specifikimet teknike për lëndën djegëse “Pellet” **si dhe specifikimet teknike për kaldajën** e cila do të ofrohet nga operatori fitues i kësaj procedure.Nga verifikimi i këtyre specifikimeve u konstatua se:

Specifikimet teknike të hartuara nga z. S.P për kaldajën Tipi KN-AT janë hartuar jo në përputhje me nenin 23 “specifikimet teknike” të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj.

Hartimi i këtyre specifikimeve ka bërë që të ngushtohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomik në këtë procedurë nga të dhënat e shënuara nga N.Z në specifikimet teknike për kaldajën që do ofrohet, disa nga elementet e specifikuar kufizojnë konkurrencën në pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë dhe orientojnë tregun dhe autoritetin kontraktorë tek operatori fitues “N.M” person fizik janë: dimensione në një ekzaktësi fikse në mm, L= 2750 mm, Gjatësi= 2180 mm, Gjërësi= 1720 mm si dhe peshën ekzakte në kg= 1855 kg.

Për hartimin e specifikimeve teknike jo në përputhje me nenin 23 të ligjit 9643 datë datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj, me pasojë kufizimin e konkurrencës dhe orientimin apo paracaktimin e operatorit fitues ngarkohet me përgjegjësi S.P inxhinier i degës teknike si dhe njësia e prokurimit e përbërë nga A.Ll, E.Pi dhe G.B për hartimin dhe miratimin e këtyre specifikimeve në DST e procedurës.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 455 datë 20.10.2016 për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,425,000 lekë pa TVSH si dhe ka krijuar Njësinë e prokurimit të përbërë nga: A.LI, E.P dhe G.B.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 456 datë 20.10.2015 për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: A.B kryetarë, F.D dhe R.J anëtare.

-Fondi limit i kësaj kontrate është nxjerrë nga përgjegjësi i planit F.F referuar kontratës së mëparshme nr. 366 datë 05.11.2015 dhe referuar kërkesës për sasi nga dega teknike datë 18.10.2016 ku kanë nxjerrë një çmim mesatarë prej 50 lek/kg.

-Drejtori i Spitalit A.M ka publikuar nxjerrë Formularin e Njoftimit të Kontratës në buletin e APP nr. 42 datë 24.10.2016 faqe 64 për procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,425,000 lekë pa TVSH datë zhvillimi tenderi 31.10.2016 ora 12:00.

-Sipas procesverbalit datë 01/11/2016 për hapjen e ofertave vlerësimin e procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,425,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 2 operatorë ekonomik:

1-Operatori ekonomik “A-A” SHPK me ofertë ekonomike 2,182,500 lekë.

2-Operatori ekonomik “N.M” me nipt L23028201S dhe ofertë ekonomike 2,425,000 lekë.

-Sipas procesverbalit datë 03/11/2016 për vlerësimin e ofertave procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,425,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë dhe u kualifikua 1 operatorë ekonomik me ofertë 2,425,000 lekë.

Me shkresën datë 11.11.2016 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është hartuar raporti përmbledhës si dhe është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor.

Me vendimin nr. 455/3 datë 11.11.2015 titullari i autoritetit kontraktorë K.K ka shpalluar fitues operatorin ekonomik “N.M” me vlerë 2,425,000 lekë.

Me shkresën datë 11.11.2017 nga drejtori i institucionit është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

a. Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 627 prot., datë 18.11.2016, me vlerë 2,425,000 lekë pa tvsh (2,910,000 lekë me tvsh), me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2016. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër K.K dhe nga personi fizik “N.M”.

-Nga verifikimi i dokumentacionit në sistem si dhe dosjes fizike u konstatua se pajisja kaldajë e ofruar nga operatori ekonomik nuk përbush specifikimet teknike referuar dokumentacionit që ndodhet në sistem dhe në dosje “kaldaja me pellet **490KW** në pronësi” ajo nuk përbush kushtin kryesorë fuqin termike. Nga ana e autoritetit kontraktorë është kërkuar kaldajë 500KW me fuqi termike nominale 500kw dhe fuqi termike e kthyer 459kw, kaldaja e ofruar nga operatori ekonomik është me fuqi 490KW me fuqi termike nominale 490KW dhe fuqi termike e kthyer 400KW.

Edhe pse nuk përbush kushtin kryesorë atë të fuqisë që ndikon drejtpërdrejtë në eficientë në ngrohje komisioni i vlerësimit të ofertave e ka kualifikuar këtë operator duke i hartuar një raport



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

përmbledhës me të dhëna të rreme dhe disinformuese për titullarit të autoritetit kontraktor për shpalljen fitues të këtij operatori ekonomik.

Veprime që ngarkojnë përgjegjësi komisjonin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga A.B kryetarë, R.J dhe F.D anëtarë.

Nga ana e drejtorit të institucionit nuk është ngritur grup për mbikqyrjen e kontratës së lidhur dhe marrjen në dorzim të kaldajës dhe pelletit të furnizuar dukë vënë në rrezik realizimin e saj me sukses në kohë e cilësinë kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX, “Ekzekutimi dhe mbikqyrja e kontratës” neni 77, gjithashtu në përfundim të kontratës autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX neni 77, pika 1. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish drejtorin K.K.

Kjo për vetë faktin e sipërcitur në hartimin e dokumentave të tenderit dhe specifikimeve teknike, u konstata një zvogëlim i konkurrencës në hartimin e specifikimeve teknike, si dhe nga mos lëvizja e kësaj kaldaja nga momenti i instalimit në vitin e parë 2014 e deri më sot. Fakt ky që tregon për një procedurë të iniciuar dhe realizuar në një ambient të pafavorshëm për operatorët ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin K.K.

Në kontratën e nëshkruar mes palëve në nenin 4 “Kushtet e dorzimit” citohet

4.1 Kontraktuesi duhet të instaloj menjëherë mbas nënshkrimit të kontratës kaldajë me pellet tipi KN-AT si dhe djegësin (brucatorë) me pellet sipas të dhënave teknike të përcaktuara në DST.

4.3 Mbas përfundimit të kësaj kontrate kontraktori duhet të kthejë në gjëndjen e mëparshme sistemin eksiztues.

Nga verifikimi dhe deklaramet kaldaja nuk ka lëvizur edhe pse është e parashkruar në kontratë për kthimin e sistemit në gjëndjen e mëparshme njëkohësisht duhet dhe të lirojë hapsirën e zënë të Spitalit “Omer Nishani”.

-Nga verifikimi fizik i kaldajës u konsatua se: kaldajës i mungon targeti i të dhënave i cili duhet të ishte i stampuar në trupit e kaldajës në pllaket metalike elemet që e bën të pamundur identifikimin tipit dhe të dhënave të kaldajës, për të dëshmuar përmbajtjen e specifikimeve sipas kësaj procedure si dhe kjo kaldajë e instaluar dhe e marrë në dorzim nga drejtori i spitalit pasi nuk ka ngritur grup marrje në dorzim pa plotësuar asnjë nga dimensionet sipas specifikimeve teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktorë dhe të kualifikuar nga ky i fundit ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin K.K.

12. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”-Shkurt 2017.

2. Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :			
1.Urdhër Prokurimi nr.76prot.datë 10.02.2017 z.K.K	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 76, datë 10.02.2017 Znj. A.Ll	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 76/1,datë 10.02.2017 Z. M.G Kryetar Znj. F.D Znj. R.J	
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Znj. E.P Znj. G.B		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,015,000lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “N.M” person fizik 2,015,000 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) - lekë	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

8. Data e hapjes së tenderit 22.02.2017 Ora 12:00	9. Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 O.E. b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b. Zbatimi i Kontratës me objekt: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit”		
14. Lidhja e kontratës Nr.627 prot., datë 18.11.2017	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 2,910,000 lekë	16. Likuiduar 2,910,000

Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar nga nevojat e përvitshme për lëndë djegëse për ngrohje (pellet) hartuar kërkesë nga përgjegjësi i zyrës teknike F.D datë 09.02.2017. Përgjegjësi i zyrës teknike F.D sëbashku me kërkesën për lëndë djegëse është shprehur se: *Kontraktuesi duhet të instalojë menjëherë mbas nënshkrimit të kontratës kaldajë me pellet tipi KN-AT si dhe djegësin (brucatorë) me pellet pasi kaldaja ekzistuese e spitalit është jashtë funksioni prej shumë kohësh.*
-Mbas përfundimit të kësaj kontrate kontraktori duhet të kthejë në gjëndjen e mëparshme sistemin eksistues.

Në kërkesën që bën kryetari i degës teknike është i saktë por zbatimi nuk është në të njëjtën linjë me të edhe pse mban pozicionin e kryetarit të degës teknike, kjo kaldajë nuk është lëvizur për asnjë moment nga vendi dhe për më tepër nuk është llogaritur qiraja për zënie hapsiere private sipas VKM 54 datë datë 5.02.2014 “Për dhënie me qira apo enfiteozë të pasurive shtetërore.

Janë hartuar specifikimet teknike për lëndën djegëse “Pellet” **si dhe specifikimet teknike për kaldajën** e cila do të ofrohet nga operatori fitues i kësaj procedure. Nga verifikimi i këtyre specifikimeve u konstatua se:

Specifikimet teknike të hartuara nga z. S.P për kaldajën Tipi KN-AT janë hartuar jo në përputhje me nenin 23 “specifikimet teknike” të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj.

Hartimi i këtyre specifikimeve ka bërë që të ngushtohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomik në këtë procedurë nga të dhënat e shënuara nga N.Z në specifikimet teknike për kaldajën që do ofrohet, disa nga elementet e specifikuar kufizojnë konkurrencën në pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë dhe orientojnë tregun dhe autoritetin kontraktorë tek operatori fitues “N.M” person fizik janë: dimensione në një ekzaktësi fikse në mm, L= 2750 mm, Gjatësi= 2180 mm, Gjërësi= 1720 mm si dhe peshën ekzakte në kg= 1855 kg.

Për hartimin e specifikimeve teknike jo në përputhje me nenin 23 të ligjit 9643 datë datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar nent 27 dhe 61 të saj, me pasojë kufizimin e konkurrencës dhe orientimin apo paracaktimin e operatorit fitues ngarkohet me përgjegjësi S.Pinxhinier i degës teknike si dhe njësia e prokurimit e përbërë nga A.LI, E.P dhe G.B për hartimin dhe miratimin e këtyre specifikimeve në DST e procedurës.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 76 datë 10.02.2017 për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,015,000 lekë pa TVSH si dhe ka krijuar Njësinë e prokurimit të përbërë nga: A.LI, E.P dhe G.B.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 76/1 datë 10.02.2017 për procedurën e prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: M.G kryetarë, F.D dhe R.J anëtare.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Fondi limit i kësaj kontrate është nxjerrë nga përgjegjësi i planit F.F referuar kontratës së mëparshme nr. 627 datë 18.11.2016 dhe referuar kërkesës për sasi nga dega teknike datë 09.02.2016 ku kanë nxjerrë një çmim mesatarë prej 50 lek/kg.

-Drejtori i Spitalit A.M ka publikuar nxjerrë Formualrin e Njoftimit të Kontratës në buletin e APP nr. 7 datë 20.02.2017 faqe 54 për procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,015,000 lekë pa TVSH datë zhvillimi tenderi 22.02.2017 ora 12:00.

-Sipas procesverbalit datë 22/02/2017 për hapjen e ofertave vlerësimin e procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,015,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimin të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 3 operatorë ekonomik:

- 1-Operatori ekonomik “T-D” SHPK me ofertë ekonomike 1,914,250 lekë.
- 2-Operatori ekonomik “N.M” me ofertë ekonomike 2,015,000 lekë.
- 3-Operatori ekonomik “S” pa ofertë ekonomike.

-Sipas procesverbalit datë 24/02/2017 për vlerësimin e ofertave procedurës së prokurimit “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje” me fond limit 2,015,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimin të ofertave, në procedurën e prokurimit mori 3 operatorë pjesë dhe u kualifikua 1 operatorë ekonomik me ofertë 2,015,000 lekë.

Me shkresën datë 06.03.2017 nga komisioni i vlerësimin të ofertave është hartuar raporti përmbledhës si dhe është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor.

Me vendimin nr. 76/3 datë 06.03.2017 titullari i autoritetit kontraktorë K.K ka shpalluar fitues operatorin ekonomik “N.M” me vlerë 2,015,000 lekë.

Me shkresën datë 06.03.2017 nga drejtori i institucionit është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

a. Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 76/4 prot., datë 21.03.2017, me vlerë 2,015,000 lekë pa tvsh (2,418,000 lekë me tvsh), me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2017. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastrë K.K dhe nga personi fizik “N.M”.

-Nga verifikimi i dokumentacionit në sistem si dhe dosjes fizike u konstatua se pajisja kaldajë e ofruar nga operatori ekonomik nuk përmbush specifikimet teknike referuar dokumentacionit që ndodhet në sistem dhe në dosje “kaldaja me pellet **490KW** në pronësi” ajo nuk përmbush kushtin kryesorë fuqin termike. Nga ana e autoritetit kontraktorë është kërkuar kaldajë 500KW me fuqi termike nominale 500kw dhe fuqi termike e kthyer 459kw, kaldaja e ofruar nga operatori ekonomik është me fuqi 490KW me fuqi termike nominale 490KW dhe fuqi termike e kthyer 400KW.

Edhe pse nuk përmbush kushtin kryesorë të fuqisë që ndikon drejtpërdrejtë në eficientë në ngrohje komisioni i vlerësimin të ofertave e ka kualifikuar këtë operator duke i hartuar një raport përmbledhës me të dhëna të rreme dhe disinformuese për titullarit të autoritetit kontraktor për shpalljen fitues të këtij operatori ekonomik.

Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi **komisionin e vlerësimin të ofertave të përbërë nga M.G kryetar, R.J dhe F.F anëtarë.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Nga ana e drejtorit të institucionit nuk është ngritur grup për mbikqyrjen e kontratës së lidhur dhe marrjen në dorzim të kaldajës dhe pelletit të furnizuar dukë vënë në rrezik realizimin e saj me sukses në kohë e cilësinë kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX, “Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës” neni 77, gjithashtu në përfundim të kontratës autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX neni 77, pika 1. Veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish drejtorin K.K.

Kjo për vetë faktin e zvogëlimit të konkurrencës në hartimin e specifikimeve teknike, si dhe nga mos lëvizja e kësaj kaldaja nga momenti i instalimit në vitin e parë 2014 e deri më sot. Fakt ky që tregon për një procedurë të iniciuar dhe realizuar në një ambient të pafavorshëm për operatorët ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin K.K.

Në kontratën e nëshkruar mes palëve në nenin 4 “Kushtet e dorzimit” citohet

4.1 Kontraktuesi duhet të instaloj menjëherë mbas nënshkrimit të kontratës kaldajë me pellet tipi KN-AT si dhe djegësin (brucatorë) me pellet sipas të dhënave teknike të përcaktuara në DST.

4.3 Mbas përfundimit të kësaj kontrate kontraktori duhet të kthejë në gjëndjen e mëparshme sistemin eksistues.

Nga verifikimi dhe deklarimet kaldaja nuk ka lëvizur edhe pse është e parashkruar në kontratë për kthimin e sistemit në gjëndjen e mëparshme njëkohësisht duhet dhe të lirojë hapsirën e zënë të Spitalit “Omer Nishani”.

-Nga verifikimi fizik i kaldajës u konsatua se: kaldajës i mungon targeti i të dhënave i cili duhet të ishte i stampuar në trupit e kaldajës në pllaket metalike element që e bën të pamundur identifikimin tipit dhe të dhënave të kaldajës, për të dëshmuar përmbajtjen e specifikimeve sipas kësaj procedure si dhe kjo kaldajë e instaluar dhe e marrë në dorzim nga drejtori i spitalit pasi nuk ka ngritur grup marrje në dorzim pa plotësuar asnjë nga dimensionet sipas specifikimeve teknike të kërkuar nga autoriteti kontraktorë dhe të kualifikuar nga ky i fundit ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin K.K.

Si konkluzion

Për të gjitha procedurat e prokurimit në lidhje me blerjen e lëndës djegëse pellet dhe furnizimi me kaldaje e brucatorë duket qartë se, llogaritja e fondit limit për këtë procedurë është marrë i mirqenë nga procedura e vitit 2014 që nuk ka argumentimi ligjore si është nxjerrë ky çmim për kg pellet pavarësisht (mungojnë ofertat e tregut) se ne dy vitet e ardhshme është bërë me studim tregu ky çmim ka mbetur i pa ndryshuar.

Komisioni nuk ka bërë studim tregu në lidhje me:

-Vlerën e instalimit (FV-furnizimim vendosje të kaldajave në spital), nuk ka asnjë arsytim ekonomik, teknik a ligjor pse nuk janë prokuruar kaldajat por është kërkuar marrja me qira e tyre.

-Vlerat e qirasë e cila duhet të dalin sipas llojit, madhësinë e kaldajave, harxhimit të pelletit, konsumin energjinë elektrike etj. Por vlera e qirasë është e injektuar në çmimin për kg pellet të ofruar nga operatori ekonomik.

Nga vitit 2014 (kohë kur kanë dalë jashtë përdorimit kaldajat e spitalit) deri më sot në vlerën e blerjes së pelletit është futur pa u përmendur edhe vlera marrjes me qira e furnizim/vendosja, mirëmbajtja dhe punimet e prishje/ndërtimit për kaldajën. Këto zëra nuk janë llogaritur më vete por është rritur padrejtësisht mbi dyfish çmimi për njësi të pelletit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Si pasojë e llogaritjes më tepër të çmimit të blerjes së pelletit për mbulimin me ngrohje të SRGJ të periudhës 2014 – 2017 dhe të zhvillimit jo në përputhje me ligjin të procedurave të prokurimit me operatorin fitues “N.M” janë lidhur kontrata me objekt: “Blerje lënde djegëse pelleti” në vlerën monetare 9,081,400 lekë pa tvsh.

Kaldaja e ngrohjes është instaluar në ambjentin e kaldajave të vjetra që ky spital disponon, me një sipërfaqe aseti (dhomë kaldaje prej 30 m²). Kaldaja e ngrohjes instalohet në muajin nentorë dhe hiqet nga aty në muajin prill sipas kontratës.

Nga verifikimet në terren dhe deklaratimet të punonjësve të kaldajës dhe verifikimi fizik i kaldajës kaldaja e ngrohjes nuk është lëvizur nga vendi për periudhën mbas përfundimit të kontratës. Nga ana e titullarit të institucionit nuk është marrë asnjë masë për lirim të hapsirës prej 30m² aq më tepër nuk i është kërkuar operatorit fitues lirim të ambjenteve apo llogaritja e një qeraje mujore sipas përcaktimeve të VKM nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar.

Referuar paragrafit III të kësaj VKM ndryshuar me VKM nr. 992, datë 9.12.2015 Tarifat dysHEME të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve, në qytetin e Tiranës tarifa dysHEME është përcaktuar 75 lek/m², (30m² x 75 lek/m² = 2,250 lekë në muaj qira e po llogaritur ndaj operatorit ekonomik për zënie hapësire përtej afatit kontraktorë.

Për periudhën Prill-Tetor, kohë në të cilën kjo kaldajë nuk duhet të ishte në këto ambiente operatori **ekonomik i detyrohet Spitalit Rajonal “Omer Nishani” vlerën prej 2,250 lekë/muaj x 7 muaj x 4 vjet = 63,000 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për institucionin dhe ngarkon me përgjegjësi titullarët e tij A.Mn dhe K.K për dhënien e mundësisë të operatorit ekonomik të shfrytëzimit të aseteve të spitalit pa asnjë detyrim.**

13-Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e impiantistikës”- Korrik 2015.

Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese:

Të dhëna për tenderin	K.V.O.	Nj.P.P.
a	b	c
Urdhër Prok. Nr 198 Prot., datë 06.07.2015 -Fondi limit 1,207,442 lekë pa tvsh -Proc. e Prok. “Kërkesë për propozim” -Data e zhvillimit të prokurimit 20.07.2015, Ora 12:00 -Kanë marrë pjesë 3 (tre) operator ekonomik -Fitues “I” shpk Gjirokastër -Vlera e kontratës 1,081,130 lekë pa tvsh -Titullar A.M	A.B F.D R.J	L.M K.M G.B

Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Kjo procedure është iniciuar nga kërkesa e përgjegjës të zyrës teknike Z. F.D për mirëmbajtjen e objekteve fizike e impianteve dhe pajisjeve të zyrave për vitin 2015. Në kërkesën e hartuar prej tij janë përcaktuar sasi të nevojshme për mallrat e nënshkruara nga Z. S.G, Z. B.K dhe Z. F.D së bashku me sasi të. Z. F.D ka hartuar dhe specifikimet teknike për këtë procedurë. Në licencat profesionale të operatorëve ekonomik pjesëmarrës përgjegjësi i zyrës teknike ka kërkuar licencën NP-3B(Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile industrial veshjet fasadash). Një licencë që kërkohet për zëra punimesh mbi 5milion lekë ndërkohë që e gjithë procedura sipas preventivit të miratuar arrin 1,207,442 lekë. Element ky për të kufizuar OE edhe pse nuk është fare e nevojshme si kërkesë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Preventivi i procedurës është hartuar nga përgjegjësja e planifikimit Z. K.M dhe miratuar nga drejtori i spitalit Z. A.M me vlerë të përlogaritur prej 1,207,442 lekë pa tvsh.

Me urdhrin e prokurimit nr. 198 prot., datë 06.07.2015 ishte urdhëruar prokurimi i fondit limit prej 1,207,442 lekë pa tvsh me procedurë prokurimi: “Kërkesë për propozim” për kontratën me objekt “Mirëmbajtje e impiantistikës” me fonde të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit. Hartimi i dokumentacionit të tenderit është në mbështetje të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, procedura e përzgjedhur është “Kërkesë për propozim pasi fondi limit është nën kufirin e ulet monetar. Pasi është zhvilluar procedura e tenderit në datë 20.07.2015 është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave për 3(tre) operatorë që morën pjesë. Nga ana e KVO në procedurën e vlerësimit të ofertave ka skualifikuar 2 (dy) OE “E” me vlerë totale të ofertës 1,107,210 lekë pa tvsh dhe “T-D” me vlerë totale të ofertës 1,184,170 lekë pa tvsh dhe ka kualifikuar OE “I” shpk me vlerë totale të ofertës 1,081,130 lekë pa tvsh. Me vendimin nr.240 datë 05.08.2015 titullari i Autoritetit Kontraktor A.M është pranuar” ankesën për rivlerësimin e procedurës nga komisioni i vlerësimit të ofertave të OE “T-D” shpk. Pas rivlerësimit të ofertave datë 05.08.2015 nga KVO ka skualifikuar OE “E” dhe “I” për arsye se nuk plotëson kriterin e licencës profesionale të shoqërisë pas verifikimit të dokumentacionit dhe ka kualifikuar OE “T-D” shpk. Në datën 10.08.2015 KVO rivlerëson për herë të dytë ofertat e OE mbështetur në ankesën e OE “I” shpk mbi dokumentacionin ligjor të licencës profesionale të shoqërisë me këto kategori: NP-3 B, NS-2 A dhe NS-4 A ku sipas kompanisë licenca që ajo zotëron jo vetëm që i plotëson këto kriteret por i ka zërat për volume punime akoma edhe më të mëdha si më poshtë NP-3 C, NS-2 D dhe NS-4 E. Nga rivlerësimi i KVO kualifikohen dy OE “I” shpk me vlerë totale të ofertës 1,081,130 lekë pa tvsh dhe “T-D” shpk me vlerë totale të ofertës 1,184,170 lekë pa tvsh.

Mbi zbatimin e kontratës

Në procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtje e impiantistikës” viti 2015 për periudhën e furnizimit nga 25.08.2015-31.12.2015 me vlerë kontrate 1,297,356 lekë me tvsh u konstatua se gjatë periudhës së zbatimit të kontratës nr. 259 datë 25.08.2015 Godina e Maternitetit ka qenë në proces restaurimi ndërkohë që në këtë kontratë janë faturuar punime mirëmbajtje në këtë godinë. Këto shpenzime janë faturuar dhe përfituar padrejtësisht nga operatori fitues “I” shpk. **Vlera e materialeve dhe punimeve të situacionuara faturuar, dhe likujduara si punime të kryera në repartin e maternitetit është në vlerën 72,990 lekë vlerë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe duhet të kthehet nga përfituesi. Më hollësisht paraqiten si më poshtë të tre urdhërshpenzimet:**

- Me urdhër shpenzimin nr.398 datë 09.11.2015 është likujduar fatura nr. 26 datë 02.10.2015 me vlerë 748,884 lekë shoqëruar pa flet hyrje shoqëruar me situacionin nr 1 nënshkruar dhe pranuar nga përgjegjësi i teknikës F.D dhe nga ish drejtori i spitalit Z.A.M. Nga verifikimi i planit të shpërndarjes u konstatua se një pjesë e këtyre materialeve dhe shërbimit kryer është situacionuar në repartin e maternitetit dhe nuk e justifikon këtë shpenzim. Vlera e likujduar për këtë repart është 38,100 lekë.

- Me urdhër shpenzimin nr.398 datë 09.11.2015 është likujduar fatura nr. 26 datë 02.10.2015 me vlerë 748,884 lekë shoqëruar me situacionin nr 2 nënshkruar dhe pranuar nga përgjegjësi i teknikës F.D dhe nga ish drejtori i spitalit Z.A.M. Nga verifikimi i planit të shpërndarjes u konstatua se një pjesë e këtyre materialeve dhe shërbimit kryer është situacionuar në repartin e maternitetit dhe nuk e justifikon këtë shpenzim. Vlera e likujduar për këtë repart është 14,730 lekë.

-Me urdhër shpenzimin nr.392 datë 25.10.2016 është likujduar fatura nr. 9 datë 10.12.2015 me vlerë 395,292 lekë shoqëruar me situacionin nr 3 nënshkruar nga ish drejtori i spitalit Z.K.K. Nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

verifikimi i planit të shpërndarjes u konstatua se një pjesë e këtyre materialeve dhe shërbimit të kryer është situacionuar në repartin e maternitetit dhe nuk e justifikon këtë shpenzim. Vlera e likuiduar për këtë repart është 20,160 lekë.

Lidhur me observacionin 442/5 datw 11.07.2018 nga z. A.M nuk merret nw konsideratw pasi nuk janë paraqitur prova dhe fakte tw reja pwr procedurwn “Mirëmbajtje e impiantistikës”.

14. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje e pajisjeve mjeksore të, dializë + impiant uji i pajisjes së dializës”- Qershor 2015.

2. Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi nr. 189 prot. datë 17.06.2015 z.A.M	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 189, datë 17.06.2015 Znj. L.M	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 189/1,datë 17.06.2015 Z. A.B Kryetar Znj. F.D Znj. R.J
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Znj. K.M Znj. G.B	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,073,329 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “B-A” person fizik 1,070,000 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 3,329 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 29.06.2015 Ora 12:00	9.Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 O.E. b)S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b.Zbatimi i Kontratës me objekt: “Mirëmbajtje e pajisjeve mjeksore të, dializë + impiant uji i pajisjes së dializës”		
14.Lidhja e kontratës Nr.218 prot., datë 27.07.2016	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 1,284,000 lekë	16.Likuiduar 1,284,000

c. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Kjo procedure prokurimi është iniciuar për mbarvajtjen e punës gjatë trajtimit të pacientëve në dializë hartuar kërkesë nga përgjegjësi i zyrës teknike F.D datë 01.04.2015. Përgjegjësi i zyrës teknike F.D sëbashku me kërkesën për procedurën e mirëmbajtjes së pajisjeve ka hartuar dhe specifikimet e tyre në referencë të detyrës që mban. Janë hartuar specifikimet teknike dhe është zgjedhur një kontratë mirëmbajtje **Full RISK** për këto pajisje.

-Drejtori i Spitalit A.M ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 189 datë 17.06.2015 për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,073,329 lekë pa TVSH si dhe ka krijuar Njësinë e prokurimit të përbërë nga: L.M, K.M dhe G.B.

-Drejtori i Spitalit A.M ka nxjerrë urdhrin e brendëshëm nr. 189/1 datë 17.06.2015 për procedurën e prokurimit “Mirëmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: A.B kryetarë, F.D dhe R.J anëtare.

Fondi limit i kësaj kontrate është nxjerrë kryetarja e degës së planit K.M datë 15.06.2015 dhe miratuar nga drejtori A.M duke ju referuar kontratës së mëparshme.

-Drejtori i Spitalit A.M ka nxjerrë Formualrin e Njoftimit të Kontratës nr. 189/2 datë 17.06.2015 për procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim “Mirëmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,073,329 lekë pa TVSH datë zhvillimi tenderi 29.06.2015 ora 12:00.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Sipas procesverbalit datë 29/06/2015 për hapjen e ofertave vlerësimin e procedurës së prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,073,329 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 1 operatorë ekonomik:

1-Operatori ekonomik “B-A” me ofertë ekonomike 1,070,000 lekë.

-Sipas procesverbalit datë 09/07/2015 për vlerësimin e ofertave procedurës së prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,073,329 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë dhe u kualifikua 1 operatorë ekonomik me ofertë 1,070,000lekë.

Me shkresën datë 20.07.2015 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është hartuar raporti përmbledhës si dhe është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor.

Me vendimin nr. 212 datë 20.07.2015 titullari i autoritetit kontraktorë A.M ka shpalluar fitues operatorin ekonomik “B-A” me vlerë 1,070,000 lekë.

Me shkresën datë 20.07.2017 nga drejtori i institucionit është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

a.Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 218 prot., datë 27.07.2015, me vlerë 1,070,000 lekë pa tvsh (1,284,000 lekë me tvsh), me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2015. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër A.M dhe nga A.K përfaqësues i operatorit ekonomik “B-A”.

15. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: **“Mirmbajtje e pajisjeseve mjeksore të, dializë + impiant uji i pajisjes së dializës”- Prill 2016.**

2. Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi nr. 202 prot. datë 12.04.2016 z.K.K	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 202, datë 12.04.2016 Znj. A.Ll	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 202/1,datë 12.04.2016 Z. A.B Kryetar Znj. F.D Znj. R.J
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Znj. E.P Znj. G.B	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,382,776 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “B-A” person fizik 1,380,000 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,776 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 29.06.2015 Ora 12:00	9.Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 O.E. b)S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b.Zbatimi i Kontratës me objekt: ““Mirmbajtje e pajisjeseve mjeksore të, dializë + impiant uji i pajisjes së dializës””		
14.Lidhja e kontratës Nr.202/3prot, datë 16.05.2016	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 1,656,000 lekë	16.Likuiduar 1,656,380

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Kjo procedure prokurimi është iniciuar për mbarvajtjen e punës gjatë trajtimit të pacientëve në dializë hartuar kërkesë nga përgjegjësi i zyrës teknike F.D dhe inxhinier S.P datë 06.04.2016. Sëbashku me kërkesën për procedurën e mirmbajtjes së pajisjeve kanë hartuar dhe specifikimet e tyre në referencë të detyrës që mban. Janë hartuar specifikimet teknike dhe është zgjedhur një kontratë mirmbajtje **Full RISK** për këto pajisje.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 202 datë 12.04.2016 për procedurën e prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,382,776 lekë pa TVSH si dhe ka krijuar Njësinë e prokurimit të përbërë nga: A.LI, E.P dhe G.B.
-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e brendëshëm nr. 202/1 datë 12.04.2016 për procedurën e prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: A.B kryetarë, F.D dhe R.J anëtare.

Fondi limit i kësaj kontrate është nxjerrë kryetarja e degës së planit F.F dhe miratuar nga drejtori K.K duke ju referuar kontratës së mëparshme si dhe kontratës shtesë.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë Formularin e Njoftimit të Kontratës nr. 202/1 datë 12.04.2016 për procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,382,776 lekë pa TVSH datë zhvillimi tenderi 25.04.2016 ora 10:00.

-Sipas procesverbalit datë 25/04/2016 për hapjen e ofertave vlerësimin e procedurës së prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,382,776 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 1 operatorë ekonomik:

1-Operatori ekonomik “B-A” me ofertë ekonomike 1,380,000 lekë.

-Sipas procesverbalit datë 26/04/2016 për vlerësimin e ofertave procedurës së prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,382,776 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë dhe u kualifikua 1 operatorë ekonomik me ofertë 1,380,000lekë.

Me shkresën datë 04.05.2016 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është hartuar raporti përmbledhës si dhe është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor.

Me vendimin nr. 202 datë 04.05.2016 titullari i autoritetit kontraktorë K.K ka shpalluar fitues operatorin ekonomik “B-A” me vlerë 1,380,000 lekë.

Me shkresën datë 04.05.2016 nga drejtori i institucionit është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

a.Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 202/3 prot., datë 16.05.2016, me vlerë 1,380,000 lekë pa tvsh (1,656,000 lekë me tvsh), me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2016. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër K.K dhe nga A.K përfaqësues i operatorit ekonomik “B-A”.

16. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: **“Mirmbajtje e pajisjeseve mjeksore të, dializë + impiant uji i pajisjes së dializës”- Prill 2017.**

Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi nr. 97 prot. datë 28.02.2017 z.K.K	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 97, datë 28.02.2017 Znj. D.L	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 97/1, datë 28.02.2017 Z. M.G Kryetar Znj. F.D Znj. R.J
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Znj. E.P Znj. G.B	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,380,000 lekë pa tvsh	6.Oferta fituese (pa tvsh) “B-A” person fizik 1,380,000 lekë pa tvsh	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,776 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

8. Data e hapjes së tenderit 10.03.2017 Ora 10:00	9. Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 O.E. b) S'kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b. Zbatimi i Kontratës me objekt: ““Mirmbajtje e pajisjeve mjeksore të, dializë + impiant uji i pajisjes së dializës””		
14. Lidhja e kontratës Nr.135 prot., datë 07.04.2017	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 1,650,000 lekë	16. Likuiduar 1,650,000

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

Kjo procedure prokurimi është iniciuar për mbarvajtjen e punës gjatë trajtimit të pacientëve në dializë hartuar kërkesë nga përgjegjësi i zyrës teknike F.D dhe inxhinier S.P datë 28.02.2017. Sëbashku me kërkesën për procedurën e mirmbajtjes së pajisjeve kanë hartuar dhe specifikimet e tyre në referencë të detyrës që mban. Janë hartuar specifikimet teknike dhe është zgjedhur një kontratë mirmbajtje **Full RISK** për këto pajisje.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 97 datë 28.02.2017 për procedurën e prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,380,000 lekë pa TVSH si dhe ka krijuar Njësinë e prokurimit të përbërë nga: D.L, E.P dhe G.B.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë urdhrin e brendëshëm nr. 97/1 datë 28.02.2017 për procedurën e prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” si dhe ka ngritur komisionin e vlerësimit të ofertave të përbërë nga: M.G kryetarë, F.D dhe R.J antare.

Fondi limit i kësaj kontrate është nxjerrë kryetarja e degës së planit F.F dhe miratuar nga drejtori K.K duke ju referuar kontratës 202/3 datë 16.05.2016.

-Drejtori i Spitalit K.K ka nxjerrë Formularin e Njoftimit të Kontratës nr. 97/2 datë 28.02.2017 për procedurën e prokurimit Kërkesë për propozim “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,380,000 lekë pa TVSH datë zhvillimi tenderi 28.02.2017 ora 10:00.

-Sipas procesverbalit datë 10/03/2017 për hapjen e ofertave vlerësimin e procedurës së prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,380,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë 1 operatorë ekonomik:

1-Operatori ekonomik “B-A” me ofertë ekonomike 1,375,000 lekë.

-Sipas procesverbalit datë 13/03/2017 për vlerësimin e ofertave procedurës së prokurimit “Mirmbajtje e pajisjes mjeksore, dializë + impiant uji i pajisjes” me fond limit 1,380,000 lekë pa TVSH, hartuar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, në procedurën e prokurimit mori pjesë dhe u kualifikua 1 operatorë ekonomik me ofertë 1,375,000lekë.

Me shkresën datë 21.03.2017 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është hartuar raporti përmbledhës si dhe është miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor.

Me vendimin nr. 97/3 datë 21.03.2017 titullari i autoritetit kontraktorë K.K ka shpalluar fitues operatorin ekonomik “B-A” me vlerë 1,375,000 lekë.

Me shkresën datë 21.03.2017 nga drejtori i institucionit është nxjerrë formulari i njoftimit të fituesit në sistemin e APP.

a. Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 135 prot., datë 07.04.2017, me vlerë 1,375,000 lekë pa tvsh (1,650,000 lekë me tvsh), me afat nga data e lidhjes së



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

kontratës deri më datë 31.12.2016. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër K.K dhe nga A.K përfaqësues i operatorit ekonomik “B-A”.

17. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: **“Blerje materiale mjeksore për dializën”- Shkurt 2016.**

2. Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1. Urdhër Prokurimi nr.189 prot. datë 10.02.2016 z.K.K	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 189, datë 10.02.2016 Znj. L.M	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 189/1, datë 10.02.2016 Z. A.B Kryetar Znj. F.D Znj. R.J
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “procedurë e hapur”	Znj. K.M Znj. G.B	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 24,828,050 lekë pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh) “B-A” 24,788,660 lekë pa tvsh	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 39,390 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 25.02.2016 Ora 13:00	9. Burimi Financimit Fondet e SDKSH	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 O.E. b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
b. Zbatimi i Kontratës me objekt: “Blerje materiale mjeksore për dializën”		
14. Lidhja e kontratës Nr.133 prot., datë 10.03.2016	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 29,746,392 lekë	16. Likuiduar 29,746,392

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Në lidhje me “Materiale konsumi për Hemodializë” si dhe “Mirmbajtje paisje mjeksore Dializë” në spitalin rajonal “Omer Nishani” ky shërbim ofrohet nga vetë spitali, i cili është i paisur me 8 aparatura Hemodialize të cilët kanë një kosto mirmbajtje dhe zëvendësimi të materialeve për ofrimin e shërbimit mesatarisht në 35,000,000 në vit si: filtra polydulfani, set li nje arteriale+venoze etj, të cilat janë produkte që përdoren vetëm për një pacient. Operatori që ofron shërbimet e mirmbajtjes dhe produktet e konsumit për këto aparate në të gjithë periudhën e auditimit ështëi njëjti “BA” SHPK.

Janë audituar kontratat e furnizimit me materiale konsumi për pacientët e Hemodializës duke u marrë në analizë nga viti 2012 për të nxjerrë një konkluzion sa më të plotë ku u vu re e njëjta sasi e konsumuar mesatarisht ndër vite si dhe për çdo vit dhe mua u verifikuan rregjistrat e pacientëve për marrjen e shërbimit të hemodializës të cilët trajtohen mesatarisht 1 herë në 2.3 ditë kalendarike. U verifikuan funksionimi i aparatëve ku u gjendët të 8 në gjendje pune së bashku me pacientët.

Nga verifikimi u konstatua një menaxhimi i konsiderueshëm i pacientëve të shpërndarë sipas grup sëmundjesh ato me Hepatit C të ndarë në dhomë më vete për parandalimin e ngjitjes së këtij virusi pacientëve të tjerë. Pacientët me Hepatit B në një ambient tjetër dhe 4 aparatet e tjerë me trajtim pacientësh normal në mabjentin e përbashkët.

Ndarje e pacientëve bëhej për rritje e sigurisë pasi edhe pse u bënte sterilizimi i aparatit pas çdo trajtimi me acidin përkatës një nga materialet mjeksore për konsum nga ana e mjekëve të këtij reparti u shikonte e nevojshme përdorimi i këtyre aparatëve vetëm për këtë gamë pacientësh.

Furnizimet me materiale konsumi nga ana e operatorit fitues “B” ishin brenda afatit cilësia e materialeve të ofruara brenda garancisë.

Nuk u konstatuan diferenca apo mungesa në furnizim me pasoja financiare për institucionin.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

a.Me operatorin ekonomik fitues është lidhur kontrata e furnizimit me nr. 133 prot., datë 10.03.2016, me vlerë 24,788,660 lekë pa tvsh (**29,746,392** lekë me tvsh), me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2016. Kjo kontratë është nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër K.K dhe nga A.K përfaqësues i operatorit ekonomik “B-A”.

18-Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt ”Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve”, të Spitalit Rajonal Gjirokastër (SRGJ), për vitin 2015 me të dhënat si më poshtë, rezultoi se;

Të dhëna për tenderin	Njësia e Prokurimi	Kom. i Vler. të Ofertave
a	B	c
-Urdhër Prokurimi nr. 145 prot, dt 11.05.2015. -Fondi limit pa tvsh 1,249,992 lekë -Fondi limit me tvsh 1,499,990 lekë -Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 21.05.2015, ora 13.00 Subjekti fitues “A”sh.p.k Fier -Data e lidhjes së kontratës 16.06.2015 -Vlera e kontrat.pa tvsh 1,239,800 lekë -Vlera e kontrat.me tvsh 1,487,760 lekë -Diferenca fondi limit 12,230 lekë me tvsh, 0.8 %.	Emër Mbiemër L.M K.M G.B Urdhri nr. 145 prot, datë 11.05.2015	Emër Mbiemër A.B Kryetar F.D Anëtare R.J Anëtare Urdhri nr. 145/1prot, datë 11.05.2015

Me datë 07.04.2015 është mbajtur procesverbali nga V.S, E.P dhe D.Q, në të cilin shprehen se kanë marrë 3 oferta nga tregu për testimin e tregut, dhe kanë nxjerrë cmimin mesatar të ofertave duke përcaktuar vlerën e fondit limit. Komisioni ka vepruar pa asnjë urdhër nga titullari për kryerjen e këtij procesi, për marrjen e ofertave, testimin e tregut dhe përcaktimin e fondit limit.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi anëtarët e testimit të tregut V.S, E.P dhe D.Q.

Me urdhërin e prokurimit nr. 145, datë 11.05.2015, nga titullari i AK-së është urdhëruar të kryhet prokurimi me vlerën 1,249,992 lekë pa TVSH, për tenderin me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve”, me burim financimi FSDKSH, është përcaktuar se lloji i procedurës të jetë “Kërkesë për propozim, arsyeja e përdorimit nuk argumentohet, dhe ngarkohen për zbatimin e urdhërit Njësia e prokurimit e përbërë prej L.M, K.M dhe G.B.

Nga kjo procedurë prokurimi rezulton se titullari i AK-së, ***nuk ka kërkesë nga sektori përkatës për fillimin e saj, nuk ka argumentuar arsyen e nevojës për kryerjen e prokurimit, nuk ka argumentuar zgjedhjen e llojit të procedurës***, pra nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për këtë dosje, si dhe nga inventari i saj, nuk rezulton të ketë asnjë dokument për nisjen e saj, çka tregon se kjo procedurë ka nisur me urdhërin e prokurimit të hartuar nga ish-drejtori i SRGJ, duke mos argumentuar lindjen e nevojës për prokurim, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu II, neni 12.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK-së, z.A.M.

Me shkresën nr. 145/2 prot., datë 11.05.2015, është nga titullari i AK z. A.M është dërguar për publikim, formulari i njoftimit të kontratës në faqen e APP për këtë procedurë prokurimi në të cilën përcaktohen:

- a) Lloji i procedurës së prokurimit (Kërkesë për Propozim)
- b) Objekti i Prokurimit; “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

- c) Fondi Limit me vlerë prej 1,249,992 lekë pa t.v.sh.
- d) Afati i kryerjes së shërbimit (nga lidhja e kontratës – 31.12.2015)
- e) Data e zhvillimit të tenderit, me 21.05.2015, ora 13.00.

Preventivi i punimeve për shërbimet e automjeteve është hartuar nga F.D me detyrë shëf i teknikës, me datë 04.05.2015 i cili nuk ka paraqitur asnjë procesverbal mbi argumentimin e nevojës së riparimit të automjeteve, i cili ka nxjerrë dhe vlerën e fondit limit, si dhe nuk ka urdhër nga titullari për përcaktimin e këtij fondi.

Referuar sistemit të APP-së rezulton se u është dërguar ftesë 5 operatorëve si më poshtë;

1. K.B me nipt K82515602D, me fushë veprimtarie “Tregëti pjesë këmbimi, Servis auto”, Gjirokastrë, subjekt i cili sipas QKR-së së tij ka qënë aktive deri me datë 13/07/2012, dhe më pas ka kaluar në statusin “**I çregjistruar**”,
2. M.2 sh.p.k me nipt K73320401D, me fushë veprimtarie “Ndertime civile, turistike, industriale”, Fier.
3. A me nipt J63208420N, Fier, me fushë veprimtarie ndër të tjera dhe objektin e prokurimit,
4. M.K, i cili rezulton me status në faqen zyrtare të QKB, për tu paraqitur për përditësimin e të dhënave, dhe
5. L.N për të cilin nuk rezulton asnjë e dhënë në regjistrin e QKB-së.

Nga sa më sipër rezulton se NJP u ka dërguar ftesë për pjesëmarrje operatorëve të cilët nuk kanë në fushën e veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, çka do tregon se nuk janë njoftuar të paktën 5 operatorë për pjesëmarrje, pra nga AK nuk argumentohet dhe dokumentohet përzgjedhja e këtyre 5 operatorëve të cilëve u është dërguar ftesa, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, neni 39.

Në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit ndër të tjera janë vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë;

1. *Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit,*
2. *Pajisjet e mesiperme kerkohen te jene te pasqyruara ne pasqyrat financiare te shoqerise (ne bilancin ekonomik te vitit 2014) dhe te jene te rregjistruara ne inventarin e mjeteve kryesore te shoqerise (aktivet e qendrueshme AQT)*
3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij te punesuar jo me pak se 16 (gjashtembedhjete) punonjës mesatarisht per çdo muaj per periudhen Janar 2014-Mars 2015, nga te cilet ne stafin teknik gjate kesaj perudhe te jene te punesuar te pakten 1(nje) inxhinierë mekanik, 2(dy) motorrist, 1(nje) pompist, 1(nje) saldator,1(nje) gomist, 4(kater) xhenerikë, 1(nje) elektroauto.*

Në lidhje me kërkesat e mësipërme konstatohet se në preventivin e punimeve të automjeteve nuk ka ndërrim për gomat për të cilat është kërkuar pajisja e mësipërme, nuk argumentohet vendosja e kriterit për të cilin ofertuesi duhet të ketë jo më pak se 16 punonjës per periudhën janar 2014-mars2015, nuk ka punime saldimi për të cilin është kërkuar 1saldator, nuk ka punime për të cilat është kërkuar 1 gomist, ka kërkuar dy motorrist dhe katër xhenerikë pa argumentuar arësyet për këto kriteret, pra këto kriteret janë vendosur në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1, pika 2, nenin 2, dhe nenin 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, seksioni II, neni 28.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin anëtarët e NjP, L.M, K.M dhe G.B.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Me datë 21.05.2015, është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave nga ku rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 operator dhe konkretisht subjekti “A” shpk., me nipt J63208420N, me adresë Fier, i cili ka paraqitur ofertën e tij ekonomike në vlerën 1,239,800 lekë pa TVSH.

Me datë 25.05.2015 është mbajtur procesverbali i klasifikimit përfundimtar për përcaktimin e OE fitues “A”, shpk., i cili plotëson kërkesat e AK-së.

Me datë 02.06.2015 është hartuar raporti përmbledhës nga KVO, i cili është miratuar nga titullari i AK-së, në të cilin është shpallur fitues OE “A” shpk., Fier, me ofertë ekonomike 1,239,800 lekë pa TVSH.

Me shkresën pa nr. prot, datë 03.06.2015, është plotësuar Formulari i njoftimit të fituesit, i cili është dërguar për botim në faqen e APP-së.

-Me nr. 187, datë 16.06.2015, është hartuar dhe lidhur kontrata e shërbimit midis titullarit të SRGJ z. A.M dhe përfaqësuesit të OE fitues z. A.Z, me vlerë 1,239.800 lekë pa TVSH, me datë fillimi 16.06.2015 dhe afat deri në 31.12.2015.

-Formulari i sigurimit të ofertës është paguar në shoqërinë Sigal, me nr. 0043269, me datë 16.06.2015, në shumën prej 148,776 lekë.

Si konkluzion në lidhje me këtë procedurë prokurimit konstatohet se:

-Titullari i AK-së ka urdhëruar nisjen e procedurës së prokurimit pa patur kërkesat paraprake, pa lindur nevoja për kryerjen e saj, pa argumentuar zgjedhjen e procedurës së prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu II, neni 12.

-Preventivi i punimeve nuk është i argumentuar për secilin automjet, gjithashtu nuk vërtetohet nevoja e kryerjes së nderrimeve për disa zëra dhe këto punime janë vendosur duke supozuar se mund të prishen.

-Nga ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, rezulton se nuk u është dëgjuar të paktën 5 OE të cilët të kenë në fushën e veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, duke ngushtuar konkurrencën, siç duket qartë edhe nga pjesëmarrja e ofertave të dhëna në të cilën ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, pra nuk argumentohet dhe dokumentohet përzgjedhja e operatorëve, gjithashtu janë vendosur kriteret diskriminuese në Dokumentet Standarte të Tenderit, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1, pika 2, nenin 2, dhe nenin 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, seksioni II, neni 28, dhe neni 39, pika 4 paragrafi II-të.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin anëtarët e NjP L.M, K.M dhe G.B.

Në lidhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi auditimin e zbatimit të kontratës së mësipërme u konstatua se ;

Nga titullari i institucionit nuk është ngritur komision për zbatimin dhe mbikqyrjen e kontratës në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK-së, z.A.M.

Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit për shërbimet e kryera rezultoi se për pjesët të cilat janë ndërruar është hartuar procesverbal nga kryetari i degës teknike z.F.D dhe është nënshkruar nga secili shofer në të cilin shprehet se është bërë kthimi i tyre në magazinën e recuperos. Ndërkohë që pjesët e ndërruara nuk janë bërë në asnjë rast hyrje në magazinën e sipërpërmendur por ruhen nga shoferët në ambientet e garazhit të secilit. Nga verifikimi me zgjedhje i disa pjesëve të këmbimit të cilat ruhen nga shoferët rezultoi se mungonin disa prej tyre për të cilat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

nuk verifikohet fakti i ndërrimit të tyre. Në lidhje me kryerjen e shpenzimeve për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve nga titullari i AK-së nuk është kërkuar raport mbi zbatimin e kontratës së mësipërme. Më poshtë jepen të dhënat sipas shpenzimeve të kryera, për pjesët të cilat mungonin;

Urdher shpenzimi			Automjeti tip	Targa	Shoferi	Pjeset e pa nderruara	Vlera me tvsh
Nr	Date	Vlera					
500	21.12.2015	151800	Benz Mercedes	GJ 8745A	M.K	Nderrim impiant Elektrik	79200
						Nderrim koke moco	8400
						Bateri 100 Amp	20400
						Nderrim sensor I xhirove te sistemit te drejtimit	24000
521	23.12.2015	49680	Benz Mercedes	GJ 8745A	M.K	Bateri 100 Amp	20400
499	21.12.2015	43080	Benz Mercedes	AA 366 EJ	E.M	Nderrim cepa freni dore	4200
						Ferrota freni te rrotave perpara	3600
						Ferrota freni te rrotave te pasme	2880
						Disk freni te pare	14400
						Disk freni te pasem	14400
494	21.12.2015	38880	Benz Mercedes	AA 366 EJ	E.M	Nderrim I bokollave te krahut te ures se pasme	2880
						Stabilizatore te ures se pasme	3600
						Amortizator I rripit te jashtem	5400
						Amortizator paraleli	4200
						Ballancues dinamik	6000
						Bokulla kraresh te pare	3600
518	23.12.2015	99600	Benz Mercedes	AA 366 EJ	E.M	Suport amortizator I pare	6000
						Amortizator I pasem	15600
						Xhunto transmisioni e perparme	3600
						Bateri 100 Amp	20400
						Kembe kamio	3000
						kembe motorri	4200
						Kembe kabine	3600
						Kushinete rregjister rrip I jashtem I motorrit	6000
						Xhunto transmisioni e pasme	6000
195	21.12.2015	147360	Benz Mercedes	GJ 8744A	H.V	Koke moco	8400
						Koke paraleli	6000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

						Kryq transmisioni	7200
						Kushinete e mocos se rrotes se pasme	5400
						Kushinete e mocos se rrotes se pare	5400
						Puliexho e dinamos	5400
						Rregullator tensioni I dinamos	2400
						Sensor I impulseve te frenimit te ABS	21600
						Sensor pres/larte gazit ne sistemin A/C	3600
						Sensor presioni vaji	3600
						Stabilizatore te ures se pare	6600
						Tirant Avantreni	5400
522	23.12.2015	62280	Benz Mercedes	GJ 8744A	H.V	Ferrota te para	6600
						Ferrota te pasme	6000
						Bateri 100 Amp	20400
497	21.12.2015	145440	Benz Mercedes	GJ 8749A	K.Ç	Helike ventilatori I ajrit te ftohjes se radiatorit	2400
						Kandeleta	7200
						Kavo freni dore e pasme	3000
						Kembe kamio	9600
						Pompe freksioni	12000
						Silentblock krah avantreni	6000
						Stabilizator I pasem	5400
						Stabilizator I ures para	6600
						Suport kembe motorri	6000
						Tirant Avantreni	5400
519	23.12.2015	97920	Benz Mercedes	GJ 8749A	K.Ç	Elike ventilatori ajri radiatori	2400
						Fllanxe me permistop kollodoku	5400
						Rrip I jashtem I motorrit	7200
						Silentblock krah avantreni	6000
						Tubo fresibel freni e rrotave te pasme	3600
						Tubo fresibel freni e rrotave te para	4800
520	23.12.2015	79680	Benz Mercedes	AA 335 FS	E.M	Ferrota te para	6600
						Ferrota te pasme	6000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

						Bateri 100 Amp	20400
						Koke paraleli	6000
						Totali	531,960

Referuar tabelës mësipër vlera për pjesët të cilat nuk u gjenden është në shumën 531,960 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. **Shuma 531,960 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK-së, z.K.K, z.F.D në cilësinë e kryetarit të degës teknike.

19-Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt "Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve", të Spitalit Rajonal Gjirokastër (SRGJ), për vitin 2016 me të dhënat si më poshtë, rezultoi se;

Të dhëna për tenderin	Njësia e Prokurimi	Kom. i Vler. të Ofertave
a	b	c
-Urdhër Prokurimi nr.218 prot, datë 04.05.2016 -Fondi limit pa tvsh 1,083,333 lekë -Fondi limit me tvsh 1,300,000 lekë -Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 16.05.2016 -Subjekti fitues "A"sh.p.k Fier -Data e lidhjes së kontratës 27.06.2016 -Vlera e kontrat.pa tvsh 1,057,800 lekë -Vlera e kontrat.me tvsh 1,269,360 lekë -Diferenca fondi limit 30,640 lekë me tvsh, 2.35%.	Emër Mbiemër A.LI E.P G.B Urdhër Prokurimi nr. 218 prot, datë 04.05.2016	Emër Mbiemër A.B Kryetar F.D Anëtare R. J Anëtare Urdhri nr.218/1 prot, datë 04.05.2016

Me shkresën pa nr. Prot, pa datë është hartuar preventivi nga komisioni i përbërë prej F.D në cilësinë e përgjegjës të degës teknike, S.P në cilësinë e inxhinierit, dhe F.F në cilësinë e përgjegjës të planit, të cilët janë bazuar në kontratën e mëparëshme për përcaktimin e fondit limiti cili është në shumën 1,084,200 lekë pa TVSH. Komisioni ka vepruar pa asnjë urdhër nga titullari për kryerjen e këtij procesi, për përcaktimin e fondit limit. Gjithashtu preventivi për 5 prej automjeteve sprinter është kryer i përbashkët pa specifikuar se për çfarë ka nevojë secili prej automjeteve. Preventivi në disa zëra përveç nderrimit të vajrave dhe filtrave, në zërat e tjerë është kryer pa lindur realisht nevoja, apo pa kryer kontroll fizik nga i cili të rezultonte se duhen ndërruar disa prej pjesëve. Në asnjë rast nuk argumentohet nevoja dhe preventivi është bërë thujse i njëjtë me preventivin e një viti më parë, për të njëjtët zëra.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit F.D, S.P dhe F.F.

Me urdhërin e prokurimit nr. 218, datë 04.05.2016, nga titullari i AK-së është urdhëruar të kryhet prokurimi me vlerën 1,083,333 lekë pa TVSH, për tenderin me objekt "Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve", me burim financimi FSDKSH, është përcaktuar se lloji i procedurës të jetë "Kërkesë për propozim, arësyeja e përdorimit nuk argumentohet, dhe ngarkohen për zbatimin e urdhërit Njësia e prokurimit e përbërë prej A.LI, E.P dhe G.B.

Me shkresën nr. 218/2 prot., datë 04.05.2016, është nga titullari i AK z. K.K është dërguar për publikim, formulari i njoftimit të kontratës në faqen e APP për këtë procedurë prokurimi në të cilën përcaktohen:

1. Lloji i procedurës së prokurimit (Kërkesë për Propozim)
2. Objekti i Prokurimit; "Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve", për nevojat e SRGJ.
3. Fondi Limit me vlerë prej 1,083,333 lekë pa t.v.sh.
4. Afati i kryerjes së shërbimit (nga lidhja e kontratës – 31.12.2016)
5. Data e zhvillimit të tenderit, me 16.05.2016, ora 10.00.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Referuar sistemit të APP-së rezulton se u është dërguar ftesë 5 operatorëve nga të cilët;

1. K.B me nipt K82515602D, me fushë veprimtarie “Tregëti pjesë këmbimi, Servis auto”, Gjirokastër, subjekt i cili sipas QKR-së së tij ka qënë aktive deri me datë 13/07/2012, dhe më pas ka kaluar në statusin “**I çregjistruar**”,
2. Q, për të cilin nuk rezulton asnjë e dhënë në regjistrin e QKB-së.

Nga sa më sipër rezulton se NJP u ka dërguar ftesë për pjesëmarrje operatorëve të cilët nuk kanë në fushën e veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, çka do tregon se nuk janë njoftuar të paktën 5 operatorë për pjesëmarrje, pra nga AK nuk argumentohet dhe dokumentohet përzgjedhja e këtyre 5 operatorëve të cilëve u është dërguar ftesa, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, neni 39.

Në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit ndër të tjera janë vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë;

1. *Paisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit,*
2. *Pajisjet e mesiperme kerkohen te jene te pasqyruara ne pasqyrat financiare te shoqerise (ne bilancin ekonomik te vitit 2015) dhe te jene te rregjistruara ne inventarin e mjeteve kryesore te shoqerise (aktivet e qendrueshme AQT)*
3. *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij te punesuar jo me pak se 15 (pesëmbdhjete) punonjes mesatarisht per çdo muaj per periudhen Janar 2015-Mars 2016, nga te cilet ne stafin teknik gjate kesaj perudhe te jene te punesuar te pakten 1(nje) inxhinierë mekanik, 2(dy) motorrist, 1(nje) pompist, 1(nje) saldator,1(nje) gomist, 4(kater) xhenerikë, 1(nje) elektroauto.*

Në lidhje me kërkesat e mësipërme konstatohet se në preventivin e punimeve të automjeteve nuk ka ndërrim për gomat për të cilat është kërkuar pajisja e mësipërme, nuk argumentohet vendosja e kriterit për të cilin ofertuesi duhet të ketë jo më pak se 15 punonjës per periudhën janar 2015-mars2016, nuk ka punime saldimi për të cilin është kërkuar 1saldator, nuk ka punime për të cilat është kërkuar 1 gomist, ka kërkuar dy motorrist dhe katër xhenerikë pa argumentuar arësyet për këto kriteret, pra këto kriteret janë vendosur në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1, pika 2, nenin 2, dhe nenin 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, seksioni II, neni 28.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP A.LI, E.P, G.B, dhe S.P.

Me datë 16.05.2016, është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave nga ku rezultoi se ka marrë pjesë 2 operator dhe konkretisht subjekti “A” shpk., me nipt J63208420N, me adresë Fier, i cili ka paraqitur ofertën e tij ekonomike në vlerën 1,057,800 lekë pa TVSH, dhe operatori ekonomik Fluid-2015 i cili nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.

Me datë 18.05.2016 është mbajtur procesverbali i vlerësimit dhe klasifikimit përfundimtar për përcaktimin e OE fitues “A”, shpk., i cili plotëson kërkesat e AK-së.

Me datë 26.05.2016 është hartuar raporti përmbledhës nga KVO, i cili është miratuar nga titullari i AK-së, në të cilin është shpallur fitues OE “A” shpk., Fier, me ofertë ekonomike 1,057,800 lekë pa TVSH.

Me shkresën pa nr. prot, datë 26.05.2016, është plotësuar Formulari i njoftimit të fituesit, i cili është dërguar për botim në faqen e APP-së.

-Me nr. 325, datë 27.06.2016, është hartuar dhe lidhur kontrata e shërbimit midis titullarit të SRGJ z. K.K dhe përfaqësuesit të OE fitues z. A.Z, me vlerë 1,057,800 lekë pa TVSH, me datë fillimi 27.06.2016 dhe afat deri në 31.12.2016.

-Formulari i sigurimit të kontratës është paguar në shoqërinë Sigal, me nr. 0047161, me datë 01.06.2016, në shumën prej 126,936 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Si konkluzion në lidhje me këtë procedurë prokurimit konstatohet se:

-Preventivi i punimeve nuk është i argumentuar për secilin automjet, gjithashtu nuk vërtetohet nevoja e kryerjes së nderrimeve për disa zëra dhe këto punime janë vendosur duke supozuar se mund të prishen.

-Nga ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, rezulton se nuk u është dëguar të paktën 5 OE të cilët të kenë në fushën e veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, duke ngushtuar konkurrencën, siç duket qartë edhe nga pjesëmarrja e ofertave, pra nuk argumentohet dhe dokumentohet përzgjedhja e operatorëve, gjithashtu janë vendosur kritere diskriminuese në Dokumentet Standarte të Tenderit, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1, pika 2, nenin 2, dhe nenin 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, seksioni II, neni 28, dhe neni 39, pika 4 paragrafi II-të.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK z.K.K, anëtarët e NjP A.LI, E.P, G.B, komisionin e hartimit të preventivit F.D, F.F, S.P.

Në lidhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi auditimin e zbatimit të kontratës së mësipërme u konstatua se ;

Nga titullari i institucionit është ngritur komision për zbatimin dhe mbikqyrjen e kontratës me urdhërin nr. 325/2prot, datë 29.06.2016, por nuk ka asnjë raport në lidhje me zbatimin e saj, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 77.

Nga verifikimi i dokumentacionit për shërbimet e kryera rezultoi se për pjesët të cilat janë ndërruar është hartuar procesverbal nga kryetari i degës teknike z.F.D dhe është nënshkruar nga secili shofer në të cilin shprehhet se është bërë kthimi i tyre në magazinën e recuperos. Ndërkohë që pjesët e ndërruara nuk janë bërë në asnjë rast hyrje në magazinën e sipërpërmendur por ruhen nga shoferët në ambientet e garazhit të secilit. Nga verifikimi me zgjedhje i disa pjesëve të këmbimit të cilat ruhen nga shoferët rezultoi se mungonin disa prej tyre për të cilat nuk verifikohet fakti i ndërrimit të tyre. Më poshtë jepen të dhënat sipas shpenzimeve të kryera, për pjesët të cilat mungonin;

Urdher shpenzimi			Automjeti tip	Targa	Shoferi	Pjeset e këmbimit	Vlera me tvsh
Nr	Date	Vlera					
475	24.12.2016	169440	Benz Mercedes	AA 335 FS	T.D	Ferota te para	6600
						Ferota te pasme	6000
						Fillanxe me permistop kollodoku	5400
						Kembe kamio	9600
						Koke moco	8400
						Koke paraleli	6000
						Bateri 100 Amp	18000
						Suport kembe motorri	10800
472	24.12.2016	161760	Benz Mercedes	GJ 8752A	B.ZH	Bateri 100 Amp	18000
						Kushinete moco e pasme	5400



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

						Kushinete moco e perparme	4200
						Kembe kamio	9600
						Stabilizator I pasem	10800
474	24.11.2016	89640	Benz Mercedez	GJ 8749A	K.Ç	Ferrota te para	6600
						Ferrota te pasme	6000
						Koke moco	8400
						Koke paraleli	6000
						Bateri 100 Amp	18000
						Kushinete moco e pasme	5400
						Kushinete moco e perparme	4200
473	24.12.2016	125040	Benz Mercedez	AA 366 EJ	E.M	Nderrim I bokollave te krahut te ures se pasme	2880
						Stabilizatore te ures se pasme	3600
						Ferrota freni perpara	3600
						Amortizator paraleli	3000
						Koke paraleli	2880
						Koke moco	3000
						Suport amortizator I pare	4800
						Bateri 100 Amp	20400
						Kembe kamio	3000
						kembe motorri	3000
						Kushinete moco e rrotes ura e pasme	4200
						Kushinete rregjister rrip I jashtem I motorrit	3000
						Xhunto transmisioni e pasme	5400
469	24.11.2016	93960	Fiat Dukato	GJ4755A	V.L	Bateri 100 Amp	18000
						Koke moco	3000
						Koke paraleli	2400
						Kushinete moco e perparme	1800
						Cepa freni rrotat pas	6600
						Cepa freni rrotat perpara	4320
						Bracio avantreni	4800
						Kryq semiaksi	6000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

						Bokolla balestre te pasme	2400
387	25.10.2016	104400	Fiat Dukato	GJ4755A	V.L	Bateri 100 Amp	20400
						Koke moco	4200
						Koke paraleli	2400
						Kushinete moco e perparme	1800
						Cepa freni rrotat pas	6600
						Cepa freni rrotat perpara	4320
						Bracio avantreni	6000
						Kryq semiaksi	8400
						Bokolla balestre te pasme	4800
471	24.11.2016	193680	Benz Mercedes	GJ 8744A	H.V	Koke moco	8400
						Koke paraleli	6000
						Kryq transmisioni	7200
						Kushinete e mocos se rrotes se pasme	5400
						Kushinete e mocos se rrotes se pare	4200
						Sensor I impulseve te frenimit te ABS	9600
						Sensor pres/larte gazit ne sistemin A/C	3600
						Pompe freksioni	12000
						Bateri 100 Amp	18000
470	24.11.2016	121320	Benz Mercedes	GJ 8745A	M.K	Koke moco	8400
						Koke paraleli	6000
						Bateri 100 Amp	18000
						Kushinete moco e pasme	5400
						Kushinete moco e perparme	4200
						Stabilizator I ures perpara	12000
520	28.12.2016	150120	Iveko	GJ6236A	S.G	Bokolla krahu avantreni te poshtem	6000
						Bokolla krahu avantreni te siperm	6000
						Cepa te pasme	8400
						Kavo freni dore	7800
						Koka moco krah avantreni	6600



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

						Kushinete regi rrip faze motorri	19200
						Bateri 100 Amp	18000
						Totali	544,800

Referuar tabelës së mësipërme vlera për pjesët të cilat nuk u gjenden është në shumën 544,800 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. **Shuma 544,800 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK-së, z.K.K, z.F.D në cilësinë e kryetarit të degës teknike.

20-Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit me objekt "Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve", të Spitalit Rajonal Gjirokastrë (SRGJ), për vitin 2017 me të dhënat si më poshtë, rezultoi se;

Të dhëna për tenderin	Njësia e Prokurimi	Kom. i Vler. të Ofertave
A	B	C
-Urdhër Prokurimi nr.167 prot, datë 15.05.2017 -Fondi limit pa tvsh 1,249,950 lekë -Fondi limit me tvsh 1,499,940 lekë -Proc. e Prok. (Kërkesë për propozim) -Data e zhvillimit të tenderit 25.05.2017, ora 10.00 -Subjekti fitues "A"sh.p.k Fier -Data e lidhjes së kontratës 16.06.2017 -Vlera e kontrat.pa tvsh 1,091,680 lekë -Vlera e kontrat.me tvsh 1,310,016 lekë -Diferenca fondi limit 189,924 lekë me tvsh, 12.66%.	Emër Mbiemër H.Xh E.P G.B Urdhër Prokurimi nr.167 prot, datë 15.05.2017	Emër Mbiemër M.G Kryetar F.D Anëtare R.J Anëtare Urdhër nr.167/1 prot, datë 15.05.2017

Me shkresën pa nr. Prot, pa datë është hartuar preventivi nga komisioni i përbërë prej F.D në cilësinë e përgjegjësit të degës teknike. Kërkesa është e paargumentuar dhe e pabazuar në procesverbale për kontrollin e automjeteve, duke vendosur zëra të supozuar për hartimin e preventivit dhe nuk janë vendosur zëra punimesh të cilat kanë nevojë automjetet. Nuk është bërë asnjë analizë për ndërrimin e vajrave dhe filtrave duke llogaritur kilometrat e kryera nga secili automjet. Për asnjë automjet nuk argumentohet nevoja dhe preventivi është bërë thujse i njëjtë me preventivin e një viti më parë, për të njëjtët zëra. Gjithashtu preventivi për 5 prej automjeteve sprinter është kryer i përbashkët pa specifikuar se për çfarë ka nevojë secili prej automjeteve. Preventivi në disa zëra përveç ndërrimit të vajrave dhe filtrave, në zërat e tjerë është kryer pa lindur realisht nevoja, apo pa kryer kontroll fizik nga i cili të rezultonte se duhen ndërruar disa prej pjesëve.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi kryetarin e degës teknike z.F.D.

Llogaritja e fondit limit është kryer nga F.F me datë 15.05.2016, i cili bazuar në preventivin e nxjerrë nga dega teknike, bazuar në kontratën e mëparëshme të vitit 2016, si dhe për automjetin volkswagen crafter është bazuar në testimin e tregut nga komisioni i testimit të tregut, ka nxjerrë fondin limit në vlerën 1,249,950 lekë pa tvsh Me datë 10.05.2017 është mbajtur procesverbali nga F.D, E.P dhe V.S, në të cilin shprehen se kanë marrë 3 oferta nga tregu për testimin e tregut, dhe kanë nxjerrë cmimin mesatar të ofertave duke përcaktuar vlerën e fondit limit të automjetit volkswagen crafter. Komisioni ka vepruar pa asnjë urdhër nga titullari për kryerjen e këtij procesi, për marrjen e ofertave, testimin e tregut dhe përcaktimin e fondit limit. .

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi anëtarët e testimit të tregut F.D, V.S dhe E.P.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Me urdhërin e prokurimit nr. 167, datë 15.05.2017, nga titullari i AK-së është urdhëruar të kryhet prokurimi me vlerën 1,249,950 lekë pa TVSH, për tenderin me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve”, me burim financimi FSDKSH, është përcaktuar se lloji i procedurës të jetë “Kërkesë për propozim”, arësyeja e përdorimit nuk argumentohet, dhe ngarkohen për zbatimin e urdhërit Njësia e prokurimit e përbërë prej H.XH, E.P dhe G.B.

Me shkresën nr. 167/2 prot., datë 15.05.2017, është nga titullari i AK z. K.K është dërguar për publikim, formulari i njoftimit të kontratës në faqen e APP për këtë procedurë prokurimi në të cilën përcaktohen:

- f) Lloji i procedurës së prokurimit (Kërkesë për Propozim)
- g) Objekti i Prokurimit; “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve”, për nevojat e SRGJ.
- h) Fondi Limit me vlerë prej 1,249,950 lekë pa t.v.sh.
- i) Afati i kryerjes së shërbimit (nga lidhja e kontratës – 31.12.2017)
- j) Data e zhvillimit të tenderit, me 25.05.2017, ora 10.00.

Referuar sistemit të APP-së rezulton se u është dërguar ftesë 5 operatorëve nga të cilët;

1. L.N me nipt K32508616C, me fushë veprimtarie “Ne fushen e tregëtis e pjese kembimi per automjete”, Gjirokastrë, subjekt i cili sipas QKR-së nuk ka në fushën e veprimtarisë së tij objektin e tenderit.
2. J.LI, me nipt K32514757F, me fushë veprimtarie “Servis per automjete”, Gjirokastrë, subjekt i cili kryen vetëm servis për automjetet dhe nuk tregëton pjesë këmbimi për to.

Nga sa më sipër rezulton se NJP u ka dërguar ftesë për pjesëmarrje operatorëve të cilët nuk kanë në fushën e veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, çka do tregon se nuk janë njoftuar të paktën 5 operatorë për pjesëmarrje, pra nga AK nuk argumentohet dhe dokumentohet përzgjedhja e këtyre 5 operatorëve të cilëve u është dërguar ftesa, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV, neni 39.

Specifikimet teknike janë hartuar nga S.P dhe janë hartuar më pas DST-të nga Njësia e Prokurimit. Në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit ndër të tjera janë vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë;

1. *Pajisje per zmontimin dhe montimin e gomave ne diskun e rrotes se automjetit,*
2. *Pajisje diagnostikuese të difektit në automjet,*
3. *Pajisjet e mesiperme kerkohen te jene te pasqyruara ne pasqyrat financiare te shoqerise (ne bilancin ekonomik te vitit 2016) dhe te jene te rregjistruara ne inventarin e mjeteve kryesore te shoqerise (aktivet e qendrueshme AQT)*
4. *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij te punesuar jo me pak se 10 (dhjetë) punonjës mesatarisht për çdo muaj për periudhen Janar 2016-Mars 2017, nga te cilet ne stafin teknik gjate kesaj perudhe te jene të punësuar te paktën 1(një) inxhinierë mekanik, 1(një) motorrist, 1(një) pompist, 1(një) saldator, 1(një) gomist, 2(dy) xhenerikë, 1(nje) elektroauto.*
5. *Operatori ekonomik duhet të ketë karroatrec për transportimin e automjeteve të difektuara. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumenta që vërtetojnë se ka karroatrec në pronësi ose me qera.*

Në lidhje me kërkesat e mësipërme konstatohet se në preventivin e punimeve të automjeteve nuk ka ndërrim për gomat për të cilat është kërkuar pajisja e mësipërme, nuk argumentohet vendosja e pajisjes diagnostikuese ndërkohë që është hartuar preventivi i punimeve që do të kryhen, nuk argumentohet vendosja e kriterit për të cilin ofertuesi duhet të ketë jo më pak se 10 punonjës per periudhën janar 2016-mars 2017, nuk ka punime saldimi për të cilin është kërkuar 1saldator, nuk ka punime për të cilat është kërkuar 1 gomist, gjithashtu vendosja për karroatrec në rastin kur preventivi është i supozuar dhe nuk vërtetohet se cili automjet është në gjendje pamundësie për të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

lëvizur, pra këto kritere janë vendosur në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1, pika 2, nenin 2, dhe nenin 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, seksioni II, neni 28.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP H.XH, E.P, G.B, dhe S.P.

Me datë 25.05.2017, është mbajtur procesverbali i hapjes së ofertave nga ku rezultoi se ka marrë pjesë vetëm 1 operator dhe konkretisht subjekti “A” shpk., me nipt J63208420N, me adresë Fier, i cili ka paraqitur ofertën e tij ekonomike në vlerën 1,091,680 lekë pa TVSH.

Me datë 06.06.2017 është mbajtur procesverbali i vlerësimit dhe klasifikimit përfundimtar për përcaktimin e OE fitues “A”, shpk., i cili plotëson kërkesat e AK-së.

Me datë 14.06.2017 është hartuar raporti përmbledhës nga KVO, i cili është miratuar nga titullari i AK-së, në të cilin është shpallur fitues OE “A” shpk., Fier, me ofertë ekonomike 1,091,680 lekë pa TVSH, dhe titullari i AK-së me vendimin nr. 226, datë 14.06.2017 ka shpallur fitues OE të mësipërm.

Me shkresën pa nr. prot, datë 14.06.2017, është plotësuar Formulari i njoftimit të fituesit, i cili është dërguar për botim në faqen e APP-së.

-Me nr. 226/1, datë 16.06.2017, është hartuar dhe lidhur kontrata e shërbimit midis titullarit të SRGJ z. K.K dhe përfaqësuesit të OE fitues z. A.Z, me vlerë 1,091,680 lekë pa TVSH, me datë fillimi 16.06.2017 dhe afat deri në 31.12.2017.

-Formulari i sigurimit të kontratës është paguar në shoqërinë Sigal, me nr. 0049735, me datë 15.06.2017, në shumën prej 131,002 lekë.

Si konkluzion në lidhje me këtë procedurë prokurimit konstatohet se:

-Kërkesa dhe preventivi i punimeve nuk është i argumentuar për secilin automjet, gjithashtu nuk vërtetohet nevoja e kryerjes së nderrimeve për disa zëra dhe këto punime janë vendosur duke supozuar se mund të prishen.

-Nga ftesat për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, rezulton se nuk u është dërguar të paktën 5 OE të cilët të kenë në fushën e veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, duke ngushtuar konkurrencën, siç duket qartë edhe nga pjesëmarrja e ofertave, pra nuk argumentohet dhe dokumentohet përzgjedhja e operatorëve dhe,

- Janë vendosur kritere diskriminuese në Dokumentet Standarte të Tenderit, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1, pika 2, nenin 2, dhe nenin 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, seksioni II, neni 28, dhe neni 39, pika 4 paragrafi II-të.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP H.XH, E.P, G.B, dhe S.P për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe F.D në cilësinë e hartimit të preventivit.

Në lidhje me dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi auditimin e zbatimit të kontratës së mësipërme u konstatua se ;

Në lidhje me zbatimin e kontratës së mësipërme konstatohet se nga titullari i institucionit nuk është ngritur komision për zbatimin dhe mbikqyrjen e kontratës në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 77.

Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK-së, z. K.K.

Nga verifikimi i dokumentacionit për shërbimet e kryera rezultoi se për pjesët të cilat janë ndërruar është hartuar procesverbal nga kryetari i degës teknike z.L.Q dhe është nënshkruar nga secili shofer në të cilin shprehhet se është bërë kthimi i tyre në magazinën e rekuperos. Ndërkohë që pjesët e ndërruara nuk janë bërë në asnjë rast hyrje në magazinën e sipërpërmendur por ruhen nga shoferët në ambientet e garazhit të secilit. Nga verifikimi me zgjedhje i disa pjesëve të këmbimit të cilat ruhen nga shoferët rezultoi se



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

mungonin disa prej tyre për të cilat nuk verifikohet fakti i ndërrimit të tyre. Në lidhje me kryerjen e shpenzimeve për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve nga titullari i AK-së nuk është kërkuar raport mbi zbatimin e kontratës së mësipërme. Më poshtë jepen të dhënat sipas shpenzimeve të kryera, për pjesët të cilat mungonin;

Urdher shpenzimi			Automjeti tip	Targa	Shoferi	Pjeset e pa nderruara	vlera me tvsh
Nr	Date	Vlera					
519	26.12.2017	121296	Benz Mercedes	AA 366 EJ	E.M	Bokolla te kraheve te ures se pasme	2880
						Ferrota freni te rrotave te para	3960
						kembe gabine	3000
						koke paraleli (M/D)	1800
						koke moco	2400
						kuzhinete moco rrotes pare	1800
						xhunto trasmissioni e perparme	3000
						Bateri 100 Amp	2040
						Amortizatore paraleli	20400
						Kembe kambio	3000
						Kembe motorri	2400
						Kushinete moco e rrotes ura e pasme	4320
517	26.12.2017	123864	Benz Mercedes	GJ 8752A	B.ZH	Bateri 100 Amp	20400
						Kushinete moco e pasme	3000
						Kushinete moco e perparme	6000
						Kembe kamio	4320
						Pompe freksioni	4320
520	26.12.2017	135144	Benz Mercedes	AA 335 FS	E.M	Ferrota te para	7200
						Ferrota te pasme	7200
						Koke moco	7200
						Koke paraleli	4800
						Bateri 100 Amp	20400
						Kushinete moco e pasme	3000
521	26.12.2017	81000	Fiat Dukato	GJ4755A	V.L	Bateri 100 Amp	20400
						Koke moco	2400
						Koke paraleli	1800



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIRKASTËR.

						Kushinete moco e perparme	1800
						Cepa freni rrotat pas	3000
						Ferrota freni rrotat perpara	3000
						Bracio avantreni	3600
						Kryq semiaksi	1800
						Bokolla balestre te pasme	1200
522	26.12.2017	135384	Benz Mercedes	GJ 8749A	K.Ç	Ferrota te para	7200
						Ferrota te pasme	7200
						Koke moco	7200
						Koke paraleli	4800
						Bateri 100 Amp	20400
						Kushinete moco e pasme	3000
523	26.12.2017	122784	Benz Mercedes	GJ 8744A	H.V	Ferrota te para	7200
						Ferrota te pasme	7200
						Koke moco	7200
						Koke paraleli	4800
						Kryq transmisioni	6000
						Kushinete e mocos se rrotes se pasme	3000
						Kushinete e mocos se rrotes se pare	3000
						Bateri 100 Amp	20400
524	26.12.2017	123744	Benz Mercedes	GJ 8745A	M.K	Koke moco	7200
						Koke paraleli	4800
						Bateri 100 Amp	20400
						Kushinete moco e pasme	3000
						Kushinete moco e perparme	3000
525	26.12.2017	116400	Iveko	GJ6236A	S.G	Cepa te pasme	7920
						Kavo freni dore	4320
						Koka moco krah avantreni	6000
						Kushinete regj rrip faze motorri	3600
						Bateri 100 Amp	18000
						Totali	364,680



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Referuar tabelës më sipër vlera për pjesët të cilat nuk u gjenden është në shumën 364,680 lekë, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. **Shuma 364,680 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK-së, z.R.K, z.L.Q në cilësinë e kryetarit të degës teknike.**

(Në lidhje me procedurat dhe shpenzimet e të tre procedurave për "Riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve", konstatohet se për automjetin tip Mercedes-Benz me targa AA 366 EJ i vitit të prodhimit 1990 janë kryer shpenzime për të tre vitet në shumën 328,296 lekë (81,960 lekë për vitin 2015, 125,040 lekë për vitin 2016 dhe 121,296 lekë për vitin 2017), shpenzime të cilat janë në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit dhe efektivitetit, pasi kostoja e riparimit dhe mirëmbajtjes së këtij automjeti tejkalon vlerën e blerjes së një automjeti të ngjajshëm, ku në kushtet e tregut ekzistencial mund të gjejshim automjete të ngjajshme të cilat variojnë në shumën e rreth 150,000 lekë sipas verifikimeve të bëra në tregun e automjeteve në faqet e ndryshme në VWeb. Nga ana e drejtuesve të insitucionit dhe strukturat mbështetëse nuk është kryer një studim pikë së pari për vlerësimin e këtij aktivi si dhe për shpenzimet që janë kryer në lidhje me të. Arrihet në konkluzion se shpenzimet për këtë automjet janë shpenzime të keqmenaxhuara në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, që kanë rënduar buxhetin e shtetit në shumën prej 328,296 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ.)

Në lidhje me shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve, grupi i auditimit arrin në konkluzionin se preventivat që kryhen për çdo vit janë thuajse të njëjtat për secilin automjet, nuk ka dokument për hyrjen në magazinë të pjesëve të dëmtuara të cilat janë ndërruar për të 9 automjetet, nuk ka një monitorim real të kilometrave të përshkuara dhe kilometrazhit të tyre, bazë për ndërrimin e vajit, filtrave dhe shërbimeve xhenerike, të cilat kryhen periodikisht, ç'ka vërteton faktin se këto procedura për disa pjesë këmbimi kryen në mënyrë jo reale dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërinë e riparimit të nevojshëm të tyre. Në cdo vit janë vendosur në preventiv pjesë për tu ndërruar të të njëjtit krah të automjetit, nevojat dhe preventivat për të tre procedurat janë thjesht parashikime për diçka që mund të ndodhë gjatë vitit dhe jo për nevojat reale që kanë patur automjetet.

-Gjithashtu në lidhje me zbatimin e Ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se;

Nga titullari i Spitalit Rajonal Gjirokastrë z.R.K është lidhur një Akt-Marrveshje me nr. 492. prot, datë 21.12.2017, me përfaqësuesin e subjektit ekonomik "G-4", z.Ç.K. Kjo marrëveshje lidhet midis palëve në vijim të kontratës së shërbimit për vitin 2017, me objekt "Ruajtjen me polici private të ambienteve të spitalit", me nr 368/3 prot, datë 18.10.2017, me afat shërbimi deri në 31.12.2017. Bazuar në këtë marrveshje titullari i SRGJ i jep të drejtën e mbledhjes së të ardhurave nëpërmjet administrimit të parkimit të ambienteve të spitalit. Ky akt është i pabazuar ligjërisht dhe në ***kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.***

Në lidhje me këtë marrveshje u kërkuar nga dega e financës mbi të ardhurat të cilat janë arkëtuar për periudhën në të cilën është lidhur marrëveshja e mësipërme nga ku rezultoi se nga OE nuk rezultoi të jetë derdhur asnjë shumë për përmbushjen e qëllimit të saj. Gjithashtu nuk mund të vërtetohet fakti nëse OE ka gjeneruar të ardhura në lidhje me këtë marrëveshje, dhe se si është



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

proceduar, pasi nga titullari i SRGJ nuk është ngritur as komision në lidhje me mbikqyrjen e kësaj marrveshje.

Për veprimin e mësipërm mban përgjegjësi:

18) Z. R.K me detyrë, ish-Drejtor i SRGJ, në cilësinë e nëpunësit autorizues.

Në observacionet e dërguara me shkresat nr. 440/40 prot, 440/41 prot, 440/42 prot, 440/43 prot, 440/44 prot, 440/45 prot, 440/36 prot, 440/37 prot, datë 05.07.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Gjirokastrë, nga punonjësit z.B.ZH, z.S.G, z.E.M, z.V.L, z.M.K, z.H.V z.T.D dhe z.H.P me pozicion shoferë të automjeteve në SRGJ, në lidhje me akt-konstatimet nr. 7/7 dhe nr. 7/8, në të cilët shprehen se;

Nga ana jonë është mbajtur procesverbal në lidhje me konstatimin e pjesëve të ndërruara në servilin ku na është caktuar kryerja e shërbimeve midis tyre dhe shefit të teknikës, por nuk ka është kërkuar ku ti dorësojmë këto pjesë të ndërruara. Nga institucioni duhej të ngrihej një komision për marrjen e tyre dhe nxjerrjen jashtë përdorimit në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe ky proces nuk është kryer nga ana jonë. Në lidhje me këto pretendime sqarojmë se:

Përgjigje:

Përsa i përket observacionit pranohet pretendimi i punonjësve pasi hartimi dhe ndjekja e procedurës është kryer në secilin rast nga shefi i degës teknike. Përgjegjësia në këto raste është e Kryetarit të Degës Teknike i cili nuk ka kryer sic duhet detyrat funksionale të tij në bazë të Rregullores funksionale të institucionit dhe Legjislacionit në fuqi.

Gjithashtu në lidhje me pretendimet e z.T.D dhe z.H.P, se janë vendosur padrejtësisht emrat e tyre në lidhje me shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e automjeteve, dhe se për këto shpenzime nuk janë ata personat të cilët kanë nënshkruar, meret në konsiderat observacioni bazuar në dokumentet e vëna në dispozicion dhe u kryen reflektimet përkatëse në këtë material auditimi.

Argumentet e paraqitura në observacion pranohen dhe meren në konsideratë.

Është dërguar observacion me shkresën nr. 440/46 prot, datë 09.07.2018, e ardhur nga Spitali Rajonal Gjirokastrë, nga punonjësi z.H.XH, me detyrë anëtar i njësisë së prokurimit, në lidhje me akt-konstatimin nr 7/8, në të cilin shprehet se;

Si anëtar i njësisë së prokurimit për procedurën me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të SRGJ”, jam ngarkuar me përgjegjësi në lidhje me kërkesën e cila u është bërë 5 operatorëve ekonomik, të cilët të kenë lidhje në fushën e veprimtarisë së tyre, se është e pamundur të bëhet përzgjedhja sipas fushës pasi sistemi nuk ta ofron një mundësi të tillë. Gjithashtu në aktkonstatim jam ngarkuar me përgjegjësi për vendosjen e kriterëve diskriminuese, për të cilat kundërshtoj pasi janë bërë kërkesa të domosdoshme për riparimin e automjeteve. Në lidhje me këto pretendime sqarojmë se:

Së pari: Observacioni i paraqitur në lidhje me dërgimin e 5 operatorëve, risqarojmë se nga ana juaj nuk janë argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë në përputhje me nenin 39, pika 4, paragrafi i dytë të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilin citohet se “Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë që do të ftojë”, për më tepër që është e natyrshme që argumentimi dhe ftesa duhet të lidhet me objektin e veprimtarisë së OE të cilit do ti dërgohet ftesa.

Së dyti: Për sa i përket vendosjes së kriterëve në procedurën e prokurimit, risqarojmë se kriteret janë vendosur jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, seksioni II, neni 28, pikat 5, geramat c) dhe ç) në të cilin citohet se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon “dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose, dështim për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion për të përmbushur kontratën”, ndërkohë që këto kritere duhet të jenë gjithashtu në përputhje me objektin dhe qëllimin e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 1, pika 2, nenin 2, dhe nenin 46. Sa më sipër observacionet në lidhje me dy pikat e mësipërme nuk janë të bazuara ligjërisht. *Argumentet e paraqitura nuk merren në konsideratë.*

Në observacionet e dërguara me shkresën nr. 442/9 prot, datë 08.08.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Gjirokastër, nga ish-drejtori z.A.M në lidhje me akt-konstatimin nr. 7/6, në të cilët është shprehur se;

Në lidhje me akt-konstatimin nr. 7/6, sa i përket procedurës së prokurimit me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve për vitin 2015”, në të cilën observohet se nuk kam nisur një procedurë pa patur dokumentacionin e duhur, sikurse është shprehur grupi i auditimit, gjithashtu në lidhje me vendosjen e kritereve të cilat janë të pa argumentuara, sqarojmë se:

Nga ana e observuesit nuk është vënë asnjë dokumentacion në dispozicion për shqyrtimin e tij, dhe në lidhje me vendosjen e kritereve për procedurën e prokurimit sa më sipër, kemi kryer reflektimet përkatëse në këtë Projektraport Auditimi.

Nisur nga sa më sipër observacioni merret në konsideratë pjesërisht.

Në observacionet e dërguara me shkresën nr. 440/51 prot, datë 31.07.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Gjirokastër, nga z.A.B, z. F.D dhe z. S.P në lidhje me objektin “Rikonstruksioni i Godinës së Maternitetit Spitali Gjirokastër” nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Në observacionet e dërguara me shkresën nr. 440/50 prot, datë 26.07.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Gjirokastër, nga z. L.Q në lidhje me aktkonstatimin nr. 7/8 nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Në observacionet e dërguara me shkresën nr. 27/7 prot, datë 27.07.2018, të ardhur nga Spitali Rajonal Gjirokastër, nga z. F.D në lidhje me aktkonstatimet nr.7/7 dhe 7/8 nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

21. Dosja e procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Medikamente”- Janar 2018.

Dosja me dokumentet e operatorit ekonomik fituese.

“Blerje Medikamentesh” me procedurë “Me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”.

Të dhëna për tenderin	K.V.O.	Nj.P.P.
a	b	c



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Urdhër Prok. Nr 211 Prot., datë 20.07.2015 -Fondi limit 1,715,715 lekë pa tvsh -Proc. e Prok. “Kërkesë për propozim” -Data e zhvillimit të prokurimit 2.03.2018, Ora 12:00 -Kanë marrë pjesë 3 operator ekonomik -Fitues “FF” dhe “IA” SHPK Tiranë --Vlera e kontratës: 3,348,795 lekë -Vlera e kontratës:1,228,817 lekë -Titullari i AK: R.K	M.G D.T B.A	N.SH A.Sh S.P
--	-------------------	---------------------

Argumentimi I Fondit limit

Grupi I auditimit ka verifikuar gjendjen në magazinë të disa medikamenteve para procedurës së prokurimit dhe është analizuar konsumi mesatar për 15ditë I secilit medikament mbi bazën e të cilit duhet të ishte përllogaritur nevoja për medikamente për periudhën 30.01.2018-15.04.2018 (74 ditë) pra fondi limit. Nga verifikimi rezultoi si më poshtë:

Medikamente	Gjendja para hartimit të fondit limit								
	3.01	15.01	30.01	15.02	28.02	Mes atari sht ne 15 dite	Urdher prokuri mi date 30janar deri ne 15 prill (74 dite)	vlera qe duhet te ishte	efekti financiar
Ranitidine 50mg f/amp	549	538	489	459	368	46	5572	250	96,328.2
Cefotaxime fl amp 1 gr	2880	2835	2783	2651	2217	170	1790	880	273,482.3
Ceftriaxone 1gr fl/amp	189	141	90	16	16	45	3500	250	372,385
Ciprofloxacine100mg/10 ml	321	315	239	175	175	40	3576	250	142,918.2
Metronidazole 500mg/100ml	139	129	129	129	122	5	2400	30	271,560
Prednisolone 25mg/2ml	130	117	938	313	25	330	2750	2000	133,650
paracetamol	1140	1128	1128	1112	958	50	1840	300	274,120
Total									1,564,524

Konstatohet se për medikamentet e më sipërme është planifikuar një sasi më e madhe nga sa konsumohet realisht. Mbështetur në të dhënat e farmacisë jo vetëm për gjendjen e ilaceve para procedurës së prokurimit por dhe me sasinë e madhe të ilaceve të skaduara për vitet objekt auditimi mund të themi se vlera e përllogaritur më sipër prej **1,564,524 lekë përbën efekt financiar negativ duke shkelur parimet e efencës efektivitetit dhe economicitetit duke krijuar një fryrje të fondit limit.**

Zbatimi I kontratës

Është lidhur kontrata nr.195 datë 05.03.2018 për furnizimin me “Medikamente lot 5, lot 6, lot 7, lot 8, lot 11, lot 16, lot 28, lot 32, lot 35, lot 36, lot 37, lot 43, lot 74, lot 83, lot 86” me operatorin ekonomik “FF” Sh.p.k Tiranë me Vlerën totale 3,348,795.8 lekë pa tvsh. Si dhe është lidhur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

kontrata nr.198/1 datë 19.03.2018 për furnizimin me “*Medikamente lot 48, lot 42, lot 46, lot 52, lot 51, lot 41, lot 49, lot 33, lot 50, lot 39, lot 25, lot 22, lot 26, lot 24, lot 18, lot 17, lot 10, lot 9, lot 87, lot 88, lot 84, lot 82, lot 81, lot 80, lot 79, lot 78, lot 77, lot 76, lot 73, lot 72, lot 69, lot 67, lot 66, lot 63, lot 62, lot 61, lot 53, lot 60, lot 59.*” Me operatorin ekonomik “*IA*” shpk Tiranë në vlerën 1,228,817 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se lëvrimi i medikamenteve është kryer më datë 13.03.2018 ndërkohë që medikamentet Cefprozid dhe Pereoksid hidrogjeni ka afat skadence nentor 2018 në kundërshtim me Nenin 6 pika 1 e kontratës: “data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prdhimit dhe asaj të skadencës ose jo më pak se një vit nga data e lëvrimit të mallit.” **Medikamentet në kundërshtim me kushtet e kontratës janë në Vlerën 70,577 lekë dhe përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shteti dhe duhet kthehet nga përfituesi “FF” shpk që me dijëni ka furnizuar me barna jo në përputhje me kontratën.**

22.Zbatimi i kontratës “**Medikamente, B6, loti 7**” me procedurë prokurimi të përqëndruar.

Për blerjen “Medikamente, B6, loti 7” është përdorur procedura e prokurimit të përqëndruar ku është shpallur fitues operatori “C.PH” dhe është nënshkruar kontrata nr.303 datë 31.07.2017 me vlerë 358,800 lekë.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës u konstatua se në aktkolaudimin e datës 31.07.2017 Kontraktori “C.PH” ka bërë të gjithë lëvrimin e mallit të kontratës për një herësh dhe nuk është kryer shpërndarja sic është parashikuar në kushtet e kontratës neni 3 pika 1: “20% e mallit në muajin e parë, 20% në të dytin, 10% të tretin, 10% të katërtin dhe pjesën tjetër deri në fund të kontratës. Shitësi është i detyruar të lëvrojë të gjithë sasinë e kontraktuar brenda datës 15.12.2017”. Furnizimi me medikamente në kundërshtim me kushtet e kontratës shkakton probleme jo vetëm në përmbushjen me nevojat për medikamente brenda shtrirjes kohore që parashikon kontrata por dhe në cilësinë e tyre. Pasi nëse bëhet shpërndarja e furnizimit sipas kushteve të kontratës edhe afati i skadimit të tyre do zgjatej në kohë duke garantuar një efektivitet në përdorimin e fondeve publike dhe në cilësinë e produkteve të blera.

Medikamenti Heparin Calcica 1200 UI mban një afat skadence më pak se një vit (janar 2018) duke shkelur kështu nenin 6 pika 2 e kontratës “Afati i skadencës....ose jo më pak se një vit nga data e lëvrimit të mallit”. Kjo kontratë duhet të mbulonte furnizimet e nevojshme deri më datë 15.12.2017. Nga verifikimi I gjëndjes së këtij medikamenti në farmacinë e SRGJ në 31.12.2017 u konstatua se nuk kishte mbetur gjëndje e këtij medikamenti. ***Edhe pse medikamenti është konsumuar brenda afatit të skadimit, furnizimi me medikamente në kundërshtim me kushtet e kontratës ngarkon me përgjegjësi operatorin ekonomik “C.PH” ndërkohë që pranimi i këtij medikamenti ngarkon me përgjegjësi grupin e kolaudimit dhe marrjes në dorëzim.***

Lidhur me pagesat:

-Me urdhër shpenzim nr.343 datë 30.08.2017 “Medikamente” me vlerë 358,800 lekë për llogari të operatorit “C.PH SHPK” disponohen fletë hyrje nr.112 datë 31.07.2017, fatura nr.140184 datë 31.07.2017, aktkolaudimi I datës 31.07.2017 dhe kontrata nr.303 dt.31.07.2017.

23.“**Kite & Reagente**”, kontratë shtesë “Me negociim”

Me objekt blerjen e “Kite&Reagent” është lidhur shtesë kontratë nr.66/1 datë 07.02.2017 me operatorin ekonomik “G-A F” shpk me vlerë 852,000 lekë me tvsh.

Nga audimi u konstatua se lëvrimi i mallit është kryer 13 ditë nga nënshkrimi i kontratës në kundërshtim me nenin 3 pika 1 e kontratës “Shitësi është i detyruar të fillojë lëvrimin dhe dorëzimin e mallit në depon e Spitalit Gjirokastër brenda jo më shumë se 10 ditësh nga nënshkrimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

i kontratës. Gjithashtu nga verifikimi i datës së skadencave në ditën e lëvrimit të mallit data 20.02.2017 rezultoi se një pjesë e kite&reagentëve kanë afat skadence më të vogël se 18 muaj sic citohet në nenin 6 pika 1 e kontratës. Më konkretisht:

Kite&Reagent	Sasia	Cmimi	Vlera	Hyrja	Skadenca
CKMB	1000	108	108,000	17-shkurt	17-korrik
Bilirubine total	2000	10.8	21,600	17-shkurt	17-Nentor
Tromboplastine	600	18	10800	17-shkurt	17-Nentor
Ck-nac 25-3ml	1000	36	36000	17-shkurt	17-korrik
Total			176,400		

Furnizimi me Kite & Reagentet e më sipërme nuk duhet të ishte bërë nga operatori ekonomik dhe as të ishin pranuar nga komisioni i marrjes në dorëzim pasi bie në kundërshtim me kushtet e kontratës. **Vlera prej 176,400 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe duhet kthehet nga përfituesi “G-A F”, shpk që me dijeni ka furnizuar me barna jo në përputhje me kontratën.**

Lidhur me pagesat:

Me urdhër shpenzimi nr.62 datë 06.03.2017 “Kite&Reagent” me vlerë 852,600 lekë për llogari të operatorit “G-A F” shpk disponohet fletë hyrje nr.18/1 datë 20.02.2017, fatura nr.77 datë 20.02.2017, aktkolaudimi datë 20.02.2017.

VIII. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Në lidhje me organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollin u hartuan dhe u dorëzuan elektronikisht pyetësorët përkatës në zbatim të drejtimit të auditimit për implementimin dhe organizimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, dhe i’u dorëzuan drejtuesit të institucionit dhe zv.drejtuesit ekonomik për të paraqitur dokumente në lidhje me zbatimin e këtij drejtimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet që:

Nga ana e drejtimit institucional nuk është vënë në funksionim Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, nuk njihet nga strukturat drejtuese të shoqërisë e punonjësit e saj, nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit sipas periudhave përkatëse nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”, pika 15, germa “a”, nga institucioni për vitin 2015, 2016 dhe për vitin 2017, nuk është hartuar dhe dërguar në ministri deklarata e misionit të institucionit dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Për vitin 2015, 2016 dhe 2017 SRGJ, nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V “Shtojcat”, Shtojca 2 – Pyetësori i vetë-vlerësimit për komponentët e MFK-së.

-Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, germa “a”, dhe Manualin për Menaxhimin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.8 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësisive të sektorit publik”, germa “a”, SRGJ nuk ka hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit.

-Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”, SRGJ nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

-Për Spitalin Rajonal Gjirokastër, nëpunësi autorizues është Drejtori i institucionit, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e programit ekonomik.

-Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin përgjegjës i sektorit të Financës, caktuar me shkresën nr. 419 prot, datë 16.11.2015 drejtuar Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Kontrolluese, Njësisë Qëndrore të Harmonizimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, dhe për dijeni degës së thesarit Gjirokastër, dhe me nr. 16004/1prot, datë 23.11.2015, nga MF, Drejtoria përkatëse ka adhur konfirmimi i nëpunësit zbatues i cili është ende në këtë pozicion.

-Të gjitha angazhimet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i institucionit.

-Për periudhën objekt auditimi në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe Kap. III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësia nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre.

- Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, pika 2 dhe 8. bdhe neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, germa “ç”, njësia nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).

-Në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap.II, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut”, nuk ka të përcaktuar koordinatorin e riskut, njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut.

-Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në Rregullore janë përcaktuar detyrat vetëm sipas drejtorive dhe linjat e raportimit, por nuk ka miratuar ndarje detyrash dhe përgjegjësi në nivel specialisti për të gjithë sektorët referuar strukturave të miratuara. Nuk ka përshkrime detyrash individuale, e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesa lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin nëpunës. Nuk ka vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që kryejnë ato. Nga Drejtori i SRGJ nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit.

-Në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, “Monitorimi”, institucioni nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Nuk ka informacion të vazhdueshëm për Titullarin për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

-Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve nuk janë trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës dhe vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë), paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”.

- Në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”, njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit, që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj.

-Të gjitha transaksionet e verifikuara me zgjedhje janë të dokumentuara dhe për dokumentimin e tyre veprohet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

SRGJ ka patur rregullore të brendshme deri në vitin 2008, pa shkresë përkatëse se kur ka hyrë në institucion dhe aktualisht funksionon me rregulloren e miratuar me shkresën nr.4884, datë 31.12.2008 të Ministrisë së Shëndetësisë. Në rregulloren e mëparëshme si dhe rregulloren e re konstatohet se Drejtuesit e SRGJ (sipas periudhave që kanë drejtuar), nuk kanë ndërmarrë hapa për futjen dhe implementimin në Rregullore të ligjit nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011, të Ministrit të Financave, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, për të përcaktuar qartë përgjegjësitë e nëpunësit autorizues dhe zbatues.

-Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit, brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit. Në SRGJ, shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike.

-Titullari informohet në mënyrë të vazhdueshme nga Drejtoria e Financës për gjendjen financiare në çdo kohë. Në bazë të këtij informacioni menaxheri i institucionit shtron domosdoshmërinë e realizimit të prioriteteve që ka institucioni.

-Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

- 6) Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,
- 7) Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.
- 8) Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V “Shtojcat”, Shtojca 2.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- 19) Z. R.K me detyrë, ish-Drejtor i SRGJ, në cilësinë e nëpunësit autorizues.
- 20) Z. A.M me detyrë Drejtor i SRGJ në cilësinë e nëpunësit autorizues



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

- 21) Z. K.K me detyrë, ish-Drejtor i SRGJ, në cilësinë e nëpunësit autorizues
 - 22) Z. P.M me detyrë, ish-Drejtor i SRGJ, në cilësinë e nëpunësit autorizues
 - 23) Z.A.B, me detyrë, ish zv/drejtor ekonomik i SRGJ në cilësinë e nëpunësit zbatues.
- Znj.D.T, me detyrë, përgjegjëse e sektorit të financës së SRGJ në cilësinë e nëpunësit zbatues.

IX.Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

-Kontratat e lidhura me subjektet private për vitin 2015, nuk kanë Stemën e “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse , në kundërshtim me “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, kapitulli II-B, “Përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve”, neni 12, dalë në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, në të cilin është përcaktuar se: *“Dokumentet që dalin nga organi shtetëror duhet të kenë: Stemën e Republikës, intestimin “Republika e Shqipërisë”, emërtimin e organit shtetëror dhe strukturës përkatëse (nëse ka të tillë), numrin e regjistrit të korrespondencës (Mod. 1), vendin dhe datën, shkurtimin e lëndës, adresën e korrespondentit, formulën “në përgjigje” ose “vijim të shkresës” (kur është rasti), numrin e lidhjeve (kur ka), tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, si dhe vulën. Data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga titullari. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sekretari apo sekretari-arkiv siglohet edhe nga përpiluesi dhe përgjegjësi i sektorit. Në të shënohet edhe sasia e ekzemplarëve të shtypur.*

-Nuk ka autorizim nga Drejtori i Spitalit për monitorimin e kontratave me qira nga stafi apo nëpunësi zbatues. Kjo bie në kundërshtim me **Vendimin nr. 54**, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” monitorimi i kontratës.

-Ish-Drejtorët e spitalit kanë bërë të mundur lidhjen e kontratave me 2 subjekte private për vitet 2015-2017 me sipërfaqe deri në 200 m² për afat kohor 1 vjeçar

-Në të dyja dosje nuk gjendet propozimi për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri, vendimi i organit drejtues të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore (këshilli administrativ) dhe miratimi i ministrisë së linjës. Ky veprim është në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika a) *“Propozimin për dhënien me qira ose emfiteozë të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri”.*

-Në asnjë dosje nuk gjendet procesverbali ku të përfshihet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël e objektit që jepet me qira, sipas llogarive financiare të vitit paraardhës, apo pamje fotografike të momentit, në kundërshtim me Vendimin nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika VI “Monitorimi i kontratave”, pika 2 ku përcaktohet: “Njësia monitoruese e kontratave të qirasë ose të emfiteozës kryen këto detyra: *“Pas lidhjes së kontratës së qirasë ose të emfiteozës, bën dorëzimin te qiramarrësi ose emfiteozëmarrësi me procesverbal të objektit të përshkruar në kontratë, sipas gentplanit përkatës. Në procesverbal përshkruhet qartë gjendja fizike e pronës,*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

vlera kontabël e objektit që jepet me qira ose emfiteozë, sipas llogarive financiare në fund të vitit paraardhës dhe shoqërohet me pamje fotografike të momentit”. Titullari i institucionit apo ndonjë i ngarkuar prej tij është përgjegjëse për zbatimin e kontratave sipas procedurave standarde për dhënien me qira konform legjislacionit.

-Spitali Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë deri më 29.06.2018, nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të aseteve në Z.V.R.P.P përkatëse.

Nisur nga fakti se në këtë spital edhe pse në nivel qarku nuk është ngritur akoma Këshilli administrativ sipas rregullores dhe ligjeve në fuqi dhe struktura organizative dhe drejtuese më e lartë e spitalit është drejtoria, vihet re një menaxhim në nivele të ulta drejtuese të këtij spitali pasi; nga prona truall që ky spital administron që në ndërtimin e tij dhe referuar planimetris së vitit 1981 nga 31,190 m² truall sot në administrim të spitalit janë vetëm 27,325 m² ose 3,865 m² më pak, sipërfaqe këto të zhveshura nga ana jugore dhe veriore e pronës pa një datë të caktuar. Referuar cmimit të trojeve në Republikën e Shqipërisë miratuar me VKM nr.89 datë 03.02.2016 për qytetin e Gjirokastrës zona kadastrale nr. 8541 ka një cmim prej 4865 lekë/m² x 3,865 m² = **18,803,225 lekë vlerë e zhveshur nga asetet e spitalit** .

Për periudhën objekt auditimi janë lidhur 2 kontrata qiraje për objekte, të trashëguara ndër vite kontrata mes Spitalit Rajonal Omer Nishani dhe z.A.Zs për një objekt në hyrje të spitalit me sipërfaqe 37.5 m² dhe një çmim prej 17,437 lekë muaj dhe kontrata me z. A.Sh për një objekt në brendësi të spitalit me sipërfaqe prej 42 m² objekt dhe 120 m² sipërfaqe funksionale me një çmim prej 10,320 lekë në muaj. Në lidhjen e kontratave mes të interesuarve dhe spitalit duke mbajtur dy standarde në çmimin për m² të qirasë mbajnë përgjegjësi ish-drejtorët A.M dhe K.K.

-Në lidhje me këtë problem ka ardhur dhe ankesa nr. 601 datë 17.05.2018 pranë institucionit të Kontrollit të Lartë të Shteti nga subjekti S Z, për kontratën e qirasë mes Spitalit dhe Subjektit. Gjithashtu nga ana e subjektit është kërkuar privatizimi i këtij ambjeti duke qenë se ndodhet në kufijte e pronës në rrethim të Spitalit si dhe nga mirmbajtja e përvithsme pasi e administron me qira prej 1992.

Nga ana e grupit të auditimit janë marrë 3 takime me palën e interesuar dhe e cila ka hartuar këtë ankesë, nga ana e spitalit sipas deklarimeve të S Z nuk ka ndonjë pengesë për privatizimin e këtij objekti e kanë marrë miratimin si dhe miratimin nga ministria e Shëndetësisë në 2015 por problematika mbet tek drejtoria rajonale e shëndet e cila nuk përcjell dosjen për në ministrin e ekonomisë, drejtoria e privatizimit të pronave shtetërore.

Për sa i përket qirasë nga ana e spitalit me këtë subjekt është lidhur një kontratë me cmim dukshë më të lartë se çmimi sipas VKM 54 dhe cmimit mesatarë për m² në këtë qytet.

Nga auditimi i kontratave të lidhura dhe procedurave për dhënien me qira ose emfiteozë të pasurive shtetërore nga SRGJ, për periudhën e auditimit, rezultoi si më poshtë:

Gjatë vitit 2015 rezultoi se:

-Kontratë qiraja pa numër, datë 17.11.2015, lidhur me shoqatën Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave.Mungon kërkesa për vitin 2015 e këtij Inspektorati drejtuar Hekurudha Shqiptare Sh.A.

Viti 2015

-Kontratë qiraja pa numër, 60/1 prot datë 02.03.2015, lidhur me personin fizik A.Sh dhe drejtorit të spitalit A.M. Objekti i marrë me qira me sipërfaqe 42 m² dhe sipërfaqe funksionale 120 m² me çmim 160 lek/m² objekti dhe 30 lek/m² sipërfaqja funksionale në total 10,320 lekë në muaj qira.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Kontratë qiraja pa numër, 45/1 prot datë 14.02.2015, lidhur me personin fizik A.Z dhe drejtorit të spitalit A.M. Objekti i marrë me qira me sipërfaqe 37.5 m² me çmim 400 lek/m² objekti në total 15,500 lekë në muaj qira. Me aktivitet mallra të ndryshëm dhe fruta perime funksionale edhe sot. *Për lidhjen e kontratës së qirasë 45/1 prot. me çmim dukshëm me të lartë se çmimim sipas VKM 54 që për qytetin e gjirokastrës është 75 lek/m² dhe më të lartë se objekti tjetër i dhën me qira duke e diskriminuar këtë subjekt ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin A.M.*

Viti 2016

-Kontratë qiraja pa numër, 120/1 prot datë 02.03.2016, lidhur me personin fizik A.Sh dhe drejtorit të spitalit K.K. Objekti i marrë me qira me sipërfaqe 42 m² dhe sipërfaqe funksionale 120 m² me çmim 160 lek/m² objekti dhe 30 lek/m² sipërfaqja funksionale në total 10,320 lekë në muaj qira.

-Kontratë qiraja pa numër, 294 prot datë 02.06.2016, lidhur me personin fizik A.Z dhe drejtorit të spitalit K.K. Objekti i marrë me qira me sipërfaqe 37.5 m² me çmim 465 lek/m² objekti në total 17,437.5 lekë në muaj qira. Me aktivitet mallra të ndryshëm dhe fruta perime funksionale edhe sot. *Për lidhjen e kontratës së qirasë 294 prot. me çmim dukshëm me të lartë se çmimim sipas VKM 54 që për qytetin e gjirokastrës është 75 lek/m² dhe më të lartë se objekti tjetër i dhën me qira nuk mjaftoi kjo por nga a na e drejtorit K.K pa asnjë shpjegim apo arsyetim ekonomik financiarë i rritet çmimi me 65 lek/m² këtij subjekti duke e trajtuar në mënyrë të diskriminuar këtë subjekt ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin K.K.*

Viti 2017

-Kontratë qiraja pa numër, 100 prot datë 01.03.2017, lidhur me personin fizik A.Sh dhe drejtorit të spitalit K.K. Objekti i marrë me qira me sipërfaqe 42 m² dhe sipërfaqe funksionale 120 m² me çmim 160 lek/m² objekti dhe 30 lek/m² sipërfaqja funksionale në total 10,320 lekë në muaj qira.

-Kontratë qiraja pa numër, 85 prot datë 15.02.2017, lidhur me personin fizik A.Z dhe drejtorit të spitalit K.K. Objekti i marrë me qira me sipërfaqe 37.5 m² me çmim 400 lek/m² objekti në total 15,500 lekë në muaj qira. Me aktivitet mallra të ndryshëm dhe fruta perime funksionale edhe sot.

Për lidhjen e kontratës së qirasë 85 prot. me çmim dukshëm me të lartë se çmimim sipas VKM 54 që për qytetin e gjirokastrës është 75 lek/m² dhe më të lartë se objekti tjetër i dhën me qira duke e diskriminuar këtë subjekt ngarkon me përgjegjësi ish drejtorin K.K.

-Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e kontratave të qirasë për periudhën objekt auditimi rezultoi se: Spitali Rajonal Omer Nishani dhe subjektet që kanë lidhur kontratë qiraje të mos kenë detyrime mes palëve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

z. A.M, në cilësinë e Ish-Drejtorit për vitin 2015

z. K.K, në cilësinë e Ish-Drejtorit për vitin 2016-2017

X.Verifikim në spitalet e varësisë, nëse hasen problematika gjatë auditimit në Spitalin Rajonal Gjirokastrë.

Gjirokastra si qytet është qendra më të rëndësishme administrative, kulturore dhe ekonomike e rajonit jugor të Shqipërisë. Qyteti i Gjirokastrës është qendër e bashkisë, rrethit, qarkut dhe prefekturës me të njëjtin emër. Në këtë qytet funksionojnë disa institucione, agjensi dhe drejtori rajonale, si spitali rajonal “Omer Nishani”, i cili mbulon me shërbime të specializuara të gjitha spitalet e zonës së Përmetit, Tepelenës dhe Libohovës. Nisur nga fakti se ky spital ka dhe mjek më të specializuar dhe shërbim më të plotë ai mbulon një fluks shumë të madh urgjencash të zonave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

përreth. Spitali Rajonal “Omer Nishani” është i pajisur me 9 Autoambulanca për ofrimin e shërbimit të urgjencës.

Nga të dhënat e zyrës së statistikave u kosntatua se për periudhë objekt auditimit ky spital ka mbuluar me shërbim 7,699 pacient të pa siguruar dhe 436 pacient të siguruar nga qytet e tjera për periudhën objekt auditimi. Nuk ka ndonjë marveshje të shkruar për ofrimin e këtyre shërbi,eve por çdo rast paliativ apo në gjëndje të rëndë drejtohet në këtë spital për marrjen e një shërbimi më të specializuar.

EMERTIMI	VITI 2015		VITI 2016		Viti 2017	
	Pa sigurim	Me sigurim	Pa sigurim	Me sigurim	Pa sigurim	Me sigurim
	Ngaketa: JashteRrethi	Ngaketa: JashteRrethi	Ngaketa: JashteRrethi	Ngaketa: JashteRrethi	Ngaketa: JashteRrethi	Ngaketa: JashteRrethi
2					6	10
<i>Vizita/Konsulta</i>	883	110	1390	58	1781	16
<i>MjekimedheIntervente</i>	90	0	629	0	406	0
<i>Tetrajtuar me karteleditore</i>	788	95	839	96	893	61
TOTALI	1761	205	2858	154	3080	77

Sic vihet re dhe nga të dhënat statistikore ky Spital pret dhe ofron shërbim për një numër shumë të madh pacintësh nga rrethet e tjera.

XI. Të ndryshme të rezultuara nga auditimi

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

-Planifikimi për blerje barna e materiale mjekimi nga ana e Spitalit omer Nishan i Gjirokastrë Kryhet pa bërë njëmirstudim tënevojës për këto barna e medikamente duke mos analizaur konsumin mesatarë vjetor dhe duke mos llogaritur kushtet e ruajtjes ne depon (farmacinë) e Spitalit e cila është në kushte jo të mira. Për këtë problem ka dhe një kërkesë tëish përgjegjësës së Farmacisë M.Z drejtuar ish-drejtorit të spitalit K.K me nr. 50 datë 28.01.2016 me lëndë: Njoftim për kushtet e farmacisë dhe mungesat e barnave dhe materialeve mjeksore.

Ndër të tjera në këtë shkresë citohet: Edhe pse të gjitha grupet e auditimit e lënë si detyrë përmirësimin e kushteve të farmacisë, vazhdon e njëjta situatë. Farmacia jasht çdo kushti kryesorë për ruajtjen e medikamenteve pa diskutuar për dëmtimin në shëdetin e personelit që punon.

Në kushtet e një planifikimi të fryrë dhe pranimi të medikamenteve me një afat skadence shumë të vogë trajtuar në aktkostatimet për blerje medikamentesh e materiale mjekimi, si dhe në kushtet e farmacisë të përmendura dhe nga M.Z, e cila është dhe anëtare e komisionit të pranimit të medikamenteve nuk mundet që këto medikamete mos të skadojnë pa u përdorur fare.

Edhe ato fonde që përdoren për blerje medikamentesh një pjesë e tyre ezaurohet duke skaduar.

-Gjatë auditimi të Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë grupi i auditimit verifikoi dhe Farmacinë apo magazinën mjekësore nisur nga planifikimi jo i saktë i konstatuar gjatë fazës së auditimit të procedurave të prokurimit të medikamente dhe materialeve mjeksore u konstatua se:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Për periudhën objekt auditimi nga blerja e medikamenteve, materiale mjeksore dhe Kite Reagente të pa planifikuar mire pa marrë gjëndjen e Farmacisë apo pa llogaritur konsumin mesatarë ndër vite dhe mbi të gjitha pranimi i mallrave jo në përputhje me kontratën por me një afat skadence shumë të afërt u konstatuan barna të skaduar në **vlerën prej 2,648,765 lekë e cila përbën efekt financiarë negativ për institucionin**. Gjithashtu në ruajtje janë barna me rrezikshmëri të lartë të cilat futen në familjen e Helmevesi Antropine, Morfinë, Pancuranium etj të skaduar në një vlerë prej 245,041 lekë nga të cilat 40,987 janë për vitet 2015-2017.

Për vitin 2015 në këtë spital kanë skaduar dhe janë asgjesuar **825,649 lekë medikamete të cilat përbëjnë efekt financiarë negativ për buxhetin e shtetit dhe ngarkojnë me përgjegjësi ish drejtorin A.M, si dhe përgjegjësinë e zyrës së planit**.

NR REN	FLETE DALJA NR	DATE	VLEFTE
1	7	6/2/2015	91859.68
2	22	8/5/2015	387212.3
3	23	8/5/2018	20170.71
4	45	30/9/2015	141015.82
5	50	11/11/2015	108638.04
6	53	11/12/2015	76752.94
	SHUMA		825,649.49

Për vitet 2016-2017 në këtë spital kanë skaduar dhe janë asgjesuar **1,823,115 lekë medikamete të cilat përbëjnë efekt financiarë negativ për buxhetin e shtetit dhe ngarkojnë me përgjegjësi ish drejtorin K.K, përgjegjësinë e zyrës së planit F.F si dhe M.Z e R.K.**

-Ne lidhje me observacionin nr. 440/32 datë 4.07.2018 të dërguar nga M.Z për sa i përket akt konstatimit nr. 11, merret pjesërshiti në konsideratë, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion: Shkresa nr. 106 prot datë 17.02.2016 hartuar nga M.Z për dijeni N/Drejtori A.B, me lëndë “Për qarkullimin e barnave me skadencë të afërt”

Shkresa nr. 308 prot datë 13.06.2016 hartuar nga M.Z për dijeni Drejtori K.K dhe shefit të planit, me lëndë “...farmacia ka barna dhe kite laboratorit me skadencë të afërt dhe më tepër se konsumi...”

Si dhe të gjitha korespondencat me email të dërguara për spitalet e tjera gjëndjen dhe shkëmbimin e medikamenteve sipas urdhrave të MInsitrisë së Shendetësisë.

Ne lidhje me observacionin nr. 442/4 datë 9.07.2018 të dërguar nga R.K për sa i përket akt konstatimit nr. 11, merret pjesërshiti në konsideratë, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion: Shkresa nr. 42 prot datë 25.01.2017 hartuar nga M.Z për dijeni Drejtori K.K, me lëndë “Barna dhe materiale mjekimi me qarkullim të ngadalshëm dhe stok”

Shkresa nr. 53 prot datë 31.01.2017 hartuar nga M.Z për dijeni Drejtori K.K, me lëndë “Barna dhe materiale mjekimi me skadencë të afërt”

Shkresa nr. 105 prot datë 10.03.2017 hartuar nga R.K për dijeni Drejtori K.K, me lëndë “Njoftim për qarkullim barnash me skadencë të afërt dhe stok”

Shkresa nr. 271 prot datë 07.07.2017 hartuar nga R.K për dijeni Drejtori P.M, me lëndë “Njoftim për barana, materiale mjekimi dhe kite laboratorit me skadencë të afërt dhe stok”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Shkresa nr. 443 prot datë 10.11.2017 hartuar nga R.K me objekt: Të shifet mundësia e qarkullimit në spitalet e tjera të barnave, kite dhe materiale mjekimit sipas listës bashkangjitur.

Konkluzionet dhe Rekomandimet

A. MASA ORGANIZATIVE

1. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i ushtruar mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre është konstatuar se:

-Nuk është ngritur Këshilli Administrativ dhe Këshilli Tekniko-Administrativ në kundërshtim me rregulloren nr. 4884 prot., datë 31.12.2008 “Për disa ndryshime në rregulloren e shërbimit të kujdesit shëndetësor dytësor (spitalor) dhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”.

-Mos-ngritja e kësaj strukture ndikon në uljen e besueshmërisë dhe saktësisë së zbatimit të politikave të Ministrisë së Shëndetësisë në Spital duke krijuar problematika në zbatimin e pesë komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në kundërshtim me nenet 19-24 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Nuk analizohen pasqyrat financiare duke rritur riskun e devijimeve të cilat janë materiale nga ana cilësore dhe sasiore, nuk analizohet buxheti duke rritur riskun e ndryshimit të destinacionit të shpenzimeve buxhetore dhe nuk jepen opinione për domosdoshmërinë e investimeve të kryera ndër vite në spital. Mungesa e Këshillit K dobësi në sistemin e kontrollit të brendshëm në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-Të gjitha funksionet që duhet të kryeshin nga Këshilli Administrativ kryhen nga Drejtori i Spitalit. Mungesa e Këshillit ka sjellë efekte në mos-përmbushjen e plotë të detyrave të drejtorit ekzekutiv në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 19.

-Nuk është ngritur gjithashtu Komiteti për planifikimin spitalor publik të qarkut në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, neni 40. Mungesa e Komitetit për planifikimin spitalor ka sjellë mangësi në hartimin dhe raportimin e planit spitalor në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Kreu V, Neni 42, Pika 2,3,5 dhe efektet janë pasqyruar në rastin e rikonstruksionit të spitalit si dhe në blerjen e pajisjeve.

Rekomandimi: 1.1 Nga Drejtoria e Spitalit, të merren masa për të ngritur Këshillin Administrativ, Tekniko-Administrativ dhe Komitetin për planifikimin spitalor të qarkut duke krijuar një sistem të mirëfilltë për monitorimin e vazhdueshëm tekniko-administrativo spitalor, duke evidentuar problematika, përgjegjësi dhe rekomandime me afate konkrete

1.2 Këshilli Administrativ, Tekniko-Administrativ dhe Komiteti për planifikimin spitalor të zbatojë detyrat sipas rregullores dhe referencës ligjore ose të përcaktohen detyra të reja të cilat duhet të jenë në kompetencë konsultative dhe vendimmarrëse.

Menjëherë

2. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i sistemeve kontabël rezulton se të gjitha regjistrimet kontabile, shpenzimet e kryera etj., mbahen, përpunohen dhe ruhen në programin excel pasi institucioni nuk ka të instaluar program financiar për krijimin e një kuadri të nevojshëm ligjor për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

njohjen dhe përdorimin e dokumenteve elektronikë, ruajtjen dhe sigurinë e informacionit të tij duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar.

Rekomandimi: 2.1 Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë të merren masat e duhura për pajisjen me sistem të informatizuar financiar për mbajtjen e kontabilitetit, për të ruajtur dhe garantuar këtë informacion, si dhe shmangur gabimet dhe humbjen e të dhënave.

Deri më 31.12.2018

3. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurave të inventarizimit për periudhën objekt auditimi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se:

-Regjistri aktual kontabël i aktiveve referuar kartelave të tyre nuk i plotëson kërkesat e nenit 30 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Komisioni i Inventarizimit për vitet 2015-2017 nuk ka përcaktuar personat përgjegjës për cilësinë dhe kushtet e ruajtjes së aktiveve, arsyet e gjendjes së tyre, si dhe për dëmtimet e konstatuara dhe shkaqet e tyre, në kundërshtim me nenin 85 germa c, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

-Nga drejtuesit e SRGJ dhe nëpunësi zbatues për secilën periudhë nuk janë marrë masat e duhura për kryerjen e procedurave të inventarit që duhet të kryhet në fund të vitit për të gjitha aktivet që ka në dispozicion SRGJ, gjithashtu nga nëpunësi zbatues nuk është marrë asnjë iniciativë për hartimin e të gjitha regjistrave kontabël në dispozicion, kryerjen e inventarit ekonomik dhe vlerësimit të të gjitha aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale, aktivet afatshkurtra dhe detyrimeve dhe të drejtave, veprime në kundërshtim të Ligjit Nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu III pikat 26-30, dhe kreu IV, pika 74.

-Nuk është kryer asnjëherë inventar fizik i aktiveve (Tokë-truall, Ndërtesa), të cilat ndodhen në kontabilitetin e SRGJ pasi nuk disponohet dokumentacion ligjor, nuk është marrë asnjë iniciativë për të kryer regjistrimin në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë, si rrjedhojë nuk mund të gjykohej nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme, e posedueshme dhe e përdorshme nga institucioni pra nuk verifikohet ekzistenca dhe dokumentacioni mbështetës i tyre, *veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, me Ligjin Nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74.*

Rekomandimi: 3.1 Nga Drejtori i Spitalit, Sektori i Financës dhe juristi i SRGJ, të merren të gjitha masat e nevojshme për identifikimin, inventarizimin fizik dhe regjistrimin e asetëve në ZVRPP Gjirokastrë, dhe pajisjen me certifikata pronësie. Nga nëpunësi zbatues të merren masat e duhura për hartimin e regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve, në përputhje me kërkesat e Legjislacionit në fuqi.

Deri më 31.12.2018

4. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2015, u konstatua se në pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve të qëndrueshme të bilancit të vitit 2015, është kryer pakësim në zërin Instalime teknike, makineri, pajisje dhe vegla pune në shumën 42,241,453 lekë, për një pajisje e cila duhet të regjistrohej në vlerën 436,782.36 lekë. Ky artikull është regjistruar në bilancin e vitit 2012 në vlerën 43,678,236 lekë. Në vitin 2015 është konstatuar nga përgjegjësja e sektorit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

financës se ky artikull është regjistruar jo sipas vlerës reale në pasqyrat financiare të SRGJ dhe janë kryer sistemimet kontabël në formatin nr. 6, të pasqyrave financiare. Ky aktiv është pakësuar në vlerën 42,241,453 lekë, ndërkohë që duhet të pakësohej me vlerën 43,241,453 lekë pra është pakësuar në shumën 1,000,000 lekë. *Këto veprime kanë sjellë një mosparaqitje të saktë dhe me besueshmëri të të dhënave financiare të institucionit të SRGJ, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe me Planin e Përgjithshëm Kontabël të Institucioneve Buxhetore në Republikën e Shqipërisë.*

-Gjithashtu për vitet 2015-2017, konstatohet se, relacioni dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare paraqitet i thjeshtë, me informacion të përgjithshëm, ku mungojnë sqarime të nevojshme për ecurinë e zërave të pasqyrave financiare. Mungojnë tërësisht shpjegimet dhe analiza e pasqyrës së flukseve monetare, *veprime në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 1 “Kuatridhe i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare”, pika 67, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 26.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaja”, dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik SNKP 1, paragrafi 128.*

Rekomandimi: 4.1 Nga Sektori i financës të kryhen veprimet e duhura për sistemimin e zërit kontabël në aktivet afatgjata të qëndrueshme, të pasqyrave financiare, duke pasqyruar vlerën reale të tij, sipas Planit të Përgjithshëm Kontabël të Institucioneve Buxhetore në Republikën e Shqipërisë.

4.2 Nga Drejtoria e SRGJ dhe Sektori i Financës, të merren masa që të pasqyrohen në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, informacioni i qartë dhe shpjegues rreth zërave materialë, për rritjen e kuptueshmërisë dhe transparencës së të dhënave.

Në vijimësi

5. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit rezultoi se gjatë vitit 2015 janë nxjerrë jashtë përdorimit aktive të imëta të cilat kanë përbërje material metalik, të cilat mund të vlerësoheshin dhe të nxirreshin në ankand për shitje skrap, *veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pikat 102 dhe 109.*

Rekomandimi: 5.1 Nga ana e Drejtorisë dhe Strukturave që ndjekin procesin e inventarizimit, të merren masa që në të ardhmen në rastet kur konstatohen materiale të cilat vlerësohen jashtë përdorimit dhe çmohen se mund të shiten për skrap, të vepohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për nxjerrjen në ankand të tyre.

Në vijimësi

6. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurave të inventarizimit në urdhrin e hartuar për krijimin e komisionit të inventarizimit, është vendosur z. A.Sh i cili ka qenë në pozicionin e auditit të brendshëm të Spitalit Rajonal Gjirokastër, *veprim ky i cili bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, neni 17, germa a).*
-Nga auditimi i procedurave të inventarizimit për vitin 2015 rezultoi se procedura e asgjësimit të disa materialeve me vlerë totale 829,779 lekë nuk është kryer e plotë dhe e saktë. Në relacionin për asgjësimin e materialeve mungojnë të dhëna për materialet të cilat do të dalin jashtë përdorimit dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

do të asgjësohen, nuk përcaktohet destinacioni final ku do të kryhet asgjësimi i tyre, gjithashtu nga titullari i SRGJ nuk ka asnjë autorizim për caktimin e z. A.B si nëpunës Autorizues për veprime të mëtejshme të procesit të inventarizimit. Në këtë relacion nuk përshkruhet asnjë argument dhe z. A.B nuk ka fuqi ligjore për vendimmarrje të tilla, të cilat janë kompetencë e titullarit të institucionit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Rekomandimi: 6.1 Drejtoria e SRGJ-së, të marrë masat e duhura që në të ardhmen, përbërja e anëtarëve të komisioneve të inventarizimit, të jetë sipas rregullave të përcaktuara në udhëzimet dhe aktet ligjore.

6.2 Nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë, sektori i financës, si dhe nga grupi i punës i cili ngrihet në çdo rast për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të merren masa për hartimin e detajuar të relacioneve me të dhëna të sakta informuese dhe justifikuese për plotësimin e kushteve tekniko-ekonomike.

Menjëherë

7. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i shpenzimeve për karburant u konstatua se në të gjitha rastet janë kryer pagesa për kontrata furnizimi me karburant pa kërkuar deklaratën doganore SAD të Operatorit Ekonomik kontraktues, mbi bazën e të cilit do të llogaritet çmimi për njësi i karburantit, rezulton se çmimi është vendosur bazuar në faturën me TVSH sipas furnizimit të shoqërisë, dhe buletinit të fundit sipas datës së faturës dhe kursit të këmbimit. Gjithashtu nga titullari i SRGJ, në asnjë rast nuk është ngritur komision për mbikëqyrjen e kontratës, *veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IX, neni 77, pika 5 dhe 6.*

Rekomandimi: 7.1 Të merren masat e duhura për kontratat e furnizimit me karburant që do të lidhen në vazhdim, që në hartimin e tyre të kërkohet nga OE fitues paraqitja e Deklaratës Doganore SAD në momentin e furnizimit dhe hyrjes së tij në pikën doganore, për përmbushjen e detyrimeve dhe llogaritjen e saktë të vlerës së faturës, gjithashtu nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe nënshkruesi i urdhër shpenzimit të kërkohet për çdo faturë ky dokument në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7.2 Nga titullari i SRGJ të merren masat e duhura për kontratat që do të lidhen, të krijohet komisioni posaçëm për mbikëqyrjen e kontratave, duke hartuar relacionet përkatëse për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Menjëherë dhe në vazhdim.

8.-Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me mbajtjen dhe dokumentimin e shpenzimeve të automjeteve, konsumit të karburantit, shpenzimeve për goma, bateri, servise etj., rezultoi se nga Dega Teknike nuk janë plotësuar kartelat përkatëse për çdo mjet, ku të jenë të evidentuara të dhënat teknike të mjetit, defektet e konstatuara, shërbimet e kryera periodike etj. Gjithashtu për automjetet nuk është evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj., shpenzime të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, si dhe për reflektimin e gjurmës standarde të auditimit. Këto veprime janë në kundërshtim me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2012, “Menaxhimi i aktiveve të njësitë e sektorit publik”, pikat 19, 26, 35, 121, 122.

Rekomandimi: 8.1 Drejtoria e SRGJ-së, zv/Drejtori Ekonomik, Dega e Financës, Dega Teknike të marrin masat që në të ardhmen, të mos përsëriten shkeljet e konstatuara në këtë material auditimi, të merren masat për kontrole të vazhdueshme në lidhje me mbajtjen e dokumentacionit të duhur për shpenzimet e kryera për automjetet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i shpenzimeve të SRGJ për automjetet që ka në dispozicion rezulton se, për automjetin me targë AA 366 EJ, referuar lejes së qarkullimit, nuk janë paguar detyrimet e taksave dhe kontrollit fizik për vitet 2016-2018, veprime për të cilat sistemi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastër do të gjenerojë gjoba, *veprime kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.*

Rekomandimi: 9.1 Nga Drejtoria e SRGJ, Dega e financës dhe Dega teknike të merren masat për likuidimin e detyrimeve që ka automjeti i mësipërm, të nxirren përgjegjësitë për shkeljet e konstatuara në këtë material auditimi, dhe nëse do të ketë penalitete t’u vihen në ngarkim personave përgjegjës. Gjithashtu të merren masat në vijim për pajisjen me dokumentacionin e duhur të automjeteve, për vazhdimin normal të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. -Gjetje nga auditimi:- Në Spitalin Rajonal Gjirokastër ka një mangësi të theksuar të njohjes së Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pasi ky Ligj nuk është vënë në funksionim, dhe për pasojë nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë ku drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

-Nga SRGJ nuk janë përcaktuar procedura të brendshme të anti-korrupsionit dhe të sinjalizimit të parregullsive. Për vitet 2015-2017, nuk është hartuar dhe dërguar në Ministri deklarata dhe raporti vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, gjithashtu nuk ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësozin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së.

-Nuk është hartuar dhe miratuar planin i cili përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit. Nuk ka të miratuar një plan afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit të të gjithë niveleve të institucionit. Për rrjedhojë në SRGJ nuk ka një Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo, udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, për kryerjen e shpenzimeve dhe funksioneve të ndryshme të shoqërisë si dhe rregulla për delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre: Nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe regjistrin e riskut, e për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut:

Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Rekomandimi: 10.1 Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë, të marrë masa që në vazhdimësi, të kryhet procesi i implementimit në Rregulloren e Brendshme të SRGJ, të informohet stafi drejtues mbi ligjin e MFK dhe komponentëve të tij, të kryhet hartimi i një plan-veprimi, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së, përfshirë menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik, gjithashtu të përcaktohen misioni, strategjia dhe objektivat, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre.

Menjëherë dhe vijimësi

11. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël, rezultoi se:

-Për vitin 2016 janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat normale të prokurimit, në shumën totale 1,124,140 lekë pa TVSH, procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim, dhe konkretisht është kryer procedura “Blerje karburant”, në muajin mars 2016 me fond limit në shumën 465,440 lekë pa TVSH, dhe procedura “Blerje karburant”, me fond limit në shumën 658,700 lekë pa TVSH në muajin nëntor 2016.

-Për vitin 2017 janë kryer 4 procedura blerje me vlera të vogla duke copëzuar fondin dhe duke anashkaluar procedurat normale të prokurimit, pra procedura të cilat duhet të kryheshin tenderim. Nga këto, 2 procedura me vlerë të vogël me objekt “Blerje karburanti” **në shumën totale 1,550,000 lekë pa TVSH**, dhe konkretisht është kryer procedura “Blerje karburant në muajin shkurt 2017”, me fond limit në shumën 800,000 lekë, dhe procedura “Blerje karburant”, me fond limit në shumën 750,000 lekë në muajin prill 2017. Gjithashtu janë kryer 2 procedura me objekt “Roje private” **në shumën totale 1,483,257 lekë pa TVSH**, konkretisht procedura me objekt “Roje private” me fond limit në shumën 733,099 lekë e zhvilluar në muajin shkurt 2017, dhe procedura me objekt “Roje private”, me fond limit në shumën 750,158 lekë, procedura të cilat duhet të kryheshin me procedurë normale prokurimi.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, neni 40, pika 1.

Rekomandimi: 11.1 Drejtoria e SRGJ dhe Sektori i prokurimeve, të merren masa, për të mos përsëritur shkeljet e konstatuara në këtë material auditimi dhe të nxirren përgjegjësitë për copëzimin e fondeve për blerjet e sipërcituara.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurave të prokurimit, lidhjes dhe zbatimit të kontratave me objekt “Riparim dhe Mirëmbajtje e automjeteve” në vitin 2015 me fond limit 1,249,992 lekë pa TVSH, në vitin 2016 me fond limit 1,083,333 lekë pa TVSH dhe vitin 2017, me fond limit 1,249,950 lekë pa TVSH mes SRGHJ dhe fituesit të vetëm pjesëmarrës OE “A” shpk. u konstatua se:

-Titullari i AK-së, nuk ka kërkesë nga sektori përkatës për fillimin e procedurës, nuk është argumentuar nevoja për kryerjen e prokurimit si dhe nuk është argumentuar zgjedhja e llojit të procedurës.

-Preventivi i punimeve të nevojave të automjeteve, nuk është i mbështetur në procesverbale konstatimi të defekteve që kanë automjetet, por është hartuar një preventiv nga përgjegjësi i Degës Teknike, të cilin e ka të paargumentuar teknikisht.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

-Ftesa për ofertë nuk u është dërguar të paktën 5 OE të cilët të kenë në fushën e veprimtarisë së tyre objektin e prokurimit, duke ngushtuar konkurrencën, siç duket qartë edhe nga pjesëmarrja e ofertave të dhëna në të cilën ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, gjithashtu janë vendosur kritere diskriminuese në Dokumentet Standarde të Tenderit të cilat nuk lidhen ngushtë me preventivin e punimeve të cilat do tu bëhen automjeteve.

-Nga titullari i institucionit nuk është ngritur komision për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratave. *Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu II, neni 12, nenin 1, pika 2, nenin 2, dhe nenin 46, pika 3, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, seksioni II, neni 28, nenin 39, pika 4 paragrafi II-të, kreu VII, neni 61, pika 2, paragrafi II-të, nenin 77, dhe me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.*

Rekomandimi: 12.1 Nga titullari i Autoritetit Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit të SRGJ në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit për “Riparinin dhe mirëmbajtjen e automjeteve”, të parashikohen nevojat për prokurim të tyre, duke vepruar në përputhje me kërkesat ligjore për hartimin e preventivave, llogaritjen e fondit limit dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të veçanta në DST, që të bëjë të mundur një pjesëmarrje të gjerë duke patur parasysh një vlerësim objektiv dhe jo diskriminues për operatorët pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe me leverdi ekonomike për fondet buxhetore duke krijuar kushtet për pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik në këto procedura.

12.2 Nga Dega Teknike të monitorohet situata reale e nevojave për riparinin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, duke mbajtur procesverbale me argumentimet përkatëse të kërkesave të tyre.

12.3 Nga titullari i SRGJ të merren masat e duhura për kontratat që do të lidhen, të krijohet komisioni posaçëm për mbikëqyrje dhe zbatim, duke hartuar raportet përkatës për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

Menjëherë dhe në vijim

14. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi mbi hartimin dhe planifikimin e projektbuxhetin për vitet 2015-2016 rezulton se nga grupi i punës të SRGJ nuk është analizuar dhe detajuar në mënyrë të hollësishme përllogaritja në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime mbështetur në kërkesën e MSH. Në relacion nuk është përshkruar gjendja e detyrimeve të pa likuiduara në fillim të vitit, ecuria e shlyerjes së tyre si dhe nuk është përshkruar planifikimi i të ardhurave dytësore të SRGJ. Lidhur me shpenzimet e rritura ndjeshëm për “barna dhe materiale mjekësore” në tre vitet e fundit nuk është bërë asnjë detajim ose analizë në hartimin e PB. Në disa zëra të llogarive buxhetore konstatohet angazhim më i madh gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar. Në disa zëra të llogarive buxhetore konstatohet angazhim më i ulët gjatë vitit në krahasim me planifikimin fillestar si pasojë e tjetërsimit të destinacionit të fondit buxhetor. Në të dyja rastet, situata tregon një planifikim jo të saktë në fillim të vitit dhe shpenzimin më të madh në këto grup llogarish në krahasim me llogari të tjera pavarësisht ruajtjes në total të limitit për angazhim buxhetor.

Rekomandimi: 14.1 Nga strukturat drejtuese të SRGJ të merren masa që Raportet e Monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajnë një informacionin të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planit të produkteve, si në sasi dhe në vlerë në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit të shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

14.2 Nga ana e SRGJ të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve brenda artikujve buxhetorë.

14.3 Nga strukturat drejtuese të SRGJ të merren masa që strukturat që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të eliminojnë planifikimet formale, dhe të kryejnë parashikime të besueshme, duke kryer analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të buxhetit referuar udhëzime përkatëse për këtë qëllim, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme në buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Në çdo rast të hartimit të PBA

15. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave janë konstatuar disa raste të personave të punësuar, ku për procedurën e marrjes në punë nuk figuron miratimi i Ministrit në kundërshtim me Urdhrin Nr. 506 datë 18.09.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë, “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve dhe dhënien me qira të ambienteve dhe hapësirave, në institucionet shëndetësore” ku punësimi është kryer sipas urdhrave të brendshme.

-Nga auditimi u konstatuan devijime dhe tejkallim të strukturës pa miratim nga Ministria e linjës por vetëm me urdhër të titullarëve për administratën, sektorin e teknikës, hotelerisë dhe mjedisit.

-Rregullorja me të cilën ka funksionuar Spitali Rajonal i Gjirokastrës është e papërshtatur me ndryshimet e bëra në strukturë gjatë viteve të fundit duke krijuar pengesë në mirëfunksionimin administrativ të institucionit. Detyrat e secilit pozicion nuk janë të qarta duke qenë pengesë jo vetëm në procesin e administrimit por dhe të rekrutimit të stafit të ri në SRGJ.

-Nga auditimi i 20 dosjeve të personelit janë konstatuar mangësi në dokumentacion. Mangësitë më të hasura kanë qenë Cv, procedura e përzgjedhjes së aplikantëve dhe të emërimit në SRGJ si psh: kandidati fitues nuk plotëson kushtet e shpallura në njoftim, mungon shpallja e njoftimit për vende vakante dhe përcaktimi i kriterëve për disa raste, procesverali i vlerësimit me pikë i intervistës dhe kriterëve të vlerësimit.

Rekomandimi: 15.1 Nga strukturat drejtuese të SRGJ të merren masa për plotësimin e me stafin e nevojshëm mjekësore dhe jo plotësimin e numrit të strukturës me staf mbështetës, duke respektuar strukturën e miratuar nga Ministria e linjës.

15.2 Të merren masat nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për plotësimin me dokumentacion të dosjeve të personelit si dhe në çdo rast, të merren masa që marrja në punë e punonjësve të bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit dhe kriterëve të përcaktuara të vlerësimit në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, duke ndjekur etapat e duhura deri në shpalljen fitues të konkurrentit.

15.3 Nga titullari i SRGJ të merren masat për hartimin e një rregulloreje përshtatur me strukturën e re të miratuar në ndihmë të mirëfunksionimit administrativ të SRGJ.

Në vazhdimësi

16. -Gjetje nga auditimi:- Gjatë auditimit me zgjedhje të likuidimeve bankre rezultoi se gjatë viteve 2016- 2017 janë pranuar dhe likuiduar nga komisioni i pritjes së mallit barna, kite dhe reagente të cilat e kanë pasur afatin e skadencës më të vogël se 1 vit, veprim që bie në kundërshtim me DST të paraqitura në procedurën e prokurimit, me kontratën e nënshkruar mes palëve si dhe në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

kundërshtim me dokumentet standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe APP. Veprime të cilat kanë sjellë efekte financiare për buxhetin e këtij institucioni të detajuar në pikën B.

Rekomandimi: 16.1 Nga komisionet e marrjes në dorëzim të barnave, kite dhe reagente të zbatohen me përpikëri marrja e tyre konform të gjithë kërkesave dhe specifikimeve teknike të kontraktuara.
16.2 Nga AK duhet që, konform legjislacionit në fuqi, politikat e nevojave për mallra emergjente të jenë pjesë e procedurave të menaxhimit të fondeve dhe procedurave të prokurimit, të ndara nga praktikat e plotësimit të kërkesave të operatorëve konform përcaktimeve kontraktuale, duke monitoruar dhe shmangur çdo rast të pranimit të barnave, kiteve dhe reagenteve nën afatet e kontraktuara të skadencës dhe argumentuar ato si pasojë e nevojës emergjente.

Menjëherë

17. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedura të prokurimit rezulton se:

-Në 6 raste, në procedurat e negocimit pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, nga autoriteti kontraktor nuk është argumentuar dhe dokumentuar arsyeja e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negocim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Në 2 raste, në procedurat e negocimit pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, shkaqet e pavarura janë të paargumentuara dhe institucioni nuk ndodhet në kushtet e nevojës extreme për ngjarje të paparashikuara në kundërshtim me nenin 33 të LPP, pika c ku rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor.”

-Në 3 raste, në procedurat e marrjes me qira të kaldajave, nga Njësia e Prokurimit në përgatitjen e DT nuk është vepruar në përputhje me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 11.

-Në 2 rast skualifikimi i operatorit ekonomik është kryer jo në përputhje të VKM nr.914 datë 29.12.2014, Neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 3.

-Në të gjitha procedurat e prokurimit, nuk ka raporte mbi monitorimin e zbatimit të kontratës sipas specifikimeve teknike, sasitë, shërbimet e kryera etj., në kundërshtim me nenet 1, 15 e 17 të kontratës, së lidhur në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, dhe me VKM nr. 914, 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX, neni 77, ku gjithashtu në përfundim të kontratës autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IX neni 77, pika 1.

Rekomandimi: 17.1 Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në çdo rast të dokumentojë dhe argumentojë gjatë realizimit të procedurave të prokurimit me negocim pa shpallje, mënyrën dhe arsyen e përzgjedhjes të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

17.2 Autoriteti Kontraktor të marrë masa për të hartuar kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike;

17.3 Nga Drejtori i Spitalit t i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt;

Vazhdimisht

18. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se:

-Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 83/2.

- Në 5 raste nga procedurat e audituara, nuk konstatohet të jetë argumentuar dhe dokumentuar vendosja e kriterëve për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2.

- Në 6 raste, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1.

Rekomandimi: 18.1 Titullari i AK të marrë masa që t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve duke marrë masa për trajnimin e stafit mbi prokurimet publike, pasi në disa raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt, me qëllim rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike,

18.2 AK të zhvillojë procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj. Gjithashtu, duhet të merren masat përkatëse, lidhur me zbatimin e kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues, sipas kushteve të rënë dakord midis palëve.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Kanë rezultuar shkelje me dëm ekonomik në vlerën **14,103,107 lekë** të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

1. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditim i ushtruar mbi procedurën e prokurimit me objekt “Blerje medikamente për nevojat spitalore viti 2016” me afat furnizimi deri më datë 15.04.2016, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 2,920,321 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “FF” Sh.p.k .

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje medikamente për nevojat spitalore viti 2017” me afat furnizimi deri më datë 15.04.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 2,512,552 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik “FF” Sh.p.k si dhe **359,780 lekë dëm ekonomik** për furnizime me medikamente jo në përputhje me cilësinë e kërkuar.

-Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekësore për vitin 2017” me afat furnizimi deri më datë 15.04.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 1,897,181 lekë**,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik **“FF” Sh.p.k** si dhe **310,800 lekë dëm ekonomik** për furnizime me materiale mjekimi jo në përputhje me cilësinë e kërkuar.

Rekomandimi: 1.1 Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **7,330,054 lekë**, nga shoqëria **“FF” Sh.p.k.** vlerë e cila përbën penalitete për ditë vonesa në furnizim si dhe arkëtimi i vlerës prej **670,580 lekë** për medikamente të furnizuara jo në përputhje me cilësinë e kontraktuar.

Deri më 31.12.2018

2. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt: *“Blerje Kite& Reagent viti 2016-2017”* është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **1,231,776 lekë** për vitin 2016 dhe dëm ekonomik në vlerën totale prej **1,016,800 lekë** për vitin 2017 ku vlera 1,928,320 lekë janë mallra të furnizuara në kundërshtim me kushtet e kontratës neni 6 pika 2 e kontratës *“Cilësia e mallit”* (përkatesisht 911,520 lekë për vitin 2016 dhe 1,101,680 lekë për vitin 2017) dhe vlera 320,256 lekë përbën penalitete të llogaritura nga mos furnizimi në kohë me mall për kontratën në vitin 2016. Operatori ekonomik fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatese **“G-A F” SHPK** ka kryer me dijeni të plotë furnizimin me Kite& Reagente me një afat skadence më të vogël se një vit dhe nuk ka realizuar furnizimin me mall brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

Rekomandimi: 2.1 Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **2,248,576 lekë**, përkatesisht nga shoqëria **“G-A F” SHPK**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Deri më 31.12.2018

3. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditim i ushtruar mbi procedurën *“Blerje materiale mjekësore për vitin 2016”* me afat furnizimi deri më datë 15.04.2016, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 493,923 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur operatorit ekonomik **“G” Sh.p.k** si dhe **36,489 lekë dëm ekonomik** për furnizime me materiale mjekimi jo në përputhje me cilësinë e kërkuar.

Rekomandimi: 3.1 Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **530,412 lekë**, përkatesisht nga shoqëria **“G” Sh.p.k** vlerë e cila përbën penalitete për ditë vonesa në furnizim në vlerën 493,923 lekë dhe 36,489 lekë medikamente jo në përputhje me cilësinë e kontraktuar.

Deri më 31.12.2018

4. -Gjetje nga auditimi:- Gjatë auditimit është konstatuar se nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar të vendimeve gjyqësore, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar detyrime përmbarimore për 10 punonjësit e larguar, në **shumën 549,064 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, *veprime në kundërshtim me*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Rekomandimi: 4.1 Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **549,064 lekë**, konkretisht nga z. K.K shuma prej 333,436 lekë, nga z. P.M shuma prej 71,422 lekë, dhe nga z. R.K shuma prej 144,206 lekë për mos likuidim vullnetarisht të detyrimeve e lindura nga largimet e padrejta nga puna por duke shtuar dhe detyrime përmbartimore shtesë.

Deri më datë 31.12.2018

5. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “*Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve*”, për vitet 2015-2017, nga verifikimi i dokumentacionit për shërbimet e kryera rezultoi se për pjesët të cilat janë ndërruar është hartuar procesverbal nga kryetari i degës teknike z. F.D për vitet 2015-2016 dhe z. L.Q për vitin 2017 nënshkruar nga secili shofer në të cilin shprehen se është bërë kthimi i tyre në magazinën e rekuperos. Ndërkohë që pjesët e ndërruara nuk janë bërë në asnjë rast hyrje në magazinën e sipërpërmendur por ruhen nga shoferët në ambientet e garazhit të secilit. Nga verifikimi me zgjedhje i disa pjesëve të këmbimit të cilat ruhen nga shoferët rezultoi se mungonin disa prej tyre për të cilat nuk verifikohet fakti i ndërrimit të tyre.

Në lidhje me kryerjen e shpenzimeve për riparimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve nga titullari i AK-së nuk është kërkuar raport mbi zbatimin e kontratës së mësipërme. Vlera për kontratën e vitit 2015 për pjesët të cilat nuk u gjenden është në shumën 531,960 lekë, për kontratën e vitit 2016 është në shumën 544,800 lekë dhe për kontratën e vitin 2017 është në shumën 364,680 lekë *veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.* **Shuma 1,441,440 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.**

Rekomandimi: 5.1 Drejtoria e SRGJ, Dega Teknike, të marrin të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës për verifikimin e secilit nga automjeteve të riparuar si dhe identifikimin dhe verifikimin e pjesëve të ndërruara për saktësimin dhe konsolidimin e vlerës prej **1,441,440 lekë të konsideruar dëm ekonomik**, dhe të informohet institucioni i KLSH-së për masat e marra.

Deri më datë 31.12.2018

6. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i procedurave të inventarizimit rezultoi se komisioni kryesor i inventarizimit ka hartuar relacion në të cilin janë shprehur se komisioni i verifikimit të inventarëve ka konstatuar mungesa material i butë në shumën 73,800 lekë, mungesa në kuzhinë në shumën 13,275 lekë dhe mungesa në repartin e oksigjenit në shumën 7,700 lekë. Shuma totale **prej 94,775 lekë është konstatuar si dëm ekonomik për buxhetin e SRGJ.** Kjo shumë u është vënë në ngarkim personave përgjegjës, janë kryer regjistrimet kontabile në pasqyrat financiare të institucionit për secilin punonjës, por nuk është kërkuar arkëtimi.

Për sa më sipër rekomandojmë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

6.1 Nga Drejtoria e Spitalit, Sektori i Financës dhe juristi i SRGJ, të ndiqen të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **94,775 lekë**, nga personat të cilëve u është njohur detyrimi në kontabilitet.

Deri më datë 31.12.2018

7. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i rregullshmërisë së shpenzimeve të kryera për zbatimin e kontratave të furnizimit me karburant u konstatua se në të gjitha rastet për këto shpenzime është llogaritur vlera e taksës së markimit të cilat janë paguar ndaj secilit OE, duke u paguar më tepër në shumën **prej 44,281 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, vlerë e përfituar padrejtësisht nga Operatorët Ekonomikë. *Këto veprime bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.*

Rekomandimi: 7.1 Drejtoria e SRGJ, Dega e financës, Sektori Juridik, të marrin masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **44,281 lekë**, si përfitim i padrejtë nga Operatorët ekonomikë, konkretisht shuma 30,707 lekë nga OE “K shpk”, shuma 3,457 lekë nga OE “F P”, shuma 3,763 lekë nga OE “G.C.G”, shuma 3,284 nga OE “E Gj shpk” dhe shuma 3,070 lekë nga OE “AD”.

Deri më datë 31.12.2018

8. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Mirëmbajtje e impiantistikës, viti 2015”* është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **72,990 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e materialeve dhe punimeve të situacionuara, faturuar, dhe likujduara si punime të kryera në repartin e maternitetit gjatë periudhës 25.08.2015-31.12.2015 periudhë kjo, kur Godina e Maternitetit ka qenë në restaurim. Operatori ekonomik fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse **“I” SHPK** ka kryer me *dijeni të plotë furnizimin me materiale impiantistike ndërkohë që kjo godinë ka qenë në rikonstrukcion.*

Rekomandimi: 8.1 Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **72,990 lekë**, përkatësisht nga shoqëria **“I” SHPK**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Deri më datë 31.12.2018

9. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt: *“Blerje Kite&Reagent, viti 2015”*, dhe *“Blerje Kite&Reagent kontrata shtesë 2017”* është konstatuar **dëm ekonomik** në vlerën totale **320,460 lekë** (përkatësisht në vlerat 144,060 lekë për vitin 2015 dhe 176,400 lekë për vitin 2017), e cila përfaqëson furnizime me Kite&Reagent në kundërshtim me nenin 6 pika 2 e kontratës *“Cilësia e mallit”*, pasi shoqëria fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse **“G-A F” SHPK** ka kryer furnizimin me Kite&Reagente jo në përputhje me kontratën .

Rekomandimi: 9.1 Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **320,460 lekë**, përkatësisht nga shoqëria **“G-A F” SHPK**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Deri me datë 31.12.2018



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

10. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Medikamente, viti 2018”, është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **70,577 lekë**, e cila përfaqëson furnizime me medikamente në kundërshtim me nenin 6 pika 1 e kontratës “Cilësia e mallit”, pasi shoqëria fituese me të cilën është lidhur kontrata përkatëse “**FF**” SHPK ka kryer furnizimin me Medikamente jo në përputhje me kontratën.

Rekomandimi: 10.1 Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **70,577 lekë**, përkatësisht nga shoqëria “**FF**” SHPK, vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Deri me datë 31.12.2018

11. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Shpenzimet e siguracionit të godinave, viti 2017” është konstatuar dëm ekonomik në vlerën totale prej **198,500 lekë** e cila përfaqëson ½ e vlerës së kontratës. Mbështetur në kontratën e mëparshme, nga e cila autoriteti kontraktorë ka përlllogaritur fondin limit për mbulimin e rreziqeve ndaj tërmetit dhe përmytjeve, ndërkohë që referuar policës së sigurimit që operatori ekonomik fitues S.U.G.A” shpk ka paraqitur për vitin 2017 ajo ofron mbulimin vetëm për rreziqet ndaj Tërmeteve në kundërshtim dhe me kërkesat e autoritetit kontraktor.

Rekomandimi: 11.1 Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **198,500 lekë**, përkatësisht “**S.U.G.A**” shpk, vlerë e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Deri më datë 31.12.2018

12. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i dokumentacionit teknik të dosjes së zbatimit për kontratën e punimeve publike me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Maternitetit Gjirokastër” të lidhur sipas aktit me nr. 179 prot. datë 05.06.2015, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Spitalit Gjirokastër përfaqësuar nga z. A.M dhe Kontraktuesit shoqëria “**A K**” SHPK, rezulton se nga verifikimi në terren i volumeve të punimeve të përfunduara para tre viteve, diferenca në volume të likuiduara por të pakryera në fakt me pasojë dëm ekonomik në vlerën **474,198 lekë pa TVSH**, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve.

Rekomandimi: 12.1 Drejtoria e SRGJ, Dega e financës, Sektori Juridik, të marrin masa, që t’i kërkojë operatorit ekonomik “**A K**” ShPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **474,198 lekë pa TVSH**, të përfutur më tepër si pasojë e punimeve të pakryera në fakt por të situacionuara e të likuduara, në zbatimin e kontratës së lidhur sipas aktit me nr. 179 prot. datë 05.06.2015 me objekt “Rikonstruksion i Godinës së Maternitetit Gjirokastër”.

Deri më datë 31.12.2018

13. -Gjetje nga auditimi:- Nga verifikimi në objekt, dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit, dhe dokumentacioni i negociimit i ndodhur në dosjen e kontratës shtesë, u konstatua rritje e paargumentuar e çmimeve të zërave, mos realizmin i disa zërave sipas preventivit dhe situacionit



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

në vlerën **57,200 lekë** jo në përputhje me vendimin Nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, veprime të cilat kanë sjell një dëm ekonomik me vlerën **57,200 lekë pa TVSH** për buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e grupit të negocimit të përbërë nga z. A.B, znj. F.D dhe z. S.P.

Për sa më sipër rekomandojmë:

13.1 Drejtoria e SRGJ, Dega e financës, Sektori Juridik, të marrin masa, që t’i kërkojë personave përgjegjës z. A.B, znj. F.D dhe z. S.P duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **57,200 lekë pa TVSH**, si rritje fiktive e çmimeve të zërave për punimet e ndërtimit.

Deri më datë 31.12.2018

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Nga auditimi është konstatuar mospërdorim në përputhje me parimet e tre E-ve , shuma prej **32,722,316 lekë** detajuar si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi i rregullshmërisë së shpenzimeve, evidentimit dhe njohjes së detyrimeve që SRGJ ka ndaj të tretëve rezultoi se:

-Për periudhën objekt auditimi janë larguar punonjës të cilët kanë ndjekur procedurat ligjore dhe kanë paditur SRGJ në Gjykatë, nga të cilat 14 çështje kanë përfunduar me Vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit, duke detyruar SRGJ të njohë shpenzime gjyqësore për të dëmshpërblyer financiarisht punonjësit në **shumën 8,369,278 lekë e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.**

- Gjithashtu nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish-punonjësit, Spitali Rajonal Gjirokastër është paditur në Gjykatë nga 13 punonjës të cilët janë në proces gjykimi dhe referuar Vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër kanë fituar këtë shkallë të gjykimit duke kërkuar nga SRGJ një dëmshpërblim financiar në shumën totale **5,057,674 lekë, shumë e cila do të sjellë një efekt financiar negativ të pritshëm për buxhetin e shtetit.**

Rekomandimi: 1.1 Nga Drejtori i Spitalit, Sektori Juridik, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, duke evidentuar përgjegjësitë individuale dhe të merren vendimet përkatëse, pasi shumatat e mësipërme janë në vlera të konsiderueshme për institucionin dhe buxhetin e shtetit.

1.2 Nga Drejtimi i Spitalit të merren masat që, në të ardhmen të respektohen procedurat e largimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke synuar një përdorim të fondeve publike me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i menaxhimit të aseteve dhe ambienteve të dhëna me qira nga prona truall që ky spital administron që në ndërtimin e tij dhe referuar planimetrisë së vitit 1981 nga 31,190 m² truall sot në administrim të spitalit janë vetëm 27,325 m² ose 3,865 m² më pak,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

sipërfaqe këto të zhveshura nga ana jugore dhe veriore e pronës. Sipërfaqe kjo e zhveshur ndërvite dhe përfitur nga subjekte apo individë privatë. Referuar çmimit të trojeve në Republikën e Shqipërisë miratuar me VKM nr. 89 datë 03.02.2016 për qytetin e Gjirokastrës zona kadastrale nr. 8541 ka një çmim reference dysHEME prej $4865 \text{ lekë/m}^2 \times 3,865 \text{ m}^2 = \mathbf{18,803,225 \text{ lekë vlerë e zhveshur nga asetet e spitalit e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e Shtetit.}}$

Rekomandimi: 2.1 Nga Drejtori i Spitalit, Sektori Juridik, të analizohet në mënyrë procesi i inventarizimit dhe regjistrimit të asetëve në zyrën e rregjistrimit përkatëse, për parandalimin e mëtejshëm të privatizimit të sipërfaqes funksionale të këtij institucioni dhe për një menaxhimi më efikas dhe me efektivitet për institucionin.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. -Gjetje nga auditimi:- Për periudhën objekt auditimi nga blerja e medikamenteve, materiale mjekësore dhe Kite Reagente të pa planifikuar mire pa marrë gjendjen e Farmacisë apo pa llogaritur konsumin mesatarë ndër vite dhe mbi të gjitha pranimiti i mallrave jo në përputhje me kontratën por me një afat skadence shumë të afërt u konstatuan barna të skaduara në **vlerën prej 2,648,765 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për Institucionin.**

Rekomandimi: 3.1 Nga Drejtori i Spitalit dhe farmacia, të analizohen në mënyrë të njëpasnjëshme medikamentet e kitet reagonte apo materialet e mjekimit në sasinë e nevojshme, gjendjen aktuale dhe konsumin mesatare si dhe të operohet me shpërndarje në spitalet e tjera për eliminimin e daljes jashtë përdorimi të këtyre medikamenteve dhe rritjen e efijencës në shpenzimin e fondeve publike.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i shpenzimeve për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve për vitet 2015-2017 rezultoi se : Për automjetin tip Mercedes-Benz me targa AA 366 EJ i vitit të prodhimit 1990 janë kryer shpenzime për të tre vitet në shumën 328,296 lekë (81,960 lekë për vitin 2015, 125,040 lekë për vitin 2016 dhe 121,296 lekë për vitin 2017), shpenzime të cilat janë në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit dhe efektivitetit, pasi kostoja e riparimit dhe mirëmbajtjes së këtij automjeti tejkalon vlerën e blerjes së një automjeti të ngjashëm, ku në kushtet e tregut ekzistencial mund të gjejsh automjete të ngjashme të cilat variojnë në shumën rreth 150,000 lekë sipas verifikimeve të bëra në tregun e automjeteve në faqet e ndryshme në ëeb. Nga ana e drejtuesve të institucionit dhe strukturat mbështetëse nuk është kryer një studim për vlerësimin e këtij aktivi si dhe për shpenzimet që janë kryer në lidhje me të. Shpenzimet për këtë automjet janë shpenzime të keq menaxhuara, **veprime të cila janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, që kanë rënduar buxhetin e shtetit në shumën prej 328,296 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ.**

Rekomandimi: 4.1 Nga Drejtori i SRGJ, zv. Drejtori ekonomik, të merren masat e duhura për analizimin e këtyre shpenzimeve, duke mos përsëritur të njëjtën logjikë në vijim, pa analizuar dhe llogaritur më parë kostot e riparimit të automjetit, dhe të veprohet në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit.

Në vijimësi

5. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt: “Blerje Medikamente, viti 2018” rezultoi se gjatë hartimit të fondit limit për blerjen e medikamenteve është planifikuar një sasi më e madhe nga sa konsumohet realisht. Mbështetur në të dhënat e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

farmacisë dhe llogaritjen e konsumit mesatarë për secilin zë të medikamenteve të shpërndarë në çdo 10 ditë kalendarike për të njëjtën periudhë por në vitin paraardhës, por dhe me sasinë e madhe të ilaçeve të skaduara për vitet objekt auditimi, vlera e përlogaritur prej **1,564,524 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit.**

Rekomandimi: 5.1 Nga titullari i SRGJ të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike **në vlerën 1,564,524 lekë** dhe eliminimin e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.

Në vijimësi

6. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël i objektit: “*Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore dhe impiantistikës, viti 2017*” është konstatuar efekt financiarë negativ në vlerën totale prej **666,180 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e kontratës së realizuar me fitues OE “A.G” në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku ngarkohet me përgjegjësi *anëtarët e njësisë së prokurimit dhe ish drejtori Z. P.M, për arsye se në këtë procedure prokurimi blerje me vlerë të vogël pas dështimit 2 herë në sistem, operatori ekonomik i përzgjedhur në mënyrë shpresore përpara daljes së urdhër prokurimit ka paraqitur sigurimin e kontratës për këtë procedurë.*

Rekomandimi: 6.1 Nga titullari i SRGJ të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike **në vlerën 666,180 lekë** dhe eliminimin e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.

Vazhdimisht

7. -Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i procedurave të prokurimit me objekt: “*Blerje Kite&Reagent, viti 2015*” rezultoi se: -Nga ana e KVO në procedurën e datës 26.06.2015 për “Blerje Kite&Reagent” është skualifikuar OE “G” sh.p.k me vlerë oferte 1,309,074.9 lekë. Skualifikimi është bërë me argumentimin se këtij OE i mungon ekstrakti i regjistrimit tregtarë si dhe ekstrakti mbi historikun e subjekteve të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Në referencë të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 53 pika 4, KVO ka kryer një skualifikim të pa drejtë mbështetur në VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar, datë 29.12.2014, Neni 66 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave pika 3 “*Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal*”. Në këtë rast KVO nuk ka menduar për ekonomicitetin e procedurës nisur nga oferta e marrë që është 23.8% më e ulët se fondi limit por ka preferuar të skualifikojë këtë operatorë dhe të ri kryejë procedurën e prokurimit.

-Nga ana e KVO në procedurën e datës 30.07.2015 për “Blerje Kite&Reagent” janë kualifikuar 2 OE, “G-A F” me ofertë prej 1,651,126 dhe “G” sh.p.k me vlerë oferte 1,700,226 lekë. Operatori i renditur i dyti i cili në procedurën e anuluar kishte ofruar 1,309,074.9 dhe skualifikuar padrejtësiht në këtë procedurë ofron 1,700,226 lekë ose 23% më tepër. OE fitues i kësaj procedure është “G-A F”.

Si pasojë e veprimeve të mësipërme, për arsye të skualifikimit të OE me ofertë më të vogël në procedurën e anuluar me pa të drejtë, për devijime të cilat nuk ndryshojnë në thelb ofertën, si dhe për shkak të kualifikimit dhe shpalljes fitues të një OE me ofertë më të lartë edhe pse në procedurë e përsërit, **është krijuar një efekt negativ financiarë me vlerë 342,051 lekë.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Rekomandimi: 7.1 Nga titullari i SRGJ të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën **342,051 lekë** dhe eliminimin e përsëritjes së rasteve të tilla në të ardhmen.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës nr. 17 prot., datë 07.01.2014 kontratave individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastër që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, si më poshtë: **“Vërejtje me shkrim”** deri në **“Largim nga puna”** për:

- 1. znj. V.T**
- 2. Z. J.K**
- 3. Znj. R.K**
- 4. Znj. M.Z**
- 5. Znj. Sh.Ç**

në cilësinë e komisionit të kolaudit dhe marrjes në dorzim të medikamenteve dhe materialeve mjekësore, për arsye se:

-Në kontratën e furnizimit me nr. 108 prot., datë 19.02.2016 “Blerje medikamente”, me vlerë 9,630,623.17lekë, me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 19.03.2016, nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër K.K dhe administratori i shoqërisë “F” shpk A.T. Nga komisioni i kolaudit dhe marrjes në dorzim janë pranuar medikamente jo në përputhje me në nenin 3 ‘Afati i lëvrimit’ pa përmbushur specifikimet e kërkuara në vlerën 42,750 lekë.

-Në kontratën e furnizimit me nr. 45/1 prot., datë 25.01.2017“Blerje medikamente”, me vlerë 10,467,525 lekë, me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 28.02.2017, nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër K.K dhe administratori i shoqërisë “F” shpk A.T. Nga komisioni i kolaudit dhe marrjes në dorzim janë pranuar medikamente Jo në përputhje me në nenin 3 ‘Afati i lëvrimit’ pa përmbushur specifikimet e kërkuara në vlerën 359,780 lekë.

-Në kontratën e furnizimit me nr. 95 prot., datë 12.02.2016“Blerje materiale mjeksore”, me vlerë 6,068,449 lekë, me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 12.03.2016, nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër K.K dhe administratori i shoqërisë “G” shpk A.C. Nga komisioni i kolaudit dhe marrjes në dorzim janë pranuar medikamente Jo në përputhje me në nenin 3 ‘Afati i lëvrimit’ pa përmbushur specifikimet e kërkuara në vlerën 36,490 lekë.

-Në kontratën e furnizimit me nr. 49/1 prot., datë 26.01.2017“Blerje materiale mjeksore”, me vlerë 5,453,540 lekë, me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 28.02.2017, nënshkruar nga drejtori i spitalit Gjirokastër K.K dhe administratori i shoqërisë “G” shpk A.C. Nga komisioni i kolaudit dhe marrjes në dorzim janë pranuar medikamente Jo në përputhje me në nenin 3 ‘Afati i lëvrimit’ pa përmbushur specifikimet e kërkuara në vlerën 310,800 lekë.

-Në kontratën e furnizimit me nr. 274 prot., datë 03.09.2015“Blerje Kite & Reagent”, me vlerë 1,981,351 lekë, me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2015. Nga komisioni i kolaudit dhe marrjes në dorzim janë pranuar Kite&Reagent Jo në përputhje me në nenin 6 pa përmbushur specifikimet e kërkuara në vlerën 144,060 lekë.

-Në kontratën e furnizimit me nr. 347 prot., datë 07.07.2016“Blerje Kite & Reagent”, me vlerë 4,415,220 lekë, me afat nga data e lidhjes së kontratës deri më datë 31.12.2016. Nga komisioni i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

kolaudimit dhe marrjes në dorzim janë pranuar Kite&Reagent Jo në përputhje me në nenin 6 pa përmbushur specifikimet e kërkuara në vlerën 911,520 lekë.

6. Znj. D.T në cilësinë e përgjegjse e zyrës së financës për arsye se:

Nga auditimi i shpenzimeve për karburant u konstatua se në të gjitha rastet janë kryer pagesa për kontrata furnizimi me karburant pa kërkuar deklaratën doganore SAD të Operatorit Ekonomik konstruktues, mbi bazën e të cilit do të llogaritej çmimi për njësi i karburantit, por çmimi është vendosur bazuar në faturën me TVSH sipas furnizimit të shoqërisë, dhe buletinit të fundit sipas datës së faturës dhe kursit të këmbimit, gjithashtu nga titullari i SRGJ, në asnjë rast nuk është ngritur komision për mbikëqyrjen e kontratës, *veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IX, neni 77, pika 5 dhe 6.*

Gjatë auditimit është konstatuar se nga mosndjekja e procedurave për likuidim vullnetar të vendimeve gjyqësore, nga momenti i njohjes së vendimit të Gjykatës së Apelit, rezulton se janë paguar detyrime përmbartimore për 10 punonjësit e larguar, në **shumën 549,064 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**, *veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.*

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2017 rezulton se gjendja debitore për gjoba, penaltete dhe detyrime të cilat janë gjeneruar për 68 punonjës të insitucionit nga kontrollet e FSDKSH-së, detyrime këto të cilat duhet të mblidhen dhe arkëtohen nga Spitali Rajonal Gjirokastrë, konstatohet se vlera në fund të vitit paraqitet në shumën 1,952, 840 lekë. Nga ana e insitucionit nuk janë marrë masat e duhura për nisjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 9, neni 12, pika g dhe gj, dhe **shuma prej 1,952,840 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.**

Gjithashtu paraqiten edhe debitorë të tjerë të cilët janë operatorë ekonomik apo mbikqyrës punimesh të cilët nuk kanë zbatuar kushtet e kontratave duke gjeneruar penaltete dhe gjoba, të cilat janë njohur në pasqyrat financiare të SRGJ. Këto penaltete janë konstatuar nga kontrollet e vazhdueshme të kryera nga FSDKSH ndaj SRGJ, ku janë 8 subjekte në shumën totale 2,885,142 lekë.

Nga ana e insitucionit nuk janë marrë masat e duhura për nisjen e procedurave ligjore për arkëtimin e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 9, neni 12, pika g dhe gj, dhe **shuma prej 2,885,142 lekë përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.**

-Nga auditim i ushtruar mbi procedurën “Blerje medikamente për nevojat spitalore viti 2016” me afat furnizimi deri më datë 15.04.2016, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 2,920,321 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penaltetet të pa llogaritur dhe mbajtur OE **“FF” Sh.p.k**.

-Nga auditim i ushtruar mbi procedurën “Blerje medikamente për nevojat spitalore viti 2017” me afat furnizimi deri më datë 15.04.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 2,512,552 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e mallit, mbi penaltetet të pa llogaritur dhe mbajtur OE **“FF” Sh.p.k** si dhe **359,780 lekë dëm ekonomik** për furnizime me medikamente jo në përputhje me cilësinë e kërkuar.

Nga auditim i ushtruar mbi procedurën “Blerje materiale mjekësore për vitin 2017” me afat furnizimi deri më datë 15.04.2017, është konstatuar **dëm ekonomik në vlerën prej 1,897,181 lekë**, pasi nga ana e autoritetit kontraktorë nuk është aplikuar tarifa ditore për ditë vonese në dorëzimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

mallit, mbi penalitetet të pa llogaritur dhe mbajtur OE “*FF*” *Sh.p.k* si dhe **310,800 lekë dëm ekonomik** për furnizime me materiale mjekimi jo në përputhje me cilësinë e kërkuar .

7. z. S.P në cilësinë e anëtarit të komisionit të negocimit të çmimeve për arsye se:

Në kontrata shtesë me Nr. 459 datë 21.10.2016 dhe vlerë 11,500,000 lekë me TVSh, midis autoritetit kontraktor përfaqësuar nga z. K.K dhe sipërmarrësit përfaqësuar nga z. A.H. Nga verifikimi në objekt, dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit, dhe dokumentacioni i negocimit i ndodhur në dosjen e kontratës shtesë, u konstatua rritje e pa argumentuar e çmimeve të zërave, mos realizmin i disa zërave sipas preventivit dhe situacionit në vlerën **57,200 lekë pa TVSh**

“Vërejtje”

9. z. M.G në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave për arsye se:

Në procedurën e prokurimit me objekt ‘Blerje lëndë djegëse për ngrohje (pellet) për nevojat e spitalit’ viti 2017 ka kualifikuar operatorin ekonomik pa përmbushur specifikimet teknike referuar dokumentacionit që ndodhet në sistem dhe në dosje “kaldaja me pellet **490KË** në pronësi” ajo nuk përmbush kushtin kryesorë fuqin termike. Nga ana e autoritetit kontraktorë është kërkuar kaldajë 500KË me fuqi termike nominale 500kë dhe fuqi termike e kthyer 459kë, kaldaja e ofruar nga operatori ekonomik është me fuqi 490KË me fuqi termike nominale 490KË dhe fuqi termike e kthyer 400KË.

D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Largim nga detyra”, për:

- z. A.M**, me detyrë ish. Drejtor i spitalit ‘Omer Nishani’
- z. K.K**, me detyrë ish. Drejtor i spitalit ‘Omer Nishani’
- z. F.D**, në cilësinë e ish përgjegjës të teknikës.
- z. G.B**, me detyrë ish përgjegjës i prokurimeve

“Vërejtje” deri “Largim nga puna” përkatësisht për:

- z. A.B**, me detyrë ish-nëndrejtor ekonomik.

GRUPI I AUDITIMIT

1. S.H, Përgjegjësi i Grupit të Auditimit
2. E.M, Auditues
3. A.N, Audituese
4. I.D, Auditues
5. J.H, Auditues

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

Y.P



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

Anekset

Konceptet dhe shkurtime e përdorura.

KLSH- Kontrolli i Lartë i Shtetit
SRV- Spitali Rajonal vlorë
AK- Autoriteti Kontraktor
VKM- Vendim i Këshillit të Ministrave
MF- Ministria e Financave
UMF- Udhëzim i Ministrisë së Financave
LPP- Ligji i Prokurimit Publik
KM- Këshilli Mbikëqyrës
QKL- Qendra Kombëare e Licencimit
QKR- Qendra Kombëare e Regjistrimit
MPPT- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
TVSH- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
AK- Autoriteti Kontraktor
OE- Operator Ekonomik
KVO- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NjP- Njësia e Prokurimit
FL- Fondi Limit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE
RAPORT AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN RAJONAL
“OMER NISHANI” GJIROKASTËR.

KTP- Kusht Teknik i Projektimit

KTZ- Kusht Teknik i Zbatimit

MFK- Menaxhimi Financiar dhe i Kontrollit